



Studim mbi Rindërtimin e Sistemit të Integritetit Nacional

Kosovë, 2007

Autorë të raportit

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS)

IKS

IKS-i është institut hulumtues jo-fitimprurës, i themeluar në vitin 2004 në Prishtinë, Kosovë. IKS-i ka për qëllim që të ofrojë hulumtime të reja dhe të politikave relevante për çështjet me rëndësi për zhvillimin social dhe ekonomik të Kosovës. IKS-i përkrahet nga Bordi Këshillues që përfshin analistë dhe praktikantë kosovarë dhe ndërkombëtarë. Puna e tyre është e financuar nga Balkan Trust for Democracy, Rockefeller Brothers Foundation, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe the Swiss Agency for Development and Cooperation. Në partneritet me Tiri-in, IKS-i ka ndërmarrë hulumtime mbi korrupsionin dhe keq menaxhimin në Kosovën e pasluftës. IKS-i, poashtu, ka bërë një studim të gjerë socio-ekonomik për kryeqytetin e Kosovës dhe tani është duke hulumtuar zhvillimin në viset rurale të Kosovës. Për më shumë informata për IKS-in, ju lutemi vizitoni www.iksweb.org.

Tiri

Tiri është një OJQ ndërkombëtare me seli në Londër, që bashkëpunon me shoqërinë civile, qeveritë dhe bizneset, me qëllim të krijimit të rrjeteve të agjentëve të zotuar për ndryshime, me qëllim të reformimit strategjik të integritetit. Tiri është një inkubator i cili ndihmon reformat e reja dhe ofron një program të mësimi kritik për të përhapur përvojat më moderne.

Ky raport është pjesë e serisë prej tetë studimeve nga vendet e rindëtuara pas luftës, të autorizuara nga Tiri dhe financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Instituti i Fondacionit për Shoqëri të Hapur. Të gjitha studimet mund t'i gjeni në www.tiri.org. Tetë qendra politike lokale ndërmorën hulumtime, duke përdorur udhëzimet e njëjta të punës. Vendet e përfshira janë: Afganistani, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Libani, Mozambiku, Palestina, Sierra Leone dhe Timori Lindor. Hulumtimi është bazë e një plani për avokim dhe monitorim, me qëllim të promovimit të integritetit në rindërtim përbrenda tetë vendeve dhe më gjerë (në aspektin ndërkombëtar). Bashkërisht, këto grupe formojnë Rrjetin për Integritet në Rindërtim (NIR).

I tërë materiali i përfshirë në këtë studim është paraparë të jetë gati me 6 Janar 2007. Janë bërë të gjitha përpjekjet për t'i verifikuar informatat që janë përfshirë përbrenda, përfshirë edhe deklaratat. Megjithatë, Tiri nuk merr përgjegjësinë për pasojat që dalin nga shfrytëzimi i këtyre informatave për qëllime të tjera ose në kontekst tjetër.

Sistemi i Integritetit Nacional

Sistemi i Integritetit Nacional (NIS), si qasje, është zhvilluar nga Jeremy Pope, për t'i kuptuar dobësitë e institucioneve shtetërore dhe dështimet e iniciativave të mëparshme reformiste, duke trajtuar korrupsionin nga shumë pikëpamje: shkaqet e korrupsionit, marrëdhëniet në mes të ekzekutivit dhe institucioneve të tjera shtetërore; fushat kryesore ku paraqitet korrupsioni ose ku demokratizimi është i detyruar; institucionet ose fushat që kanë rol në nxitjen e reformës dhe të demokratizimit, në ballafaqimin me korrupsionin; progresi në strategjinë e qeverisë dhe iniciativave të donatorëve kundër korrupsionit; përparësitë dhe dobësitë përkatëse të këtyre institucioneve ose fushave mbi baza individuale ose kolektive, për t'i siguruar kapacitetet e veta që të jenë të lira nga korrupsioni ('korrupsioni-argumentimi'), si dhe të nxisin një qasje më të kompletuar për t'u ballafaquar me korrupsionin.

Studimi mbi Rindërtimin i NIS-it (RNIS) e çon qasjen edhe më përpara, duke e përdorur atë për t'i vlerësuar vendet e pas luftës se si e rindërtojnë ato shtetin dhe ecin drejt demokratizimit. RNIS-i ofron kornizën përmes së cilës bëhet vlerësimi i ndikimit dhe i pasojave të konfliktit, çështjeve të shumta politike dhe institucionale, rolit të donatorëve, jo vetëm sa i përket rindërtimit, zhvillimit kundër-korrupsionit dhe prioritetëve, por gjithashtu edhe sa i përket çështjeve shpesh komplekse dhe të vazhdueshme të pushtetit, korrupsionit dhe demokratizimit.

Studimet e vendeve të RNIS-it janë punuar sipas një shablloni të njëjtë, duke kërkuar pasqyrën e përgjithshme të vendit dhe profilin e korrupsionit, plotësuar me evidencën e llojeve, niveleve dhe shkaqeve të korrupsionit. Kjo qasje kërkon diskutime për hapat e ndërmarrë nga institucionet dhe fushat kryesore - zakonisht ekzekutivi; legjislativi, zgjedhjet/financimi i partive politike; auditori; gjyqësia; shërbimi civil; policia dhe prokuroria; prokurimi publik; ombudspersoni; agjencitë hetimore/vëzhguese; mediat; shoqëria civile; qeveria lokale dhe rajonale – në parandalimin e korrupsionit si dhe njoftimin mbi efikasitetin e hapave të tillë dhe marrëdhëniet në mes të institucioneve dhe çështjet, siç janë ndërhyrja politike e institucioneve, pasojat nga regjimet e mëparshme, roli i donatorëve në përkrahjen dhe bashkëpunimin në procesin e reformimit - në përgjithësi, si dhe të korrupsionit, në veçanti; politizimin e reformave miqësore të donatorëve, siç janë decentralizimi dhe demokratizimi.



Tiri

Downstream Building (3rd fl),
1, London Bridge,
London SE1 9BG
United Kingdom

Kosovar Stability Initiative (2007) *Reconstruction National Integrity System Survey Kosovo 2007*. London: Tiri

© 2007 Tiri

Përmbajtje

1. Shkurtesat.....	7
2. Përmbledhje ekzekutive.....	11
3. Përshkrimi i vendit.....	12
3.1 Konteksti i konfliktit-lufta.....	13
3.2 Kostoja e konfliktit.....	15
3.3 Korrupsioni dhe konflikti.....	16
3.4 Pasojat e konfliktit.....	17
3.5. Donatorët dhe financimi.....	17
3.6 Rindërtimi i vendit.....	19
3.7 Çështjet e rindërtimit – koordinimi i donatorëve.....	21
4. Profili i korrupsionit.....	22
5. Aktivitetet kundër korrupsionit.....	24
5.1 Qeveria.....	24
5.2 Donatorët.....	25
6. Sistemi i Integritetit Nacional.....	26
6.1. Ekzekutivi.....	26
6.2. Legjislativi.....	29
6.3. Komisioni zgjedhor.....	33
6.4. Financimi dhe shpenzimet e partive politike.....	35
6.5. Institucioni i Auditorit Suprem.....	38
6.6. Gjyqësia dhe prokurorët.....	41
6.7. Shërbimi civil.....	44
6.8. Policia.....	47
6.9. Prokurimi publik.....	49

6.10. Ombudspersoni.....	53
6.11. Agjencitë vëzhguese.....	57
6.12. Mediat.....	Error! Bookmark not defined.
6.13. Shoqëria civile.....	Error! Bookmark not defined.
6.14. Qeverisja lokale dhe rajonale.....	Error! Bookmark not defined.
7. Diskutimi i çështjeve kryesore.....	70
7.1 NIS: Institucionet e integritetit.....	70
7.2 Ecuria e reformave në rindërtim.....	74
7.3 Efikasiteti i reformave në rindërtim.....	75
8. Prioritetet dhe rekomandimet.....	76
9. Fusnotat.....	78
10. Referencat.....	95
10.1 Publikimet.....	95
10.2 Burime nga interneti.....	97
10.3 Shtypi.....	101
11. Legjislacioni.....	103
12. Intervistat.....	106

1. Shkurtesat

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
BPK	Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
AQF	Autoriteti Qendror Fiskal
CIVPOL	Policia Civile e UNMIKU-ut
DASHC	Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil
DoR	Departmenti i Rindërtimit
AER	Agjencia Evropiane e Rindërtimit
EC	Komisioni Evropian
KZPA	Komisioni i Zgjedhjeve për Parashtresa dhe Ankesa
KEF	Këshilli Ekonomik dhe Fiskal
UE	Unioni Evropian
EUMIK	Misioni i Unionit Evropian në Kosovë
EURORAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Publike Financiare të Jashtme dhe Rajonale
FIU	Zyra për Hetime Financiare
RFJ	Republika Federative e Jugosllavisë
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
DPB	Drejtorati për Banim dhe Pronë
KPM	Komisioni i Pavarur për Media

ICTY	Tribunali Ndërkombëtar për Krimet në ish-Jugosllavi
ITF	Grupi Punues Ndërkombëtar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KDGJ	Komisioni Disiplinor Gjyqësor
SPPA	Strukturat e Përbashkëta të Përkohshme Administrative
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
K-FOR	Forcat e NATO-s në Kosovë
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
SHGA	Shoqata e Gazetarëve të Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
KNAP	Projekti Kosovar për Avokim të OJQ-ve
KOCB	Zyra për Krimin e Organizuar në Kosovë
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
MTI	Ministria e Tregëtisë dhe e Industrisë

NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
GJHR	Gjykata Holandeze për Revizion
NDI	Instituti Kombëtar Demokratik
OJQ	Organizatë Joqeveritare
NIS	Sistemi i Integritetit Nacional
NISS	Sudim mbi Rindërtimin e Sistemit të Integritetit Nacional
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral të Kosovës
IOK	Institucioni i Ombudsperson-it në Kosovë
OLAF	Zyra Evropiane për Luftën Kundër Mashtrimeve
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
OSCE	
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSCE-KVM	Misioni Verifikues në Kosovë i OSBE-së
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovës
NPP	Ndërmarrjet në Pronësi Publike
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
KRPP	Komisioni Rregulativ i Prokurimit Publik
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Partive Politike
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
NPSH	Ndërmarrje në Pronësi Shoqërore
ESK	Enti i Statistikës të Kosovës
KELDP	Komisioni për Emërime të Larta në Polici dhe Drejtësi
SPEAK	Përkrahja për Arkivin Elektronik Parlamentar në Kosovë

PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KPM	Komisioni i Përkohshëm për Media
TOL	Tranzicioni Online
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Grave
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar

2. Përmbledhje ekzekutive

Me qëllim të vlerësimit të suksesit të Sistemit të Integriteti Nacional të Kosovës (NIS), ky studim bazohet në dy kritere themelore. E para, është niveli deri në të cilin një institucion ka qenë në gjendje t'a përmbush misionin e vet të plotë, duke kontribuar kështu pozitivisht në integritetin e përgjithshëm të NIS-it të Kosovës. E dyta, është më e përafërt me atë se sa ka qenë drejtpërdrejt e kyçur secila shtyllë në luftimin e parregullsive dhe të korrupsionit. Sa i përket periudhës së marrë në shqyrtim, ky studim kontrollon të dyjat: procesin e (ri) ndërtimit të institucioneve – dhe rolin e aktorëve të përfshirë vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe efikasitetin e tyre sot, shtatë vite pas përfundimit të luftës.

Bazuar në kriteret e mësipërme, ky raport tregon se mediat janë sot shtylla më e fortë e NIS-it të Kosovës. Mediat e shkruara kanë qenë posaçërisht një organ aktiv, i zëshëm dh dinamik, duke pasqyruar dhe mbajtur një shumëllojshmëri pikëpamjesh dhe qëndrimesh të ndryshme ndaj spektrik politik të Kosovës. Ato, po ashtu, kanë qenë një prej shtyllave më këmbëngulëse në raportimin për dhe kundër korrupsionit dhe parregullsive të tjera në sektorët publik dhe privatë të Kosovës.

Komisioni Zgjedhor, Zyra e Auditorit Gjeneral, Ombudspersoni dhe Shërbimi Policor, po ashtu, kanë qenë relativisht shtylla të suksesshme, shikuar nga misionet dhe mandatet e tyre ligjore. Mirëpo, ky studim konsaton se efikasiteti i tyre në praktikë është i kufizuar, sepse janë të varur nga funksionimi i institucioneve të tjera, veçanërisht ngs sistemi i drejtësisë.

Në të vërtetë, ky studim ka gjetur se gjyqësia është shtylla më e dobët në NIS-in e Kosovës, e cila në masë të madhe e pengon punën dhe lidhshmërinë e pjesës tjetër të sistemit. Siç do të tregojë ky studim, sistemi gjyqësor jofunksional – në rastin më të mirë – e bën punën e institucioneve të tjera të pavlerë, siç është rasti me Auditorin Gjeneral të Kosovës. Në rastin më të keq, ndihmon shfaqjen e korrupsionit, duke mos i mbajtur nën kontroll institucionet e tjera të rëndësishme, siç është ekzekutivi.

Legjislativi dhe ekzekutivi, po ashtu, kanë qenë relativisht shtylla të dobëta në NIS-in e Kosovës. Të influencuara drejtpërdrejt nga forcat dhe interesat e partitve politike, këto institucione kanë qenë të dobëta në luftimin e korrupsionit dhe të parregullsive të tjera të brendshme. Gjithashtu, pavarësisht pozitës së tyre qendrore në NIS, ato pak kanë kontribuar në nxitjen e integritetit në institucionet e tjera qeveritare.

Shkurt, ky studim sugjeron se NIS-i i Kosovës, për dy arsye, është jo funksional. E para, ndonëse është bërë një përparim i dukshëm në zhvillimin e kornizës ligjore kundër korrupsionit, zbatimi i ligjit në praktikë shpesh ka munguar. E dyta, NIS-i i Kosovës është jo funksional, po ashtu, për arsye se parregullsitë e disa prej shtyllave më të rëndësishme të tij vazhdimisht zvogëlojnë efikasitetin e shtyllave të tjera të suksesshme. Kështu, mësimi kryesor që del nga shembulli i Kosovës për misionet e ardhshme ndërkombëtare në vendet e pasluftës, është se ndërtimi i një gjyqësie

efikase, që nga fillimi i procesit të rindërtimit, është vendimtare për sigurimin e një NIS-i të suksesshëm dhe të vetëqëndrueshëm.

3. Përshkrimi i vendit

Kosova përfshin 10.887 kilometra katrorë dhe ka 1.86 milionë banorë.¹ Është e rrethuar dhe kufizohet me Malin e Zi - në veriperëndim, me Serbinë - në veri dhe në verilindje, me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë - në jug, si dhe Shqipërinë - në perëndim dhe në jugperëndim. Rreth 90% e popullësisë së Kosovës janë shqiptarë, 8% serbë dhe malazezë, ndërsa të tjerët (turqit, romët, ashkalijtë, egjiptasit dhe boshnjakët) përbëjnë 2% të popullësisë së saj.²

Kosova ka qenë nën protektoratin e KB-së që nga viti 1999. Ligjërisht ende është pjesë e Republikës së Jugosllavisë, por në proces të 'bisedimeve për statusin final' që nga fillimi i vitit 2006. Administrimi zyrtar në Kosovë udhëhiqet nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), autoriteti i të cilit rrjedh nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB-së.

Pas zgjedhjeve të para nacionale në vitin 2001, UNMIK-u ndihmoi krijimin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ). IPVQ-të përmbajnë Zyrën e Presidentit të Kosovës, Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Kryeministrit, 15 ministritë, gjykatat dhe një numër të institucionve të tjera, siç janë përcaktuar në Kornizën Kushtetuese të vitit 2001. Përgjatë viteve, UNMIK-u transferoi një numër të kompetencave tek institucionet vendore (për shembull, në arsim dhe në shëndetësi), ndonëse ende mban autoritet të rezervuar në disa fusha (siç është privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore). Gjithashtu, që cilido ligj i miratuar nga inishtacionet e zgjedhura vendore të mund të hyjë në fuqi, kërkohet nënshkrimi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara.

Pushteti politik vendor është i ndarë në mes të katër partive më të mëdha politike. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) është partia më e vjetër, që ende gëzon përkrahjen më të madhe, edhe përkundër humbjes së 100.000 mijë votuesve në zgjedhjet e fundit. Partia Demokratike e Kosovës (PDK), partia e dytë më e madhe, është themeluar pas luftës dhe ka tërhequr përkrahësit e saj kryesisht nga ish luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Kryeministri i parë i pasluftës në Kosovë, Bajram Rexhepi, ka qenë anëtar i PDK-së dhe ka mbajtur këtë pozitë gjatë viteve 2001-2004. PDK-ja tani është në opozitë, së bashku me 'Partinë Reformiste – Ora', një parti e re, e themeluar pak para zgjedhjeve të vitit 2004, që udhëhiqet nga ish gazetari dhe botuesi, Veton Surroi. Kryeministri aktual, Agim Çeku, është anëtar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), partia e tretë për nga madhësia, shumica e përkrahësve të së cilës vijnë nga strukturat e UÇK-së në perëndim të Kosovës.

Zgjedhjet e para të mbajtura në Kosovë kanë qenë zgjedhjet lokale (komunale), në vitin 2000, të cilat janë pasuar nga zgjedhjet nacionale në vitin 2001. Grupi i dytë i zgjedhjeve lokale dhe nacionale është bërë në vitin 2002, respektivisht në vitin 2004. Përveç zgjedhjeve të para lokale në vitin 2000, të gjitha zgjedhjet e tjera janë zhvilluar duke përdorur procedurën e votimit me 'lista të mbyllura', përmes së cilës qytetarët

kanë shprehur preferencat e tyre për partitë politike, e jo për individët përbrenda partive. Zgjedhjet kanë qenë të organizuara nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe mbikëqyrura nga një numër i madh i organizatave monitoruese vendore dhe ndërkombëtare. Të gjitha zgjedhjet konsiderohet se kanë qenë demokratike dhe të ndershme dhe asnjëra prej partive politike kryesore nuk i ka kontestuar rezultatet përfundimtare.

Megjithëse në vitet e para të pas luftës Kosova përparoi shumë sa i përket rindërtimit fizik dhe ndërtimit institucional, tri ditët e demonstratave dhe të trazirave të dhunshme, të organizuara nga minoriteti serb dhe shqiptarët e Kosovës, në mars të vitit 2004, kanë qenë pengesë serioze në procesin e pajtimit politik dhe social. Ato shkaktuan një numër të konsiderueshëm të plagosurve dhe shkatërrim të madh të pronave: 19 njerëz u vranë (shumica të kombësisë shqiptare) dhe afër 900 u lënduan; mbi 700 shtëpi të serbëve, të ashkalijve dhe të romëve u dëmtuan; rreth 4.500 njerëz u zhvendosen. Veç kësaj, 30 kisha serbe dhe dy manastire u dëmtuan ose u shkatërruan.³

Mungesa e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë, është sot faktori kryesor i jostabilitetit. Ndonëse Bruto Produkti Vendor (BPV) për kokë banori është rishikuar kohëve të fundit nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), vlerësimet ende janë shumë të ulëta dhe sillen diku 1.200 euro në vit.⁴ Pas rritjes së shpejtë të shkaktuar nga procesi i rindërtimit në dy vitet e para pas përfundimit të luftës, rritja e BPV-së pas vitit 2002 ka qenë mjaft e ulët (duke lëvizur 3-4% në vit) dhe në të vërtetë ka shënuar rënie në vitin 2005. Vlerësimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në vitin 2004, vlerësuan papunësinë në shkallën prej 22-30% të fuqisë punëtore aktive.⁵ Ndonëse shumë veta i bazuan shpresat e tyre në zhvillim ekonomik përmes privatizimit të ndërmarrjeve punuese shoqërore (NPSH), procesi i privatizimit, i inicuar nga UNMIK-u përmes Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), në vitin 2002 ka qenë i ngadalshëm dhe mjaft shumë i kritikuar nga zyrtarë qveritarë, afaristë dhe veçanërisht nga sindikata e ish punonjësve, pjesa më e madhe e të cilëve sot janë ta papunësuar.

3.1 Konteksti i konfliktit-lufta

Përveç një periudhe të shkurtër gjatë Luftës së Dytë Botërore, Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë, që nga zanafilla e federatës në vitin 1919, edhe pse ushtria dhe policia jugosllave janë përballur me kryengritje të vazhdueshme të armatosura të shqiptarëve të Kosovës. Miratimi i Kushtetutës së vitit 1974, i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), ka qenë një kthesë e madhe për Kosovën. Ajo ka deklaruar Kosovën si Provincë Autonome të Jugosllavisë, duke i gëzuar pothuajse të gjitha të drejtat sikurse republikat e tjera që e përbënin Federatën. Në të njëjtën kohë, janë dhënë kredi nga Banka Botërore, me qëllim të zhvillimit të Kosovës, një rajon që deri tani ka vuajtur nga neglizhenca. Ndërmarrjet Pronësore Shoqërore janë hapur për të zbutur papunësinë, ndërsa, në saje të të hyrave të pashembullta të fondeve, edukimi i lartë në gjuhën shqipe është përhapur shpejt, në të vetmin universitet publik në Kosovë, Universitetin e Prishtinës.

Megjithatë, këtyre investimeve si dhe zhvillimit të rajonit iu afrua fundi pas pesë vitesh, me demonstratat gjithëpërfshirëse të vitit 1981. Kjo ka nisur me shfaqjen e pakënaqësisë nga studentët të cilët kundërshtuan ushqimin që iu servohej në menzën e studentëve, por rrëmuja shpejt u zhvillua në demonstrata përmasash të mëdha kundër rritjes së ngadalshme ekonomike në Kosovë dhe statusit të tyre inferior në republikën e ish- RSFJ-së.

Viti 1989 shënon një fillim të ri për Ballkanin. Slobodan Millosheviqi ka përdorur situatën e tendosur në vend për të nxitur lëvizje nacionaliste serbe brenda RSFJ-së dhe për të fituar fuqi politike, e cila do t'ia fuqizonte sundimin e tij. Ndryshimet politike të viteve të '90-ta janë shoqëruar me rënien e socializmit dhe rritjen e nacionalizmit. Republikat përbërëse të RSFJ-së hynë në luftë me njëra tjetrën, e cila çoi në shpërbërjen e Federatës.

Autonomia e Kosovës u suprimua në mars të vitit 1989, duke nxitur një lëvizje të madhe të rezistencës politike paqësore nga popullata shqiptare kundër regjimit shtypës serb që tashmë ishte rritur. Papunësia në mes shqiptarëve kosovarë u rrit, ngase punëtorët refuzuan që të pranojnë me shkrim bartjen e autonomisë së Kosovës tek Qeveria e re e Serbisë. Gjithashtu, studentëve nuk u është lejuar mësimi në gjuhën shqipe, duke hapur rrugën për struktura paralele në shkolla dhe edukimin e lartë. Për më shumë, njerëzit e rëndomtë janë përballur me kërcënime nga autoritetet serbe. Kjo kohë është karakterizuar edhe për keq menaxhim të ndërmarrjeve në pronësi private dhe shoqërore, ku shumica e NPSH-ve janë privatizuar dhe u janë shitur në mënyrë ilegale kompanive serbe.

Meqë Jugosllavia po shpërbëhej, pasi që Kroacia dhe Sllovenia deklaruan pavarësimin e tyre prej Federatës, elita politike e Kosovës, gjithashtu, shpalli pavarësinë e saj në vitin 1991. Edhe përkundër faktit që kjo nuk është njohur nga pjesa e mbetur e Jugosllavisë (atëherë e quajtur Republika Federale e Jugosllavisë - RFJ), në Kosovë janë mbajtur zgjedhjet paralele, në të cilat zgjedhje Ibrahim Rugova është zgjedhur kryetar.

Edhe përkundër fuqisë së lëvizjes paqësore, kah mesi i viteve të '90-ta, ishte në rritje ndjenja në mes të disa fraksioneve të popullatës shqiptare, se strategjia për rezistencë pasive vetëm po i zgjatë edhe më shumë vuajtjet. Pasi që çështja e Kosovës u la jashtë agjendës së Konferencës së Dejtonit të vitit 1995, që synonte të sjellë paqe në Bosnje, u shfaq rezistenca e armatosur, e njohur si Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Qendra intelektuale dhe organizative e UÇK-së ishte e koncentruar në diasporën zvicerane të

shqiptarëve kosovarë, ndërsa fuqia në Kosovë ishte e vendosur në rajonin më të varfër, në pjesën qendrore dhe perëndimore të Kosovës. UÇK-ja filloi të vepronte përmes sulmeve të vogla kundër forcave të sigurisë së Serbisë në vitin 1995, por u shfaqën publikisht në marsin e vitit 1998, kur ushtarët e maskuar që mbanin uniformën e UÇK-së folën në funeralin e Adem Jasharit, ushtar shqiptar i vrarë nga forcat serbe në shtëpinë e tij, së bashku me afro 50 anëtarët e familjes së tij.

Gjatë periudhës së viteve 1998-1999, luftimet u intensifikuan nga forcat e sigurisë së Serbisë, duke reaguar rëndë dhe shkaktuar jo vetëm humbje në njerëz, por edhe shkatërrime të mëdha të pronave. Armëpushimi në tetor të vitit 1996 ka sjellë dislokimin e Misionit Verifikues në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE-KVM)

Megjithatë, me masakrën e 45 civilëve të fshatit Reçak, në fillim të vitit 1999, komuniteti ndërkombëtar organizoi Konferencën e Rambujesë në shkurt të vitit 1999, me shpresë se do të gjejnë një zgjidhje diplomatike për këtë problem. Ekipi negociator shqiptar ka qenë i përbërë nga përfaqësues të lëvizjes paqësore dhe të UÇK-së. Javier Solana, Sekretar Gjeneral i NATO-s - Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), ka negociuar në të dy anët. Megjithatë, Qeveria e Serbisë nuk është pajtuar me kushtet e vëna nga Grupi i Kontaktit në Rambuje, duke e detyruar kështu NATO-n që pas ultimatumit të vepronte me sulme ajrore kundër Serbisë. Një sërë sulmesh ajrore kundër pikave të rëndësishme strategjike në RFJ, filluan me 24 mars dhe zgjatën 77 ditë. Bombardimet pushuan dhe forcat e Serbisë filluan të tërhiqen menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes teknike ushtarake mes forcave udhëheqëse ndërkombëtare të sigurisë, NATO-s, KFOR-it dhe Republikës Federale të Jugosllavisë, me 9 qershor 1999.⁶

3.2 Kostoja e konfliktit

Lufta e Kosovës ka qenë shumë më e shkurtër se ajo në Bosnje. Megjithatë, dëmet dhe humbjet ishin të mëdha: Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNJ) numëroi më shumë se 8.700 të vrarë dhe mbi 3.500 persona të 'zhdukur'.⁷ Sot, numri i personave të zhdukur ka zbritur në 2.200 – por ende zbulohen varreza masive në Kosovë dhe Serbi. Numri i varrezave masive të gjetura deri më tani është 610, disa prej të cilave ende duhet të hapen. Sipas KMDLNJ-së, vlerësimi i përgjithshëm për viktimat e luftës është 11.000 njerëz, shumica prej të cilëve kanë qenë civilë të paarmatosur. KMDLNJ-ja, po ashtu, thekson se gjatë luftës në vitin 1999, afër 900.000 njerëz ishin dëbuar. Numri i të lënduarve dhe të përdhunuarve është ende i panjohur, por besohet se shifra duhet të jetë e lartë.

Sa i përket dëmeve fizike, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapsinor (MMPH) ka kontrolluar të gjitha vlerësimet ekzistuese dhe ka arritur shifrën prej më shumë se 120.000 shtëpive të shkatërruara pjesërisht ose plotësisht në tërë Kosovën. Nga numri

i përgjithshëm i raportuar për shtëpitë e dëmtuara, afër 100.000 shtëpi janë konsideruar se kanë qenë ‘të dëmtuara rëndë’ (kategoria III, IV dhe V), ndërsa rreth 23.000 kanë qenë ‘më pak të dëmtuara’ (kategoria I dhe II).⁸ Kjo përbën 40% prej gjithësej 300.000 shtëpive të dëmtuara gjatë luftës në Kosovë, siç është vlerësuar nga Enti i Statistikës së Kosovës (ESK).⁹

Dëmi tjetër në Kosovë – në këtë rast, jo i shkaktuar drejtpërdrejt nga lufta – ka qenë ‘fluturimi i kapitalit’ jashtë Kosovës. Kjo ndodhi gjatë viteve të ’90-ta, vite që i paraprinin luftës, kur Jugosllavia po ballafaqohej me krizë monetare. Me falimentimin e shumë ndërmarrjeve shoqërore dhe kollapsit të përgjithshëm të ekonomisë, një numër i bankave në Kosovë falimentuan, duke marrë me vete pjesën më të madhe të depozitave të njerëzve që i kishin siguruar në llogaritë bankare. Në mungesë të parave të mëdha për të financuar luftën e saj në Kroaci dhe në Bosnje, qeveria jugosllave u drejtua në shtypjen e parave, duke shkaktuar një formë spirale të pashembullt të inflacionit dhe duke e shtyrë edhe më tej popullin e vet drejt një ekonomie të hirtë dhe asaj të zezë, të bazuar në para të gatshme – “kesh”.

Më pak e prekshme – por megjithatë tepër e madhe – kostoja e periudhës së aparteidit ishte dëmi i shkaktuar në burimet njerëzore të shqiptarëve të Kosovës. Të lënë jashtë ekonomisë shtetërore për shumë vite, aftësitë e fuqisë punëtore shqiptare të Kosovës ishin gati të shkatërroheshin. Ekonomia e vogël, e bazuar në tregti, që u shfaq në sektorin privat, kishte kapacitet të vogël t’i rris madje aftësitë ekzistuese, e jo më që të investojë në ngritjen e tyre. Në anën tjetër, ndërmarrja më fisnike, sistemi paralel i arsimit, thjesht nuk kishte burime të mjaftueshme për të mbajtur cilësi të njejtë të arsimit, rezultat i së cilës ishte se një gjeneratë e tërë e të rinjëve të Kosovës, që diplomuan në shkolla të larta dhe universitete - janë me aftësi nën nivelin e duhur. Efektet e kësaj janë të dukshme edhe sot në ekonominë e zhvlerësuar të Kosovës.

3.3 Korrupsioni dhe konflikti

Është vështirë të dihet lloji i saktë i korrupsionit dhe niveli i korrupsionit gjatë viteve 1990, për dy arsye. E para lidhet me mungesën e të dhënave për këtë çështje, sepse, gjatë kësaj periudhe janë bërë shumë pak studime. Arsyeja e dytë është konceptuale, dhe ka të bëjë me legjitimitetin e veprimeve të përkrahësve të lëvizjeve së rezistencës në Kosovë dhe bashkëveprimeve të tyre me autoritetet Serbe të asaj kohe. Thënë shkurt, duke ditur se sistemi paralel social, ekonomik dhe politik, i organizuar nga shumica e popullatës shqiptare gjatë viteve 1990, nuk është njohur kurrë nga autoritetet serbe, veprimet rezistuese të ndërmarra brenda këtij konteksti, gjithmonë janë konsideruar të paligjshme dhe potencialisht korruptive sipas një pikëpamjeje zyrtare. Kështu, për shembull, departamenti paralel i arsimit, për të importuar libra nga Shqipëria, duhej t’i korruptonte zyrtarët policorë të doganave serbe. Megjithatë, veprimet e tilla janë konsideruar si të pranueshme dhe të nevojshme nga udhëheqësit dhe popullata e gjërë shqiptare e Kosovës, të cilët kanë qenë të vendosur për të siguruar shkollimin në gjuhën amtare për fëmijët e tyre (perceptione të ngjashme, po ashtu, janë aplikuar edhe për kontrabandimin e armëve nga UÇK-ja, prej Shqipërisë në Kosovë, me qëllim të luftimit të regjimit serb).

3.4 Pasojat e konfliktit

Pas përfundimit të luftës, shumica e serbëve etnikë, që kanë qenë në shërbim të qeverisë gjatë viteve të '90-ta, e lëshuan Kosovën – sipas llogarive një e treta e tërë popullësisë serbe të para-luftës në Kosovë. Ata që kanë mbetur tani jetojnë kryesisht në enklava rurale dhe, në përgjithësi, nuk marrin pjesë në institucionet publike të Kosovës.

Vakumi i mbetur nga largimi i zyrtarëve serbë, fillimisht është plotësuar me grupimet e afërta me UÇK-në, të cilët filluan t'i rimarrin qeveritë lokale dhe pronat publike si 'shpërblim' që kishin luftuar në luftë. Megjithatë, me afër 60.000 trupa të NATO-s, të shpërndarë në Kosovë, si dhe UNMIK-un e vendosur menjëherë pas luftës, fuqia përkatëse e PDK-së, parti e afërt me UÇK-në, ngadalë u zvogëlua.

Në vitin 2000, UNMIK-u themeloi të ashtuquajturat Struktura të Përbashkëta të Përkohshme të Kosovës (SPPK), të cilat është menduar t'i bëjnë bashkë të gjitha partitë e mëdha dhe pjesëmarrësit e tjerë, derisa do të mund të mbaheshin zgjedhjet e duhura. Kah fundi i viti 2000, janë mbajtur zgjedhjet e para komunale dhe, për habi të disa analistëve politikë, LDK-ja, e afërt me lëvizjen paqësore, fitoi shumicën në një numër të madh të asambleve komunale dhe rimori pozitën qendrore në arenën e partive politike të Kosovës.

Megjithatë, ndonëse shqiptarët e Kosovës formalisht zëvendësuan serbët etnikë në pozitën institucionale, pushteti i vërtetë politik vazhdoi të mbetet në UNMIK-un. UNMIK-u filloi hartimin e ligjeve të aplikueshme me nxjerrjen e rregulloreve të reja, megjithëse ka lejuar, po ashtu, zbatimin e ligjeve para vitit 1989, të cilat ishin në konflikt me ligjet e tij të reja. UNMIK-u, po ashtu, ishte përgjegjës për përcaktimin dhe formimin e plotë të ndërtimit institucional në Kosovë, prej Kornizës Kushtetuese gjer te Ligji Zgjedhor. Megjithatë, sa i përket funksionimit të përditshëm të vendit, aftësia e UNMIK-ut për të detyruar zbatimin e ligjit ka qenë gjithmonë mjaft e dobët. Gjithashtu, zbatimi i ligjit ka mbetur i pakët, madje edhe pas bartjes së kompetencave shtesë tek Strukturat e Përbashkëta të Përkohshme (SPPK), të njohura si Qeveria e Kosovës.

3.5. Donatorët dhe financimi

Fondet e para në Kosovë arritën madje para përfundimit të bombardimeve të NATO-s, kur në vitin 1998, Qeveria e SHBA-ve, përmes departamenteve të saj të ndryshme, filloi shpërndarjen e ndihmave humanitare në ushqim. Për shembull, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID), prej marsit të vitit 1998 ofroi 67 milionë dollarë amerikan, si ndihmë ushqimore përmes Zyrës për Ushqim dhe Paqë, për t'i zvogëluar nevojat urgjente të refugjatëve të Kosovës.¹⁰ Komisioni Evropian (EC) në vitin 1999 përpiloi një plan veprimi për Kosovën, me 127 milionë euro, që do të shpenzoheshin në vitin 1999 përmes Grupit Punues të EC për rindërtimin e Kosovës (më vonë i zëvendësuar nga Agjencia Evropiane e Rindërtimit (EAR)).¹¹

Në mes të qershorit të vitit 1999 dhe dhjetorit të vitit 2004, donatorët ndërkombëtarë zotuan 2.572 milionë euro për Kosovën, prej të cilave 2.514 milionë euro ishin të kontraktuara, kurse 2.215 milionë euro ishin shpenzuar.¹² Duke e pjesëtuar shumën e përgjithshme të parave të shpenzuara në Kosovë pas luftës, në periudhën 5.5 vjeçare, gjatë së cilës paratë janë investuar (korrik 1999-dhjetor 2004), me numrin e përafërt të popullësisë në Kosovë, 1.86 milionë njerëz, ne nxjerrim shifrën e ndihmës për kokë banori në Kosovë, që është 217 euro në vit.¹³

Shuma e përgjithshme e donacioneve në Kosovë ka arritur kulmin e vet në vitin 2000, dhe që atëherë e tutje - donacionet çdo vit u zvogëluan përgjysmë. Më shumë se 400 milionë euro janë shpenzuar në vitin 2002, krahasuar me vetëm 150 milionë euro në vitin 2004.

Gjatë fazës emergjente, donacionet më të mëdha shkuan në ‘Banim dhe shërbime publike’. Prej 361.7 milionë euro të shpenzuara gjatë viteve 1999-2004 për ‘Banim’, 341 milionë janë shpenzuar gjatë vitit 2002.¹⁴ Gjatë viteve 1999-2004, ‘Shërbimet publike’ morën më shumë se 650 milionë euro, kurse ‘Bujqësia’ mori rreth 110 milionë euro. Megjithëse investimet në bujqësi duken të larta, është vetëm çereku i shumës së investuar në vetëm një shërbim publik, në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK); janë të ulëta posaçërisht kur të merret parasysh se 60% e popullësisë së Kosovës jeton në zona rurale. Veç kësaj, rezultatet e investimeve në bujqësi nuk janë përgjithësisht të kënaqshme: programet e bujqësisë, të zhvilluara nga donatorët, u mundësuan disa familjeve të jetojnë nga prodhimet e tyre bujqësore, por nuk kanë nxitur ndonjë zhvillim të qëndrueshëm në bujqësi. Për shembull:

‘Në vitin 2000, në Kosovë janë sjellë rreth 10.000 lopë dhe u janë dhënë familjeve. Ato ose janë shfytëzuar për qumësht për familje, për t’a shitur dhe blerë pajisje shkollore për fëmijët, ose i kanë shfytëzuar si mish për dimër – duke u shërbyer për disa muaj si zgjidhje për familjet. Ndonjëherë lopët ngordhnin edhe para se të mund të therreshin, duke qenë se ishin të një race shumë të mirë dhe familjet e Kosovës nuk ishin në gjendje t’i ushqenin si duhet. Po qe se këto 10.000 lopë do t’u ishin dhënë 100 bujqëve, ne supozojmë se më shumë se gjysma e tyre nuk do të kishin sukses, sot ne do të mund të kishim **së paku** 10 ferma të mira në Kosovë dhe nuk do të kishim nevojë që ende të importojmë qumësht, djath dhe kos’¹⁵

Shërbimet publike gjer më sot mbesin zona kryesore e përqendrimit me më shumë se gjysmën e buxhetit të shërbimeve publike që i shkon KEK-ut. Donatori më i madh i KEK-ut është AER-i, i cili vazhdon të kontraktojë kompani evropiane që të punojnë në KEK, me shumë pak ose aspak rezultate. Që nga viti 1999, donacionet në KEK kanë qenë shumë të diskutueshme, me shumë të dhëna për korrupsion në mediat vendore dhe ndërkombëtare.¹⁶

Prej vitit 1999 – 2000, e deri në vitin 2004, donatorët e ndërruan zonën e fushëveprimit varësisht nga kombinimi i shumë faktorëve. Siç e thotë një analist:

‘Sektorët prioritarë janë përcaktuar kryesisht në bazë të vlerësimit paraprak për dëmtimet e luftës, të bëra nga shtetet, donatorët dhe organizatat e ndryshme. Megjithatë, preferencat për zonat në të cilat donatorët donin të investonin, vareshin shumë nga ajo se ku ishin të vendosur trupat e KFOR-it të vendit të atij donatori. Kjo ishte e rëndësishme për arsye të sigurisë, sidomos në atë kohë, kur projektet ishin të vështira dhe trupat e KFOR-it u shfrytëzuan si zbatues në terren’¹⁷

Si rezultat i kësaj, rajonet si Drenica, ku ishin të vendosura trupat ruse të KFOR-it, morën shumë pak donacione, në krahasim me rajonet si Gjilani ose Prizreni, ku ishin të vendosura trupat e SHBA-ve dhe ato gjermane.¹⁸

Në fillim, donatorët u përqendruan në tejkalimin e situatës emergjente, përmes ofrimit të granteve dhe ndihmës teknike. Donacionet e shfrytëzuara si investime kapitale u zvogëluan pas vitit 2003, kur fokusi kaloi në ndërtim të kapaciteteve për ‘qeverisje’ dhe trajnime për ‘demokraci’. Zyrtarët në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave (MEF) kanë konfirmuar se donacionet në Kosovë, në përgjithësi, tani po zvogëlohen, me më së shumti fonde të shpenzuara gjatë fazës emergjente, kur fokusi ka qenë në rindërtimin fizik. Sipas tyre: ‘Sot, Kosova është duke pranuar ndihmë teknike dhe ngritje të kapaciteteve për legjislacion, administrim publik dhe të tjera, përmes këshilltarëve dhe ekspertëve të jashtëm. Ky ndryshim ndodhi në fund të vitit 2002 dhe në fillim të vitit 2003’.¹⁹ Kjo, po ashtu, është konfirmuar nga shuma e parave të shpenzuara në qeverisjen demokratike dhe shoqërinë civile. Në vitin 2002, më pak se 9% e shumës së përgjithshme të donacioneve është shpenzuar në këtë fushë, ndërsa në vitin 2004 llogaritej më shumë se 20% e shumës së përgjithshme të shpenzimeve të donatorëve.²⁰

Gjatë fazës zhvillimore, duket se ka qenë një tendencë e donatorëve t’i mbi-financojnë disa sektorë, duke i lënë anash disa sektorë të tjerë. Ish bashkëkryesuesi i Departamentit të Rindërtimit në kuadër të UNMIKU-ut, shprehu pakënaqësinë që donatorët pothuajse krejtësisht kanë anashkaluar sektorët si bujqësia dhe edukimi, kurse i kanë mbi-fokusuar dhe mbi-financuar sektorët si mediat dhe demokratizimin. Siç e tha ai: ‘Demokratizimi është me të vërtetë i rëndësishëm, jetik. Por, me gjithë këto para të derdhura në iniciativat e shoqërisë civile, derisa shtyllat kryesore të shoqërisë demokratike – edukimi, policia, drejtësia, trajnimet e shërbimit publik – duket se kanë qenë shumë pak të financuara, duket...goxha e çuditshme’.²¹

Edukimi, pamëdyshje, ka qenë shumë pak i financuar, duke tërhequr vetëm 6% dhe 5% nga paratë e përgjithshme të donatorëve në vitin 2002, përkatësisht në vitin 2004.²² Kjo bie ndesh me përpjekjet e bashkësisë së donatorëve për t’i ngritur kapacitetet vendore duke sjellur këtu ekspertë dhe të këshilltarë ndërkombëtarë.

3.6 Rindërtimi i vendit

Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989, sistemi ekzistues politik ishte ndarë në dysh. Të përjashtuar nga strukturat qeveritare, shqiptarët filluan t’i

krijojnë institucionet paralele politike dhe shoqërore, të organizuara jashtë dhe brenda në Kosovë. Institucionet zyrtare kontrolloheshin nga serbët etnik.

Me përfundimin e luftës në qershor të vitit 1999, autoritetet serbe në Kosovë u larguan për në Serbi, duke e lënë kështu Kosovën pa asnjë strukturë qeveritare në vend. Zbrastësia shpejtë ishte plotësuar me stukturat lirshëm të organizuara që dolën nga UÇK-ja. Ata u përpoqën ta drejtojnë ligjin dhe rendin paralelisht me forcat e KFOR-it dhe administratën e KB-së që ishte në formim e sipër, UNMIK-un, që ballafaqohej me një varg vështirësish në ditët e para të tij. Për shembull, kur shtatë punëtorë të BE-së arritën në qershor të vitit 1999, ‘njerëzit në Bruksel ishin në pushime dhe nuk mund t’i ndihmonin ata. Ata nuk mundën madje t’i shfrytëzojnë as zyrtat dhe pajisjet e KB, kështu duhej që ata ta themelojnë një zyrë të BE-së’.²³ Përfundimisht, UNMIK-u ishte i organizuar në katër shtylla: Shtylla I – Policia dhe Drejtësia, Shtylla II - Administrata Civile, Shtylla III – Demokratizimi dhe Ndërtimi i Insitucioneve (i udhëhequr nga Organizaata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – OSBE) dhe Shtylla IV – Rindërtimi Ekonomik dhe Zhvillimi (i udhëhequr nga Misioni i BE-së në Kosovë dhe i financuar nga Komisioni i BE-së).

Në janar të vitit 2000, UNMIK-u filloi krijimin e institucioneve të para zyrtare të qeverisjes lokale dhe të institucioneve administrative, Strukturat e Përbashkëta të Përkohshme Administrative (SPPA), duke sjellur në këtë mënyrë një fund zyrtar të ‘të gjitha strukturave të tjera të Kosovës të një karakteri ekzekutiv, legjislativ ose gjyqësor’.²⁴ SPPA drejtohej nga Këshilli i Përkohshëm Administrativ, i përbërë nga anëtarë të shoqërisë së Kosovës dhe të UNMIK-ut, me detyrë për t’i dhënë PSSP-së rekomandime për rregulloret e reja. Megjithatë, fakti se të gjitha vendimet e rëndësishme legjislative dhe ekzekutive vazhduan të merren ekskluzivisht nga përfaqësuesit e UNMIK-ut, krijoi tensionim në mes të përfaqësuesve vendor të SPPA-së.

Në vitin 2001, UNMIK-u hartoi dhe nxori Kornizën Kushtetuese për Kosovën, e cila shërbeu si bazë për krijimin e IPVQ-ve – stukturat e para politike dhe nacionale të zgjedhura në Kosovën e pasluftës.²⁵ IPVQ-të u themeluan për të zëvendësuar SPPA-të dhe për të marrë më shumë përgjegjësi në qeverisjen e Kosovës. Kështu, në vitin 2002, 14 departmanetet e SPPA-ve – përfshirë shëndetësinë, arsimin, financat dhe zhvillimin ekonomik, çështjet civile, kulturën e të tjera—u shkrinë dhe u transformuan në ministritë e qeverisë.

Megjithatë, ndonëse në pushtet erdhi një qeveri e zgjedhur, PSSP-ja ende kishte fjalën e fundit për secilin ligj të propozuar, po ashtu për miratimin përfundimtar të Buxhetit të Kosovës, të politikave monetare, në shpërbërjen e Kuvendit të Kosovës e të tjera. Kështu, Kosova ishte e udhëhequr nga të dyjat: nga strukturat e zgjedhura politike dhe nga stukturat administrative, jo të zgjedhura – të dytat mbikëqyrnin të parat.

Një aspekt tjetër vendimtar në procesin e ndërtimit të institucioneve ishte krijimi i Buxhetit të Konosliduar të Kosovës (tash e tutje ‘Buxheti i Kosovës’), i cili përbëhej nga të dyjat, paratë e gjeneruara në vend dhe nga fondet e donatorëve. Përbërja e Buxhetit të Kosovës ndryshoi nëpër vite: në disa vite të para buxheti varej shumë nga

paratë e donatorëve, por që nga viti 2002/2003 buxheti pothuajse i tëri financohej nga të hyrat vendore, veçanërisht nga taksat doganore.

3.7 Çështjet e rindërtimit – koordinimi i donatorëve

Përprojekjet e para të koordinimit të donacioneve të dedikuara për rindërtimin e Kosovës së pasluftës, në vitin 1999 rezultuan me themelimin e zyrës së përbashkët të Komisionit të UE-së dhe Bankës Botërore, e vendosur në Bruksel. Ata kishin përgatitur një program të detajuar për rindërtim, i cili duhej të ndiqej nga të gjithë donatorët e kyçur në procesin e rindërtimit në Kosovë. Programi për rindërtimin dhe ripërtëritjen e Kosovës ishte paraqitur në nëntor të vitit 1999. Ata po ashtu organizuan dhe bashkëdrejtuan dy konferencat e donatorëve në korrik dhe në dhjetor të vitit 1999, të cilat ishin vendimtare në mobilizimin dhe drejtimin e përkrahjes së madhe të donatorëve.²⁶

Të ballafaquar me shumë sfida të tjera urgjente, vetë UNMIK-u fillimisht ishte i ngadalshëm për t'i dhënë udhëzime gjithëpërfshirëse dhe koherente komunitetit të donatorëve. Më vonë, në fund të marsit të vitit 2000, e themeloi Departamentin e Rindërtimit (DoR). Departamenti i rindërtimit ka pasur njësinë për koordinimin e donatorëve, e cila ishte pjesë e shtyllës së UE-së, dhe ka qenë përgjegjëse për mbledhjen e informatave nga donatorët, koordinimin e investimeve të donatorëve, përgatitjen e buxheteve dhe 'Planeve për Investime Publike' për të drejtuar programet e donatorëve.

Megjithatë, prezenca e DoR-it nuk mblodhi fuqinë e donatorëve për të vendosur se ku dhe si duhet të shfrytëzohen fondet e tyre. Në të vërtetë, në atë kohë, DoR kishte mungesë të kapaciteteve për t'i koordinuar në mënyrë të duhur përprojekjet e donatorëve ose të vazhdojë më tutje sipas rekomandimeve të donatorëve për rindërtim. Siç ka vlerësuar vet DoR, pavarësisht qëllimit të mirë, ka pasur mungesë të udhëzimeve strategjike nga UNMIK-u, si dhe ngurrim në shpërndarjen dhe shkëmbimin e informatave për përprojekjet e donatorëve. Koordinimi në sektorë të caktuar ka qenë shumë më i mirë; megjithatë, nuk është zbatuar në të gjithë sektorët.

Departamenti i Rindërtimit kishte kaluar te IPVQ-të, dhe në vitin 2002 u zëvendësua me Sektorin për Koordinim me Donatorë në Kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave (MEF). Disa organizata/donatorë ndërkombëtarë u ankuan për mungesën e plotë të përkushtimit nga ky institucion, duke thënë se në vitin 2002 sektori ka funksionuar shumë më mirë se tani. Ndoshta një pjesë e problemit qëndron në faktin se Sektori për Koordinim me Donatorë është paraqitur si joefikas për shkak të shumë ndryshimeve në personel dhe të një vargu të menaxherëve dhe drejtorëve të përkohshëm. Në anën tjetër, personeli në Sektorin për Koordinim me Donatorë beson se problemi kryesor qëndron në faktin se donatorët nuk kanë qenë kurrë të obliguar t'i raportojnë Qeverisë së Kosovës për aktivitetet e tyre dhe Qeveria gjithmonë ka mirëpritur çdo involvim të tyre, pa vënë kurrë asnjë kriter për raportim.²⁷

Organizata të tjera, po ashtu, u përpoqën t'i koordinojnë disa aktivitete të donatorëve, por e kanë bërë këtë 'nga ulësja e prapme', sepse ata mendonin se udhëheqja mbi

koordinimin e donatorëve duhet të jetë detyrë e Sektorit për Koordinimin e Donatorëve, në kuadër të MEF-it. Për shembull, AER-i koordinoi përkrahjen e donatorëve sektorial në mes të shteteve anëtare të BE-së, përmes takimeve mujore, ku përfshiheshin edhe IPVQ-të, të cilat i paraqitnin shqetësimet dhe prioritetet e tyre për investime. Siç thotë një zyrtar: ‘zakonisht këto takime organizoheshin kur AER-i tashmë po hynte në fazën e implementimit të projekteve. Megjithatë, periudha më e rëndësishme e konsultimeve është gjatë planifikimit të planit veprues për vitin pasues, ku ne i ftojmë donatorët t’i paraqesin planet e tyre, në mënyrë që të shmangim dublimin me projektet tjera’.²⁸

Ndoshta vlerësimi më i mirë është dhënë nga zëvendës drejtori i USAID-it, i cili e ka parë koordinimin e donatorëve gjithmonë të zënë në mes dy zjarresh. Siç e thotë ai: ‘në njërën anë, donatorët nuk duan të koordinohen, kurse në anën tjetër ata nuk dëshirojnë ti humbin mjetet...Si rezultat i kësaj është një mospërputhje në mes të asaj çka është thënë për koordinimin e donatorëve dhe çka ju shihni në të vërtetë’.²⁹ Sipas tij, në fund të ditës, dublimi kyresisht është shmangur përmes kontakteve personale të udhëheqësve të donatorëve - të cilët zakonisht e dinë- ose lehtë mund ta kuptojnë përmes një bisede telefonike, se çka është duke bërë secili prej tyre në terren.

Si përfundim, ndonëse përpjekjet e donatorëve kanë kontribuar mjaft në rindërtimin ekonomik dhe social të Kosovës, ndihma e tyre ka qenë e pa koordinuar dhe fondet e tyre nuk janë menaxhuar në kuadër të procesit të Buxhetit të Kosovës. Përgjithësisht, donatorët kanë diskutuar për nevojat dhe financimin me organizatat e veçanta buxhetore në mënyrë të njëanshme, por shpesh kanë lënë mundësinë që shpenzimet e tjera për projektin (p.sh. mirëmbajtja) të absorbohen nga Buxheti i Kosovës, pas përfundimit të projektit. Kjo shpesh ka ndodhur pa paralajmërim paraprak të Buxhetit të Kosovës, me një ndikim të mundshëm dhe të padëshirueshëm në ridestinimin e fondeve të parapara për personel dhe mirëmbajtje, për qëllime tjera. Në fund, ndonëse disa informata janë marrë sa i përket shpenzimeve të planifikuara të donatorëve, historikisht MEF-i ka mundur vetëm që më pas ta përcjellë rrjedhën e mjeteve të donatorëve.³⁰

4. Profili i korrupsionit

Një analizë e studimeve të ndryshme që masin perceptcionet për korrupsionin në Kosovën e pasluftës ka gjetur se, në krahasim me vendet e tjera në rajon, shoqëria kosovare është mjaft tolerante kur është fjala për korrupsionin - vetëm në Shqipëri, Maqedoni dhe Kroaci, toleranca kulturore për korrupsionin është më e lartë.³¹ Në të vërtetë, disa veprime që në kushte normale do të kosideroheshin si korruptim, nuk janë parë të jenë të tilla nga një përqindje domethënëse e shoqërisë kosovare.³² Për shembull, 29% e responentëve nuk e kanë ditur se është korrupsion t’i bindësh të tjerët të punësojnë një shok ose ndonjë të afërm, 35% mendojnë njëjtë sa i përket dhënies së dhuratave për mjekë, si falenderim për kujdesin e veçantë mjekësor, ndërsa 34% menduan se është e arsyeshme për t’u dhënë zyrtarëve dhurata me qëllim të marrjes së lejes ndërtimore.³³

Pagat e ulëta janë identifikuar si shkaktari kryesor i korrupsionit, sipas studimit të UNDP-së të vitit 2004 për perceptimin publik për korrupsionin. Afër 50% e të intervistuarve nga UNDP-ja besojnë se pagat e ulëta të zyrtarëve publikë janë shkaku kryesor i korrupsionit. Përpos pagave të ulëta, mungesa e sundimit të ligjit është identifikuar nga komuniteti afarist si shkaktari kryesor i korrupsionit (29%).³⁴

Megjithëse këta dy faktorë mund të jenë më të rëndësishmit në nxitjen e korrupsionit në Kosovë, situata është pa dyshim e rënduar nga sistemi politik aktual dhe veçanërisht nga karakteri i dyfishtë i tij. E para, fuqia dhe ndikimi i partive të ndryshme politike që ndërhyjnë në punët ditore të institucioneve të ndryshme qeveritare – prej ekzekutivit dhe legjislativi, deri te gjyqësia – duke penguar në këtë mënyrë kontrollimet dhe vlerësimet e nevojshme. Për shembull, kur opozita në Kuvendin e Kosovë kërkoi që të formohet një komision për hetimin e, me sa duket, një transferi të dyshimtë ndërministror të parave, parlamentarët që përfaqësonin partitë në pushtet, thjeshtë e rrëzuan me vota propozimin dhe komisioni nuk u formua kurrë. E dyta, autoriteti bazë i UNMIK-ut, është shfrytëzuar nga shumë politikanë vendorë si një arsyetim për të mos i marrë përgjegjësitë kur paraqiten problemet (edhe në fushat me kompetenca të transferuara) dhe të mos jenë transparent në kërkesat/nevojat e qytetarëve.³⁵

Në Kosovë, perceptimi se korrupsioni ekziston në të dy nivelet, atë qendror dhe lokal, i dyti përfshin shuma më të vogla të parave dhe më shumë korrupsion ‘të vogël’ për shërbime të ndryshme publike, si shëndetësia dhe arsimit. Të gjitha studimet e shqyrtuara në këtë analizë tregojnë se shërbimet publike, posaçërisht KEK-u dhe Posta dhe Telekomit i Kosovës (PTK), janë dalluar si shumë të korruptuara. Komuniteti i biznesit ka identifikuar si shumë të korruptuar AKM-në (64% e respondentëve), UNMIK-un (49%), doganat (48%), organizatat ndërkombëtare (40%), gjykatat (38%) dhe sistemin shëndetësor (38%). Prej njerëzve që kanë shfrytëzuar shërbimet e gjykatave, 57% besojnë se korrupsioni është ‘prezent shumë ose në një masë’ në gjyqësinë e Kosovës.³⁶

Duhet të potencohet se, sipas të gjitha studimeve të shqyrtuara, *përvojat* personale të respondentëve me korrupsionin janë dukshëm më të vogla se perceptimi i tyre për korrupsionin. Në mes të publikut të përgjithshëm të shqiptarëve të Kosovës, niveli i korrupsionit i sprovuar drejtpërdrejt rritet prej 12% - në mes të vitit 2004, në 18% në kohën e njëjtë të vitit pasues, për t’u ulur në 14% - vetëm në fund të vitit 2005. Studimet me komunitetin e biznesit tregojnë se raporti në mes të korrupsionit të perceptuar dhe atij të sprovuar është gati dy herë më i lartë se me publikun e përgjithshëm.³⁷

Përfundimisht, është vështirë të maten shpenzimet financiare të korrupsionit, duke qenë se asnjë studim serioz nuk ka tentuar ta bëjë këtë. Mund të argumentohet se shpenzimet politike të korrupsionit kanë qenë të ulëta, sepse asnjë parti politike deri më tani nuk i ka humbur zgjedhjet si rezultat i perceptimit të publikut për korrupsionin. Gjithashtu, ndihma ndërkombëtare në Kosovë, asnjëherë deri më sot nuk është kushtëzuar në bazë të luftimit të korrupsionit, dhe nuk është refuzuar në baza të tilla.

5. Aktivitetet kundër korrupsionit

5.1 Qeveria

Si pjesë e agjendës ‘Standardet për Kosovën’, një ndër masat e para të Qeverisë së Kosovës për të luftuar korrupsionin në 2003, ishte themelimi i Zyrës për Qeverisje të Mirë pranë zyrës së Kryeministrit. Detyrë kryesore e kësaj zyreje në atë kohë ishte hartimi i Strategjisë së Kosovës kundër korrupsionit. Qëllimi kryesor i strategjisë ishte të krijohet ‘një mjedis të përshtatshëm ligjor dhe institucional për parandalimin dhe zhdukjen e korrupsionit’ e po ashtu të instalojë kulturën kundër korrupsionit në Kosovë. Sipas kësaj strategjije, Kuvendi i Kosovës ishte ngarkuar për të miratuar Ligjin Kundër Korrupsionit, ndërsa Qeveria, në konsultim me institucionet e UNMIK-ut, do të miratonte një Plan të Veprimit kundër Korrupsionit.³⁸

Në vitin 2005, Kuvendi i Kosovës nxori Ligjin për Zhdukjen e Korrupsionit, si dhe një numër të ligjeve të tjera me qëllim të dekurajimit të korrupsionit dhe përmirësimit e integritetit të institucioneve publike, siç është Ligji për Pengimin e Larjes së Parave dhe Ligji për Prokurimin Publik.

Ligji për Zhdukjen e Korrupsionit parasheh themelimin e Agjencisë Anti-Korrupsion, e cila do të udhëhiqet nga një drejtor, i cili duhet të jetë banor i përhershëm i Kosovës. Drejtori emërohet nga Kuvendi i Kosovës, me propozimin e së paku dy kandidatëve nga Këshilli i Agjencisë Anti-Korrupsion, dhe duhet të zgjedhet brenda 60 ditëve pasi që Ligji të jetë shpallur nga PSSP-ja. Këshilli duhet të jetë një trup i pavarur mbikëqyrës, i përbërë nga nëntë anëtarë, tre prej të cilëve janë të emëruar nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa të tjerët, nga një, janë të emëruar nga institucionet në vijim: Zyra e Presidentit, Qeveria, Gjykata Supreme, Zyra e Prokurorit Publik, autoritetet lokale dhe shoqëria civile.³⁹

Agjencia është përgjegjëse për vëzhgimin e punës së institucioneve vendore, përfshirë edhe njësitë e tyre të prokurimit dhe për mbikëqyrjen e pasurive dhe dhuratave të marra nga zyrtarë publik dhe familjet e tyre. Me ligj, Agjencia është e obliguar të përcjellë çdo informatë që ka të bëjë me shkeljet e mundshme korruptive tek Zyra e Prokurorisë Publike, për procedura të mëturjeshme, dhe duhet të zhvillojë hetime administrative lidhur me akuzat e supozuara për korrupsion në ato raste kur nuk inicohet procedurë penale.

Megjithatë, kredibiliteti i Agjencisë Anti-Korrupsion është penguar që në fillim. Mospajtimet politike përbrenda Kuvendit të Kosovës nënkuptojnë se u desh më shumë se gjysmë viti për emërimin e tre anëtarëve të parë të Këshillit të Agjencisë.⁴⁰ Emërimi i drejtorit ishte edhe më i vështirë, procedurë që mori më shumë se një vit pas adoptimit të Ligjit për Zhdukjen e Korrupsionit. Në të vërtetë, Agjencia edhe tani nuk është plotësisht funksionale, duke vepruar prej një zyreje të vogël në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës dhe pritet të punësojë 7-8 zyrtarë vetëm pas vitit 2007.⁴¹

Gjithashtu, madje edhe vet anëtarët e Këshillit të Agjencisë Anti-Korrupsion, janë skeptik sa i përket efikasitetit të mundshëm të kësaj agjencie, duke u thënë se ‘kjo thjesht është një agjenci simbolike, e themeluar thjesht për ta bindur opinionin publik se Qeveria është duke bërë diçka, kurse në të vërtetë askush nuk është i interesuar ta luftojë korrupsionin’.⁴² Një anëtar tjetër pohon se, sipas mendimit të tij, anëtarët e tjerë janë emëruar më shumë për besnikëritë e tyre politikë se sa për qëndrimet e tyre kundër korrupsionit, të cilat sjellin në pyetje pavarësinë e institucioneve. Megjithatë, ai dyshon mjaft nëse Agjencia ndonjëherë do të mund të funksionojë siç duhet, nëse gjyqësia dhe policia nuk i ofrojnë mbështetjen e duhur.

5.2 Donatorët

USAID-i ka qenë një donator i rëndësishëm për grupet e shoqërisë civile, të cilat kanë qenë të gatshme të angazhohen kundër korrupsionit. Në vitin 2002, themeloi Organizatën Joqeveritare të Kosovës (OJQ), Projekti për Avokim (KNAP) – program fillestar për grante kundër korrupsionit për OJQ-të me seli në Kosovë, të cilat ishin të gatshme për të udhëhequr në parandalimin e korrupsionit. Kohëve të fundit më shumë ka përkrahur themelimin e OJQ-së ‘Çohu’ – Organizatë për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, e cila përpiqet ta luftojë korrupsionin në institucionet qeveritare përmes ngritjes së vetëdijësimit publik.

Përkrahja e AER-it në aktivitetet kundër korrupsionit, ka qenë e fokusuar kryesisht në financimin e njësive të specializuara për hetime, siç është Njësia për Hetime Financiare (FIU) – drejtpërdrejt e vendosur nën shtyllën e parë të UNMIK-ut, që mbulon Policinë dhe Gjyqësinë, e cila që nga viti 2003 ka pasur mandatin për të kryer kontrollime financiare të organeve publike, të ndërmarrjeve publike si dhe të organizatave të tjera që marrin fonde publike, e po ashtu ka pasur fuqinë të iniciojë hetime penale. FIU-ja mori ndihmë nga KE-së prej marsit të vitit 2004 deri në vitin 2006, dhe në vitin 2005 buxheti i vet ishte 0.7 milionë euro. Përndryshe, AER-i alokoi 1.3 milionë për forcimin e kapaciteteve të Kosovës në luftimin e shpërlarjes së parave dhe korrupsionit. Përfundimisht, AER-i ka qenë, po ashtu, pjesëmarrës i rregullt në takimet e Grupit Punues Ndërkombëtar (ITF), organ i përkohshëm i cili po ashtu përfshinte FIU-në, Zyren Evropiane Kundër Mashtrimeve (OLAF) dhe Zyren e KB-së për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Brendshme.⁴³

Së bashku me Zyren për Qeverisje të Mirë, të Zyrës së Kryeministrit, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ndërmori një studim me qytetarë për luftimin e korrupsionit, që kishte për qëllim të pasqyrojë qëndrimet e qytetarëve për shkallën dhe llojin e korrupsionit në Kosovë dhe të ndihmojë zbatimin e Strategjisë Anti-Korrupsion të Qeverisë.⁴⁴

Megjithatë, suksesi i këtyre aktiviteteve të donatorëve në NIS-in e Kosovës është diskutabil. Në njërën anë, është vështirë të matet ndikimi i fushatave në ngritjen e vetëdijes publike sa i përket niveleve të tanishme të korrupsionit në institucionet publike. Në anën tjetër, njësitë hetimore speciale për antikorrupsion, siç është FIU-ja, kanë shënuar relativisht pak rezultate në luftimin e korrupsionit. FIU-ja në të vërtetë ka përcjellë hetime të profilit të lartë, që kanë të bëjnë me menaxherët e vjetër të PTK-

së dhe zyrtarët e UNMIK-ut. Sidoqoftë, ‘pas disa muajve të hetimeve, rasti papritmas është mbyllur – edhe pse mediat publikuan kopjet e kontratave që qartazi paraqisnin shumë parregullësi.’⁴⁵

6. Sistemi i integritetit nacional

6.1. Ekzekutivi

Ekzekutivi i parë në Kosovën e paslutës u formua për disa muaj në fund të vitit 2001 dhe në fillim të vitit 2002. Pasi nxjerrja e Kornizës Kushtetuese, Rregullorja për Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse dhe zgjedhjet e para nacionale në vitin 2001. Madhësia e ekzekutivit të Kosovës dhe fusha e kompetencave të tij ndryshuan gjatë kohës, me transferimin gradual të kompetencave të rezervuara nga UNMIK-u dhe PSSP-ja tek IPVQ-të.

Përveç Kryetarit të Kosovës (të zgjedhur nga Kuvendi) dhe Kryeministrit, fillimisht, ekzekutivi përbëhej vetëm prej nëntë ministrive, dy prej të cilave kanë qenë të rezervuara për përfaqësuesit e komunitetit pakicë.⁴⁶

Është me rëndësi të ceket se funksioni kryesor i ekzekutivit në Kosovë udhëhiqet nga Kryeministri, e jo nga Kryetari. Sidoqoftë, duke marrë parasysh se deri në janar të vitit 2006, President i Kosovës ishte Ibrahim Rugova (LDK), lider me shumë ndikim që nga fillimi i viteve 1990-ta, disa nga vendimet më të rëndësishme politike u morën nga zyra e tij. Veç kësaj, për shkak se të gjithë kryeministrat deri më sot kanë qenë përfaqësues të partnerit më të vogël të koalicionit dhe jo drejtpërdrejt nga LDK-ja, autoriteti i tyre herë pas here është penguar nga LDK-ja. Për shembull, në fillim të gushtit të vitit 2006, mediat raportuan një letër që i ishte dërguar Agim Çekut nga LDK-ja, Kryeministri aktual nga rradhët e AAK-ës, e cila kinse kërkonte që ministrat e lidhur me LDK-në, duhet të mbikëqyren nga Zëvendës Kryeministri, e jo nga vet Kryeministri.⁴⁷ Letra erdhi menjëherë pasi Çeku u përpoq të bëhej më i ashpër ndaj ministrave të paaftë ose të korruptuar, të cilët në atë kohë ndodhi të jenë më së shumti nga LDK-ja

Kryetari i Kosovës është zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës me votim të fshehtë. Emërimi për postin e Kryetarit të Kosovës kërkon mbështetjen e partisë që ka siguruar numrin më të madh të vendeve në Kuvend ose e cila ka të paktën 25 deputetë. Kuvendi zgjedh Kryetarin e Kosovës me shumicën e dy të tretave të deputetëve të Kuvendit. Nëse pas dy votimesh nuk arrihet shumica prej dy të tretave, në votimin që vijon, për zgjedhje kërkohet shumica e votave e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe ligjin e zbatueshmëm, detyrat e Kryetarit janë: marrja e masave në fushën e bashkëpunimit me jashtë në koordinim me PSSP-në, prezentimi i raportit në Kuvendin e Kosovës, për gjendjen eçështjeve të përgjithshme në Kosovë të paktën një herë në vit, dhënia e medaljeve dhe shprehja e mirënjohjeve. Mandati i Kryetarit të Kosovës zgjat katër vjet.⁴⁸ Pas vdekjes së Ibrahim Rugovës, në

vitin 2006, Kryetar i Kosovës që nga fillimi i vitit 1990, pasues i tij u bë Fatmir Sejdiu, anëtar i po të njejtës parti.

Kryetari i Kosovës, pas konsultimeve me partitë politike, koalicionet ose grupet e përfaqësuar në Kuvend, i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër. Kandidati i propozuar, në radhë, propozon listën e ministrave sipas shumicës së deputetëve të tij. Nëse kandidatët e propozuar nuk marrin shumicën e kërkuar, atëherë e tërë procedura ripërsëritet.⁴⁹

Kuvendi mund të mos ia jap votëbesimin Qeverisë vetëm nëse me një shumicë të deputetëve të tij zgjedh njëkohësisht një Kryeministër të ri bashkë me listën e ministrave të propozuar nga ai ose ajo. Pas zgjedhjes së tij ose të saj, Kryeministri mund të zëvendësojë çdonjërin prej ministrave, pa pëlqimin e Kuvendit. Por, pas dorëheqjes së Kryeministrit, e gjithë Qeveria është e obliguar të jap dorëheqjen dhe Qeveria vazhdon cilësinë e kujdestarit deri në zgjedhjen e Kryeministrit të ri.⁵⁰ Megjithatë, ligji asnjëherë nuk është zbatuar saktësisht në Kosovë. Në vitin 2005 dhe 2006, dy Kryeministrit lanë postet e tyre, po asnjë ndryshim tjetër nuk pasoi në përbërjen e Qeverisë.

Kabineti aktual nën udhëheqjen e Kryeministrit Agim Çeku, i cili ishte zgjedhur si zëvendësim i Kosumit në mars të vitit 2006, përbëhet prej 15 ministrave, përfshirë edhe dy të shtuara në vitin 2006, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.⁵¹ Ministrat propozohen nga Kryeministri, por emërohen nga Kuvendi i Kosovës, dhe ata nuk duhet të jenë deputetë të Kuvendit.

Sipas Rregullores mbi IPVQ-të, roli i Kryeministrit dhe i ministrave të tij ose saj – Qeveria – është të shërbejnë bashkërisht si organ ekzekutiv administrativ për IPVQ-të e Kosovës. Brenda fushës së përgjegjësive të IPVQ-ve, Qeveria është e obliguar të ushtrojë pushtetin ekzekutiv, të zbatojë ligjet e Kuvendit dhe tjera, të propozojë projektligje me kërkesën e Kuvendit, si edhe ka të drejtën që me iniciativën e vet t'i propozojë projektligje Kuvendit.⁵²

Zbatimi i politikave të Qeverisë është përgjegjësi e secilës ministri, në fushën e vet përkatëse të kompetencave, nën autoritetin e ministrit përkatës. Ato duhet të përgatisin akte legjislative dhe tjera, duhet të bëjnë rekomandime për politika dhe duhet ta zbatojnë ligjin në fuqi brenda fushës së përgjegjësive të veta. Ministrinë mund të pranojnë udhëzime nga Qeveria në pajtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese për IPVQ-të.

Në pajtim me politikat e vendosura nga Qeveria, secili Ministër duhet të jetë i përgjegjshëm ndaj Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë me Ministrinë e tij ose saj, përfshirë edhe shfytëzimin e fondeve, përmes të dyjave, raportimit periodik para Kuvendit si dhe raportimit me kërkesën e Kuvendit. Ministri duhet të vendos orientimin politik të punës së ministrisë. Në pajtim me politikat e vendosura nga Qeveria, secili ministër do të nxjerr vendime ose udhëzime administrative me qëllim që të rregullojë aktivitetet e ministrisë në përgjithësi, ose në fushat e veçanta të aktiviteteve të ministrisë. Secila ministri duhet t'i raportojë Kuvendit në mënyrë

periodike dhe me kërkesë të Kuvendit, për aktivitetet e saj, përfshirë të gjitha fondet e pranuar.⁵³

Një prej vlerësimeve të punës së ministrive, është bërë nga projekti i përbashkët ‘SIGMA’ i OECD-së dhe UE-së, të cilët kanë ardhë në përfundim se:

‘Të gjitha ministrinë janë në fazën fillestare të zhvillimit dhe kalimit në vet-udhëheqje. Ministrinë janë veçanërisht të dobëta në fushat e formulimit dhe hartimit të politikave, dhe këto aktivitete vazhdojnë të kryhen kryesisht nga ekspertë të jashtëm. Aftësia e ministrave në planifikimin e punëve të tyre dhe në veprimin sipas një plani të miratuar, po ashtu është e dobët.’⁵⁴

Zyra e Kryeministri është rritur në numrin e të punësuarve gjatë tri viteve të fundit. Ka filluar si një zyrë me 95 të punësuar në vitin 2003, duke u rritur në 154 dhe 160 në vitin 2004, respektivisht në vitin 2005. Ngjashëm, buxheti për zyrë u rrit prej 2 milionë euro në vitin 2003, në 2.1 milionë euro në vitin 2004 dhe 2.5 milionë në 2005.⁵⁵ Sot, Zyra e Kryeministrit ka buxhetin prej 2.97 milionë euro.⁵⁶

Pagat në ekzekutiv ndryshojnë sipas vendit të punës. Ato sillen prej 1.400 euro dhe 1.200 euro në muaj për Kryetarin dhe Kryeministrin, si dhe 500 euro për këshilltarët e tyre. Kjo është e krahasueshme me pagën mesatare të shërbyesit civil në qeveri, e cila është 210 euro.⁵⁷ Ky supozohet të jetë fitimi i vetëm që cilido shërbyes civil e merr, sipas Ligjit për Shërbyesit Civil. Veç kësaj, rregullat për mbikëqyrjen e pasurisë dhe rregullat për dhuratat janë paraparë me Ligjin për Anti-Korrupsion.

Agjencia Anti-Korrupsion është organ që do të mbikëqyr pasurinë e ‘personave të lartë zyrtarë’ (përfshirë ministrat, deputetët e Kuvendit etj.), të cilët duhet të ofrojnë informata, përfshirë gjendjen e pasurisë së tyre dhe pasurisë së personave që jetojnë më ta, brenda një muaji pas marrjes së postit.⁵⁸ Nëse personi i lartë zyrtar nuk ofron këtë informatë, ekzistojnë procedura që Agjencia i ndërmerr hap pas hapi. Nëse pas tre muajve personi nuk i paraqet këto informata, Agjencia do të informojë organin përgjegjës për fillimin e procedurës për shkarkim nga detyra. Megjithatë, Agjencia Anti-Korrupsion ka filluar të funksionojë në verën e vitit 2006, pesë vjet pas organizimit të parë të ekzekutivit. Në ndërkohë, Ligji për Shërbyesit Civil, i zbatueshëm po ashtu edhe për nëpunësit e Qeverisë, ka caktuar rregullat dhe procedurat për dhurata dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare.

Sipas Ligjit për Anti-Korrupsion, një zyrtar nuk duhet të pranojë dhurata ose përfitime të tjera, përveç dhuratave formale dhe dhuratave të rastit, në vlerë të vogël.⁵⁹ Të gjitha dhuratat e marra dhe vlera e tyre korresponduese do të regjistrohen nga personi zyrtar në katalogun e dhuratave që mbahet nga organi ku personi zyrtar ushtron funksionin e tij, dhe nëse Agjencia konstaton se zyrtari ka thyer rregullat do ta njoftojë organin ku personi zyrtar i lartë ushtron detyrën e tij/saj.

Rasti i nivelit më të lartë të mos zbatimit të Ligjit për Anti-Korrupsion lidhet me ish Kryeministrin e Kosovës, Bajram Kosumin. Në 2005, pasi kishte humbur fluturimin, Kosumi u kthye në Prishtinë nga pushimet e tij në Turqi me një aeroplan privat, me çmim afër 20.000 euro. Disa ditë pas kthimit të tij, ai tha se fluturimi ishte paguar nga

disa njerëz afaristë, emrat e të cilëve ai nuk i zbuloi. Dy ditë më vonë, ai deklaroi se Et'hem Çeku, atëherë ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kishte paguar biletën e aeroplanit, duke vepruar si një mik. Me shfrytëzimin e aeroplanit privat, të paguar nga 'një shok', shumë kritika argumentojnë se Kosumi ka shkelur Ligjin Anti-Korrupsion, i cili hyri në fuqi në prill të vitit 2005.⁶⁰ Ish Kryeministri Kosumi është detyruar të jap dorëheqje në mars të vitit 2006, përmes presionit politik të autoriteteve vendore dhe atyre ndërkombëtare. Ai u konsiderua si i paaftë për të udhëhequr Kosovën në një periudhë kaq të ndjeshme, kohë kur Kosova po përpiqet të fitojë pavarësinë. Disa zyrtarë qeveritarë, megjithatë, supozojnë se dorëheqja e tij mund të ketë qenë, gjithashtu, e lidhur me akuzat për korrupsion në media.

Rasti i dytë dhe mjaft i qartë për korrupsion, i raportuar nga mediat në prill dhe maj 2006, i cili në fakt nuk u ndëshkua, ishte rasti i ministrit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, i cili nga Auditori Gjeneral pohohej se ka keqpërdorur një pjesë të madhe të buxhetit të Ministrisë, kryesisht në veshmbathje për femra dhe meshkuj dhe gjëra të tjera. Kryeministri Çeku ka paralajmëruar se do ta shkarkojë ministrin, por deri më tani ai s'ka qenë në gjendje ta bëjë këtë. Ministri (dhe të tjerët) ende qëndrojnë në postet e tyre.

6.2. Legjislativi

Me Kushtetutën Jugosllave të vitit 1974, Kosova ka pasur Kuvendin e saj, sitimin ligjor të ndarë nga ai i Serbisë (republika nën të cilën ka qenë një 'krahinë autonome'), dhe ka pasur të drejtën të përfaqësohet drejtpërdrejt në institucionet federale të Jugosllavisë. Në fillim të viteve 1989, Kuvendi i Kosovës u shpërnda si dhe u shfuqizuan edhe rregulloret e tjera ligjore që mbronin autonominë e Kosovës.⁶¹ Kosova e riktheu Kuvendin vetëm në vitin 2001, kur Kuvendi i Kosovës u themelua në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe Rregulloren e UNMIK-ut mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, përgjegjëse për themelimin e Qeverisë së përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë.

Sipas Kornizës Kushtetuese, Kuvendi i Kosovës është institucioni më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i IPVQ-ve. Përgjegjësitë e tij përfshijnë: miratimin e ligjeve dhe të rezolutave në fushat e përgjegjësisë të IPVQ-ve; zgjedhjen e Kryesisë së Kuvendit; zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës; miratimin ose refuzimin e kandidatit për Kryeministër, së bashku me listën e ministrave të Qeverisë së propozuar nga kandidati për Kryeministër; marrjen e vendimeve për emërime të tjera, ashtu siç përcaktohet në këtë Kornizë Kushtetuese; marrjen parasysht dhe miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të propozuara brenda fushës së përgjegjësisë të tij; vendosjen mbi mocionet e mosbesimit ndaj Qeverisë; udhëzimin e Qeverisë për përgatitjen e projektligjeve; miratimin e Rregullores së Punës të Kuvendit dhe të komisioneve të tij, si dhe përgjegjësi të tjera të parapara në Kornizën Kushtetuese ose me instrumente të tjera ligjore.

Kuvendi përbëhet prej 120 deputetëve, të zgjedhur me votim të fshehtë, prej të cilëve 100 janë të votuar drejtpërdrejt nga Kuvendi, ndërsa 20 vendet e mbetura janë të

rezervuara, si vijon: 10 vende për serbët e Kosovës dhe 10 vende për minoritetet e tjera. Zgjedhjet e para u mbajtën në nëntor të vitit 2001, ndërsa të dytat dhe të fundit deri më tani, u mbajtën në tetor të viti 2004.

Në fund të vitit 2002, Kuvendi i Kosovës ka pasur 237 persona në listën e pagave, prej të cilëve 119 kanë qenë deputetë të Kuvendit, 112 kanë qenë personel i përgjithshëm administrativ dhe 6 nëpunës administrativ, të caktuar për Kryesinë e Kuvendit.⁶² Në vitin 2005, 316 njerëz kanë qenë në listen e pagave të Kuvendit, me pagat e deputetëve të Kuvendit në vlerë prej 536 euro në muaj.⁶³

Pjesa më e madhe e fondeve për Kuvendin e Kosovës vijnë nga Buxheti i Kosovës, por po ashtu ka pranuar edhe përkrahje nga donatorët, kryesisht në formë të ndihmës teknike dhe të trajnimeve.

Në vitin 2003, shuma prej 6.7 milionë euro nga Buxheti i Kosovës, ka qenë e alokuar për Kuvendin e Kosovës. Përpos fondeve nga Buxheti i Kosovës, Kuvendi i Kosovës po ashtu pranoi përkrahje edhe nga donatorët. Në vitin 2003, programi për ndihmë i EC-së i ofroi Kuvendit rreth 2 milionë euro, me qëllim që të ndihmojë Kuvendin në përmbushjen e mandatit kushtetues, si dhe të menaxhojë në mënyrë efektive procesin legjislativ, në harmoni me standardet evropiane dhe praktikat më të mira.⁶⁴

Në periudhën në mes të viteve 2003-2004, AER-i, Norvegjia dhe Fondi i Besimit i UNDP DG i dhanë Kuvendit të Kosovës shumë prej 550.000 dollarë amerikan, përmes Projektit për Përkrahjen e Arkivit Elektronik të Parlamentit të Kosovës (projekti SPEAK), i zbatuar nga UNDP-Kosova dhe Unioni Ndërparlamentar i Gjenevës. Qëllim i këtij projekti ishte themelimi i arkivit elektronik, regjistrimi i seancave - i diskutimeve dhe dëgjimeve/shqyrtimeve në Kuvend, standardizimi i dokumenteve për ecurinë e punës dhe procesin e informimit, përmirësimi i mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies, përmes informimit të publikut të Kosovës me punën e Kuvendit.⁶⁵ OSBE-ja dhe Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), po ashtu, i kanë dhënë Kuvendit ndihma të ndryshme teknike.⁶⁶

Në vitin 2005, buxheti i përgjithshëm për Kuvendin e Kosovës ka qenë 8.75 milionë euro, prej të cilave 2.61 milionë euro kanë qenë për ndërtimin e ndërtesës së re, që do të shërbejë për takimet e nivelit të lartë për parlamentarët e Kosovës.⁶⁷ Ky ka qenë propozim i LDK-ës dhe është përkrahur nga Nexhat Daci, ish kryetari i Kuvendit dhe njëri ndër deputetët më të përfolur të Kuvendit, siç është raportuar në mediat vendore. Duke qenë se ky objekt do të ndërtohet në mes të Parkut Nacional, afër Prishtinës, opozita dhe shoqëria civile për këtë vendim e kanë paditur Kuvendin në gjykatë. Një deputet i PDK-ës në Kuvend tha se, edhe pse gjykata ende nuk ka ndërmarrë asnjë vendim, punët po vazhdojnë dhe paratë publike po shpenzohen në diçka - për të cilën gjykata mund të vendos që të rrënohet.⁶⁸

Në vitin 2006, Buxheti i Kosovës i alokoi Kuvendit shumë prej 7.53 milionë euro, prej të cilave 76% janë dedikuar për shpenzime operationale, ndërsa 24% të mbetura - janë për investime kapitale.⁶⁹

Sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi dhe udhëzimeve të tjera të PSSP-së dhe të Këshillit Ekonomik dhe Fiskal (KEF), MEF-i duhet t'ia parashtrijë Qeverisë, PSSP-së dhe KEF-it, dokumentin e propozim-buxhetit vjetor. Pastaj, Qeveria formalisht ia dërgon për miratim Kuvendit të Kosovës propozimin e buxhetit vjetor.⁷⁰

Propozim buxhetin e shqyrton Komisioni i Kuvendit për Buxhet dhe Financa dhe drafti, në të vërtetë, i është dorëzuar Kuvendit, që vetëm formalisht e miraton buxhetin. Është PSSP-ja ai që duhet të jap miratimin përfundimtar për buxhetin. Siç pohon një deputet i Kuvendit: 'Vërejtjet tona nuk merren parasysh'. PSSP-ja ka fjalën e fundit. Ne e votojmë buxhetin, por nuk mund ta ndryshojmë përmbajtjen e tij'.⁷¹

Në rast të ndonjë ngjarjeje që kërkon shpenzime të ngutshme ose të pa parashikuara, organizata buxhetore, për t'i mbuluar këto shpenzime, mund të kërkojë fonde shtesë në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave. Ministri mund të autorizojë shpenzimet nga përvetësimet e pa parashikuara (të rastit), në shumën e përgjithshme deri në 250.000 euro. Nëse kërkohet një shumë më e madhe, ministri, paraprakisht, duhet të marrë miratimin me shkrim nga Qeveria dhe PSSP-ja.⁷²

Ajo që është tërësisht e paligjshme dhe që ka ndodhur vitin e kaluar, ishte transferi ndërmisoror i 1 milion euro, i ndryshëm nga buxheti i aprovuar. Ministria e Shërbimeve Publike (MSHP) i transferoi paratë në Zyren e Kryeministrit. Opozita kërkoi në Kuvend që të formohej një komision për ta hetuar rastin, mirëpo parlamentarët që përfaqësonin partitë në qeveri e mbivotuan opozitën në këtë çështje, kështu që komisioni i tillë nuk u formua kurrë.⁷³

Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, e miratuar në maj të vitit 2005, obligon deputetët 'që t'i përmbahen ligjit dhe të veprojnë...në pajtim me besimin e popullit që u është dhënë, duke u kujdesur në veçanti për...parimet (e) vetëmohimit, integritetit moral, objektivitetit, përgjegjësisë, sinqeriteti, ndershmëria dhe aftësia udhëheqëse'.⁷⁴

Veç kësaj, deputetët duhet të deklarojnë gojarisht për interesat e tyre personale ose të familjarëve të tyre të ngushtë, para se të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit ose të komisioneve të tij. Gjithashtu, edhe kur kjo deklaratë është bërë, deputeti nuk mund të votojë në çështjen kur 'ndonjë vendim i caktuar mund të rezultojë me përfitim financiar për te dhe mund të mos pranohet nga një kategori e gjerë e njerëzve, që nuk janë deputetë të Kuvendit ose nga të afërmit e deputetëve të Kuvendit'. Përfundimisht, një deputet i Kuvendit nuk i lejohet 'të propagojë ose të inicojë çfarëdo rrjedhe ose çështjeje në mbledhjet e Kuvendit apo të komisioneve të tij, si shkëmbim për pagim ose përfitim tjetër në natyrë, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte. E njëjta gjë vlen po qe se pagesa ose përfitimi është pranuar nga anëtari i familjes së ngushtë të deputetit'.⁷⁵

Rregullorja e Punës, po ashtu, detyron deputetët ta informojnë më shkrim kryetarin e Kuvendit, brenda 30 ditësh nga seanca inauguruese e Kuvendit, për të gjitha përfitimet financiare, për të gjitha të mirat financiare që posedojnë ata apo familja e tyre e ngushtë dhe për fitimet financiare që ata mund t'i marrin nga: punësimi, drejtimi i ndërmarrjeve, këshillimi, ligjërimi dhe gazetaria, dhuratat dhe mikëpritja, si

dhe nga mbështetja financiare ose përkrahja që ata mund të marrin si kandidatë ose deputetë të Kuvendit, (ndryshe nga partia politike që ata përfaqësojnë). Në kohën kur do të bëhet funksionale, Agjencia Anti-Korrupsion do të jetë organi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre dhe të dipozitave të tjera, të cilat aktualisht nuk zbatohen – për shembull:

‘Nëse një person bëhet deputet i Kuvendit, ai ose ajo nuk mund, gjithashtu, të punojë si zyrtar i lartë civil, siç janë drejtorët e departamenteve ose sekretarët permanent të ministrive. Megjithatë, në praktikë, pasi që janë bërë deputetë, shumë drejtorë prapëseprapë i kanë mbajtur pozitat e tyre të mëparshme...Gjithashtu, një numër i zyrtarëve nuk e respektojnë rregulloren që një zyrtar mund të marrë vetëm dy paga nga Buxheti i Kosovës – njëra pagë e plotë, ndërsa tjetra vetëm gjysma e vlerës reale. Për shembull, Bujar Dugolli, ministër aktual i Tregtisë dhe Industrisë, merr tri paga të plota nga Buxheti i Kosovës: pagën si ministër, pagën si deputet i Kuvendit, si dhe pagën si profesor në Universitetin e Prishtinës; ngjashëm me të edhe Nexhat Daci, ish kryetar i Kuvendit, merr tri paga nga Buxheti i Kosovës - si deputet i Kuvendit, si profesor në Universitetin e Prishtinës dhe si anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës’⁷⁶

Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, deputeti i Kuvendit mund të mos jetë më deputet nëse ai ose ajo është dënuar për vepër penale në Kosovë dhe është dënuar me burgim për një peirudhë prej gjashtë e më shumë muaj, dhe nëse është duke kryer dënimin e caktuar nga Tribunali Ndërkombëtar i Hagës për Krime Luftë në ish-Jugosllavi, por nuk e ka zbatuar urdhrin për t’u paraqitur para tij.

Mgjithatë, pavarësisht nga gjithë këto obligime të shumta ligjore për transparencën financiare dhe kufizimet e tjera të ngjashme në shfrytëzimin e fondeve publike nga deputetët e Kuvendit, prap një numër i shkeljeve janë raportuar në media. Për shembull, gazeta ditore *Koha Ditore*, pohon se gjoja Nexhat Daci, ish ryetar i Kuvendit të Kosovës, mori pagesa në avans afër 6.161 euro gjatë periudhës një mujore, në vjeshtën e vitit 2006, kurse vetëm 3.921 euro ishin shpenzuar nga zyra e tij për ushqim dhe pije gjatë kësaj periudhe.⁷⁷ Ngjashëm, gazeta ditore në gjuhën shqipe - *Zeri*, pohoi se auditori i pavarur, *Deloitte & Touche*, ka gjetur se vetura e porositur nga zyra e Kryetarit të Kuvendit në vitin 2005, është dashur të paguhej nga fondet e dedikuara për ndërtimin e Arkivit të Kuvendit.⁷⁸ Një anëtar i opozitës në Kuvend u shpreh se, ‘Kosova funksionon sipas sistemit të bazuar në parti: gjyqësia, ekzekutivi dhe legjislativi, të gjitha janë institucione që ekzistojnë vetëm në letër. Megjithatë, partia në pushtet i mbizotëron këto institucione, dhe ‘kontrollat dhe vlerësimet’ në mes të institucioneve i shpartallon pjesë pjesë’.

Është më rëndësi të ceket se sistemi zgjedhor në vend: sistemi i ‘votimit me lista të mbyllura’, që i obligon votuesit të votojnë për partitë e jo për individë, dhe në këtë mënyrë – kritikët thonë – dekurajon përgjegjësinë individuale të politikanëve dhe krijon hapësirë të mjaftueshme për korrupsion.⁷⁹

6.3. Komisioni Zgjedhor

Departamenti për Zgjedhje i Misionit të OSBE-së në Kosovë, që nga viti 1999 ka qenë përgjegjës për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor të nivelit lokal dhe qendror në Kosovë.⁸⁰ Gjatë vitit 2004, Departamenti për Zgjedhje i OSBE-së ka përkrahur krijimin e institucioneve zgjedhore kosovare, të cilat nën përkrahjen e OSBE-së, në vjeshtën e vitit 2004, organizuan zgjedhjet nacionale. Megjithatë, Departamenti për Zgjedhje i OSBE-së ende është përgjegjës për disa funksione të lidhura me zgjedhjet, siç janë: përgatitja dhe mirëmbajtja e listës së votuesve, krijimi i kushteve të nevojshme për të i'a dorëzuar procesin Sekretariatit të Komisionit Qendror për Zgjedhje; udhëheqja e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike (ZRPP), si dhe vazhdimi i përkrahjes në hartimin e kornizës elektorale ligjore.⁸¹

Në procesin e organizimit dhe vëzhgimit të zgjedhjeve, Departamenti i OSBE-së për Zgjedhje kohë pas kohe është përkrahur nga vullnetarët e KB-ve, numri i të cilëve në vitin 2002 arriti kulmin - me 400 vullnetarë.⁸² Megjithatë, gjatë zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës në vitin 2004, procesi u vëzhgua nga mbi 200 vëzhgues ndërkombëtarë, e po ashtu edhe nga vëzhgues vendor. Buxheti për Departamentin për Zgjedhje i OSBE-së ka ndryshuar prej vitit në vit dhe pothuajse i dyfishuar gjatë viteve zgjedhore.⁸³ Buxheti për vitet 2001 dhe 2004 (vite të zgjedhjeve nacionale) ka qenë 6.5 milionë, respektivisht 5.1 milionë. Sipas personelit të Departamentit për Zgjedhje në OSBE-së, buxheti i tyre në vitin 2006 ka qenë përafërsisht 2.3 milionë euro, kurse stafi ka numëruar rreth 45 të punësuar.⁸⁴

Që nga viti 2004, institucionet vendore për zgjedhje, siç është përcaktuar me Rregulloren mbi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë: Komisioni Qendror për Zgjedhje (KQZ), Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ), Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ) dhe Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP).⁸⁵

Në vitin 2004, KQZ-ja u bë institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e proceseve zgjedhore në Kosovë. Rregullorja parasheh që KQZ-ja të jetë organ i pavarur dhe i përhershëm, përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe mbikëqyrjen menaxhuese dhe administrative të udhëheqjes së zgjedhjeve në Kuvendin e Kosovës dhe në kuvendet komunale të Kosovës. Sipas kësaj rregulloreje, KQZ-ja përbëhet prej një kryesuesi dhe 12 ose më shumë anëtarëve të tjerë, të gjithë të emëruar nga PSSP-ja, në konsultim me bashkëpunorët/partnerët e tjerë.

Dy komisionerë janë zgjedhur nga PSSP-ja, në konsultim me OSBE-në, kurse të tjerët, anëtarët vendorët, janë nominuar nga partitë e mëdha politike shqiptare dhe nga përfaqësuesit e komuniteteve më të vogëla.⁸⁶ Rregullorja mbi Komisionin Zgjedhor përcakton se përveç kryesuesit, komisionerëve dhe zëvendësve të zgjedhur nga PSSP-ja, i tërë stafi tjetër do të paguhet me mjetet e siguruar nga Buxheti i Kosovës.⁸⁷

Sekretariati Zgjedhor është themeluar në vitin 2003 dhe është përgjegjës për të siguruar përkrahjen e nevojshme administrative dhe nevojave të tjera për KQZ-në.⁸⁸

Duke qenë një krah ekzekutiv i KQZ-së, çdo vendim i ndërmarrë nga SKQZ-ja nevojitet të aprovohet nga ai i mëparshmi.⁸⁹

Shumë përgjegjësi të lidhura me zgjedhjet janë transferuar tek SKQZ-ja, megjithëse Departamenti për Zgjedhje të OSBE-së vazhdon ta përkrah atë të mëparshmin me këshilla profesionale dhe trajnime⁹⁰ E vetmja kompetencë e rezervuar e Departamentit për Zgjedhje të OSBE-së janë listat e votuesve, votimi jashtë vendit dhe udhëheqja e qendrës së numërimit të votave dhe rezultateve.

SKQZ-ja, në bashkëpunim me KQZ-në, përcakton buxhetin dhe logjistikën. Financimi për KQSZ-në bëhet nga Buxheti i Kosovës, kurse përkrahja nga donatorët ndërkombëtarë është limituar në trajnime dhe përkrahje për bashkëpunim rajonal.

Në vitin 2004, vit i zgjedhjeve nacionale të Kuvendit dhe vit i parë i funksionimit të KQZ dhe SKQZ, buxheti i miratuar për SKQZ-në ka qenë 5 milionë euro, megjithëse buxheti i miratuar me zotimet e bartura ka qenë në të vërtetë vetëm 4.8 milionë euro. Prej shifrës së fundit, vetëm 3 milionë euro përfundimisht janë shpenzuar nga SKQZ-ja. Në vitin 2005 - vit jo zgjedhor - buxheti i miratuar për KQSZ-në ka qenë më shumë se 90 përqind më i vogël se ai i miratuar në vitin 2004, e që është 450.000 euro.⁹¹

KQZ-ja mund ta delegojë autoritetin e tij për nënshkrimin e kontratave të punës tek zyrtari udhëheqës ekzekutiv i Sekretariatit. Aktualisht në SKQZ janë 50 punëtorë të përhershëm, prej të cilëve 20 janë të vendosur në zyrën kryesuese, kurse 30 janë të vendosur në terren (një zyrtar ekzekutiv në çdo komunë). Gjatë zgjedhjeve, zyrtarët komunal zgjedhor veprojnë si udhëheqës të komisioneve zgjedhore në çdo komunë. Prej 30 zyrtarëve ekzekutiv komunal, 26 janë shqiptarë dhe 4 janë serbë.⁹²

Komisionet komunale zgjedhore janë organe profesionale në secilen prej 30 komunave të Kosovës, që ndihmojnë në zhvillimin e zgjedhjeve. KKZ-të janë përgjegjëse për sigurimin e informatave për votuesit dhe partitë politike, për të drejtat dhe obligimet e tyre. Para zgjedhjeve, ato emërojnë dh trajnojnë këshillat e vendvotimeve dhe ndihmojnë për aranzhime teknike në vendvotime. Nga KKZ-të pritet t'i kryejnë punët e tyre në mënyrë të paanshme dhe profesionale, duke u siguruar të gjithëve nivel të barabartë të shërbimit. KKZ-të zakonisht kanë në mes të tre dhe pesë anëtarëve, të cilët për punën e bërë paguhen me pagë prej 100 euro në muaj.⁹³

Në vitin 2004, UNMIK-u, po ashtu, themeloi Komisionin për Ankesa dhe Parashpresa. KZAP është organ i pavarur, i emëruar nga PSSP-ja, jo më vonë se dy muaj para mbajtjes së zgjedhjeve. Qëllimi i Komisionit është të vendos lidhur me ankesat dhe parashpresat e lejuara përkitazi me procesin zgjedhor, ashtu siç është përcaktuar në rreguloret, udhëzimet administrative dhe në rregullat zgjedhore në fuqi. Sipas kësaj rregulloreje, KZAP përbëhet nga një shef i Komisionit dhe tre apo katër anëtarë të Komisionit, të emëruar sipas vendimit të PSSP-së, në konsultim me kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.⁹⁴

Një person me një interesim ligjor në çështjet përbrenda juridiksionit të KZAP ose të drejtat e të cilit janë shkelur në lidhje me procesin zgjedhor, mund të paraqes ankesë në KZAP. KZAP është i obliguar të marr vendim me konsensus, i cili pastaj publikohet në pajtim me rregulloret e tij të punës.

KZAP-ja ka fuqi t'i gjobis subjektet politike, ku deri në qershor të viti 2005 rezultuan 179.041 euro nga gjobitjet e bëra, të shpërndara në mbi 65 raste dhe të lëshuara për 33 parti.⁹⁵ Këto ndëshkime janë bërë për arsye të ndryshme: thjesht për shkak se subjekti politik ka mbajtur një ngjarje politike të pautorizuar, ka mbuluar posterët e partive të tjera, ose kanë lajmëruar me vonesë ose nuk kanë njoftuar fare për tubimin politik. Tri partitë më të mëdha politike, LDK, PDK dhe AAK, po ashtu, janë gjobitur për shkeljen e Rregullorës së UNMIK-ut nr.2004/12, veçanërisht lidhur me menaxhimin financiar, publikimin dhe raportimin e obligimeve të partive politike.

Një numër i organizatave vendore dhe ndërkombëtare kanë ndihmuar katër palë zgjedhjet që janë mbajtur në Kosovë që nga fundi i luftës në vitin 1999, që janë të pranueshme nga këndvështrimi i procesit, procedurat dhe numri i votuesve. Për shembull, Daan Everts, udhëheqës i atëhershëm i OSBE-së, ndjeu se zgjedhjet e vitit 2001 ishin 'sukses i madh' dhe 'një hap i madh drejt demokracisë'.⁹⁶ Duke folur për zgjedhjet e vitit 2004, Julie Mertus, një krijues dhe profesor në Universitetin e Washington-it, në SHBA, deklaroi se 'zgjedhjet në Kosovë e kaluan testin e tyre me sukses'.⁹⁷

Ka pasur edhe kritika të zëshme nga një numër i organizatave, veçanërisht sa i përket ecurisë së zgjedhjeve të Kuvendit të Kosovës në 2004, të *sistemit* elektoral të përdorur (të mbyllura karshi sistemit me lista të hapura), por jo për punën e Komisionit Zgjedhor. Ligji i ri mbi sistemin zgjedhor në Kosovë aktualisht është duke u hartuar nga Zyra e zëvendës kryeministrit, më qëllim të adresimit të kësaj kritike. Është më rëndësi të ceket se asnjëra prej partive kryesore politike nuk i ka kontestuar rezultatet e zgjedhjeve të mbajtura deri më tani.

6.4. Financimi dhe shpenzimet e partive politike

Numri i partive politike në Kosovë ndryshon prej vitit në vit. Sipas ESK-së, kanë qenë: 49 parti politike gjatë zgjedhjeve komunale në vitin 2000; 35 parti gjatë zgjedhjeve nacionale në vitin 2001; 68 parti gjatë zgjedhjeve të dyta komunale në vitin 2002, si dhe 33 parti politike gjatë zgjedhjeve nacionale në vitin 2004. Në të gjitha këto zgjedhje, partitë që fituan më së shumti vende janë: LDK, PDK dhe AAK, që nga viti 2004 edhe 'Partia Reformiste – Ora'.⁹⁸

Legjislacioni i tanishëm mbi regjistrimin dhe funksionimin e partive politike është Rregullorja e UNMIK-ut nr.2004/11, *Mbi Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike në Kosovë*, e cila zbatohet përmes Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike (ZRPP), e vendosur në kuadër të Departamentit për Zgjedhje në OSBE.⁹⁹ Regjistrimi në ZRPP është kusht për secilën parti që dëshiron në veprojë në Kosovë. ZRPP-ja mirëmban listën e të gjitha partive të regjistruara dhe informatat e tyre përkatëse financiare.¹⁰⁰

Secila parti politike e regjistruar në Kosovë është e obliguar t'i dorëzojë ZRPP-së raportet gjashtëmujore financiare, të cilat janë verifikuar nga ZRPP-ja dhe janë nënshkruar nga auditori i certifikuar, i cili deri më sot gjithnjë ka qenë anëtar i stafit ndërkombëtar.¹⁰¹ ZRPP-ja ka të drejtën për të audituar 'çdo formular publik financiar të fushatës' së subjekteve politike dhe të përgatis nga një raport përfundimtar të auditimit me të dhënat e gjetura, pas çdo fushate zgjedhore.¹⁰² Raportet janë të bazuara në informatat e paraqitura nga vet partitë politike, si dhe nga burimet e tjera, siç është regjistri i bizneseve, regjistrimi i veturave ose nga kadastrat.¹⁰³ ZRPP-ja mirëmban Dosjen për Informim Publik, në të cilën janë llogaritë e deklaruara nga partitë politike, përfshirë burimet e donacioneve, të cilat janë paraqitur për t'u parë nga anëtarët e publikut.¹⁰⁴ Përfundimisht, është e rëndësishme të ceket se ZRPP-ja nuk ka të drejtë të hetojë rastet e dyshuara për korrupsion, megjithëse mund t'i paraqes dyshimet e tij te instiucionet e tjera.¹⁰⁵

Buxheti për ZRPP-në ndahet prej buxhetit të përgjithshëm të Departamentit të Zgjedhjeve të OSBE-së. Buxheti për vitin 2004, vit zgjedhor, ka qenë përafërsisht 4 milionë euro, për vitin 2005 rreth 1 milion euro, kurse për vitin 2006 ka qenë 2.3 milionë euro. Stafi punues në ZRPP ndryshon prej vitit në vit, duke arritur kulmin në vitin 2003, me 13 të punësuar. Në vitin 2006, ZRPP-ja ka pasur dy punëtorë me orar të plotë, të ndihmuar nga një auditor ndërkombëtar i OSBE-së.¹⁰⁶

Megjithëse Departamenti i Zgjedhjeve i OSBE-së ka filluar bartjen e disa përgjegjësi lidhur me zgjedhjet tek instiucionet vendore, siç është certifikimi i kandidatëve, pranimi i mbikëqyrësve dhe shpërndarja e materialit zgjedhor, kurse përgjegjësia për auditimin financiar të partive politike është planifikuar të mbetet brenda ZRPP-së, derisa të ekzistojë kjo zyrë. Sugjerimet e Ambasadorit të OSBE-së për bartjen e ZRPP-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë ose në Auditorin Gjeneral të Kosovës, janë hedhur poshtë.¹⁰⁷

Me ligj, partitë politike duhet t'i regjistrojnë raportet financiare që përmbajnë pasqyrën e fitimit dhe humbjeve, e cila tregon të hyrat dhe shpenzimet e tyre (përfshirë ato të degëve të tyre) dhe faturat për të gjitha shpenzimet që tejkalojnë shumë prej 100 euro. Llogaritë e tyre bankare duhet të identifikojnë të hyrat sipas burimit, shumës dhe mënyrës së pagesës dhe pagesat e bëra nga marrësi, qëllimin e përdorimit të fondeve dhe mënyrën e pagesës. Librat e kontabilitetit duhet të mirëmbahen për pesë vite dhe duhet të jenë në dispozicion për inspektim, me kërkesë të KQZ-së dhe ZRPP-së.¹⁰⁸

Ligji u lejon subjekteve politike qasje në fondet publike në proporcion me vendet që mbajnë në Kuvendin e Kosovës, sigurimi i fondeve të tilla është: '(a) posaçërisht i autorizuar në ligjin në fuqi; dhe (b) është ndarë në mes të pranuesve, duke u bazuar në kriteret e zyrtarizuara nga Kuvendi i Kosovës...dhe është shpërndarë në atë mënyrë që të mos bëhet dallim i vendeve të parapara për bashkësitë joshqiptare të Kosovës...dhe vendeve të tjera në Kuvend'.¹⁰⁹

Veç kësaj, partia politike mund të pranojë kontribute nga personat privat, nëse shuma nuk e kalon vlerën prej 20.000 euro për vit kalendarik për një person.¹¹⁰ Kjo e drejtë, megjithatë është temë e dy çështjeve. E para, se një kontribut i tillë në para ndeshet me kërkesat e legjislacionit mbi parandalimin e shpërlarjes së parasë. E dyta, se kontribuesi i paraqet partisë, emrin e tij ose të saj të plotë, adresën, numrin e regjistrimit civil të UNMIK-ut, numrin e pasaportës ose numrin e patentë shoferit.¹¹¹

Partitë politike nuk lejohen të pranojnë kontribute të dhëna në mënyrë të tërthortë përmes një personi, nga paratë, pasuria apo shërbimet e palës së tretë. Ato po ashtu nuk mund të hyjnë në asnjë lloj veprimtarie financiare apo fitimprurëse, përpos shitjes së të mirave (siç janë publikimet ose posterët) me emblemën apo akronimin e partisë në shumë të përgjithshme jo më të madhe se dy mijë (2.000) euro në vit.¹¹²

Gjithashtu, partitë politike janë të obliguara të paraqesin: (a) secilin kontribut, ose grup të kontributeve, të pranuar prej një burimi të vetëm gjatë një viti raportues financiar, që tejkalon vlerën prej 1.500 euro, dhe (b) secilën pagesë nga partia politike për një burim të vetëm gjatë një viti raportues financiar, që tejkalon vlerën prej 10.000 euro.¹¹³

Si pjesë e detyrave të tyre për t'i bërë llogaritë bankare të subjekteve politike, të hapura për informim publik, në vitin 2004, OSBE-ja publikoi 'Raportin mbi Raportet Financiare Vjetore të Partive Politike për vitin 2002 dhe 2003', 'Raportet Gjashtëmujore Financiare të Partive Politike për vitin 2004', dhe 'Raportin mbi Shpenzimet Financiare të Fushatës së Subjekteve Politike për Zgjedhjet e Kuvendit në vitin 2004', siç janë plotësuar nga secila parti politike e regjistruar në Kosovë.¹¹⁴ Veç kësaj, në vitin 2004, ZRPP-ja po ashtu publikisht ka deklaruar pasurinë personale të politikanëve të Kosovës, siç është caktuar më heret, kur regjistroheshin si kandidatë për zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës.¹¹⁵

Megjithatë, efikasiteti i kësaj kornize ligjore dhe institucionale për rregullimin e transparencës financiare të partive politike, herë pas here është vënë në pikëpyetje. Në vitin 2004, gazeta ditore në gjuhën shqipe, *Koha Ditore* ka shkruar se 'nëse ne e krahasojmë atë se çka është parë dhe shkruar gjatë katër viteve, me atë se çka i deklaruan OSBE-së kandidatët politikë për Kuvendin e Kosovës, deklaratat e tyre financiare duken...thjesht qesharake'.¹¹⁶

Në të vërtetë, ZRPP-ja vet në raportet e saj përmend një numër të gabimeve në deklaratat financiare të partive politike, prej të cilave më të shpeshtat janë 'regjistrimi jo i saktë i shifrave të publikuara' dhe 'lënia jashtë' e tyre.¹¹⁷ Për shembull, në vitin 2004, partia më e madhe në pushtet, LDK-ja, tejkaloi kufirin e lejuar ligjor për pagesat ditore, si dhe nuk paraqiti informatat e nevojshme për 43 donacionet e veta.¹¹⁸ Partia e dytë më e madhe në pushtet, AAK-ja, mori në formë të kontributeve nga një kompani private, e ndaluar me Rregulloren mbi Partitë Politike, dhe nuk ka bërë publike asnjë shpenzim për reklamat televizive. Partia e dytë më e madhe në opozitë, 'Partia Reformiste – Ora', nuk kishte paraqitur asnjë kopje të faturave të marra për shpenzimet e bëra gjatë periudhës së fushatës. Sipas ZRPP-së, vetëm partia më e madhe në opozitë, PDK-ja, kishte paraqitur tërë dokumentacionin përkrahës në lidhje

me të hyrat dhe shpenzimet e veta dhe ka qenë e vetmja parti 'bilanci i së cilës doli vërtetë në rregull'.¹¹⁹

Për shkeljen e dispozitave të Rregullores mbi Partitë Politike, ZRPP-ja mund të shqiptojë deri në 20.000 euro, pa paragjykuar asnjë sanksion që mund të zbatohet.¹²⁰ Deri më tani, prapë se prapë, gjrobat e caktuara nga ZRPP-ja në asnjë rast nuk kanë tejkuluar vlerën prej 200 euro dhe ato janë shqiptuar kryesisht për shkak të dorëzimit me vonesë të raporteve financiare. Vetëm dy parti politike janë suspenduar deri më tani, që të dyja për mos mbajtjen e kuvendit të anëtarëve, siç kërkohet me Rregulloren mbi Partitë Politike. Nuk ka pasur raste të suspendimit të partive për shkak të neglizhencës për të paraqitur të dhënat e reja vjetore ose raportet financiare.¹²¹

6.5. Institucioni i Auditorit Gjeneral

Që nga përfundimi i luftës, fondet publike në Kosovë kanë qenë çështje e procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Auditimi i brendshëm ka qenë përgjegjësi e zyrave të auditimit të brendshëm, në çdo institucion publik, që fillimisht kanë qenë nën mbikëqyrjen e Autoritetit Qendror Fiskal (AQF), kurse tani janë nën mbikëqyrjen e MEF-it.¹²²

Auditimi i jashtëm fillimisht është udhëhequr nga Gjykata e Holandës për Auditim (NCA), e cila në vitin 2000 ka fituar tenderin ndërkombëtar për të audituar të gjitha fondet e menaxhuara nga UNMIK-u.¹²³ Duke i njohur vështirësitë thelbësore të menaxhimit financiar në një vend të pas luftës, NCA-ja ka ardhur në përfundim se 'natyra e ndjeshme e sistemeve të kontabilitetit...e ka bërë të pamundur paraqitjen e qëndrimeve financiare në mënyrën dhe kualitetetin e duhur, e që normalisht do të ishte i pritur në sektorin publik' dhe se 'raporti i auditimit duhet t'i paraqes kufizimet në harmoni me parimet e kontabiliteti sipas kesh-it'.¹²⁴

Mandati i NCA-së më pas është zgjatur deri në vitin 2003, kur përgjegjësitë për auditimin e jashtëm janë bartur tek Zyra e sapofomuar e Auditorit Gjeneral të Kosovës (ZAGJ). ZAGJ-i është një institucion i pavarur publik, i themeluar në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe Rregulloren nr. 2002/18 të UNMIK-ut, *Për Themelimin e Zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës dhe Zyrën e Auditimit të Kosovës*.¹²⁵ Në 2003, ZAGJ-i është bërë anëtar i Organizatës Evropiane të Institucioneve Regjionale të Jashtme për Financa Publike (EURORAI), duke siguruar kështu njohjen e parë profesionale të ZAGJ-it të Kosovës.¹²⁶

ZAGJ-i ka mandatin për të bërë auditime vjetore të pavarura për të gjitha subjektet që marrin para publike, përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Kryetarit të Kosovës, të gjitha ministritë e Kosovës dhe agjencitë ekzekutive të IPVQ-ve, të gjitha komunitatet e Kosovës, Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK), doganat e UNMIK-ut, AKM-në, NPP, Ombudspersonin dhe subjektet e tjera që marrin fonde nga Buxheti i Kosovës.¹²⁷ Megjithatë, duke ditur që ZAGJ-i fillimisht nuk ka pasur kapacitete të mjaftueshme për t'i bërë auditimet e të gjitha këtyre institucioneve, kjo herë pas here ka bërë që të angazhohen kontraktorët privat të auditimit.

Megjithëse emërimi i Auditorit Gjeneral është pjesë e kompetencave dhe përgjegjësi të rezervuara të PSSP-së, korniza ligjore përmend se ‘Auditori Gjeneral duhet t’i kryej detyrat e tij ose saj në mënyrë të pavarur nga... [PSSP]... dhe... [IPVQ]’.¹²⁸

Ligji parasheh se:

‘gjatë tri viteve të para pas...[Regullorja për ZAGJ]...hyrjes në fuqi, auditori gjeneral do të emërohet nga PSSP-ja, për një mandat fillestar prej së paku 3 vitesh dhe jo më shumë se pesë vite. Mandatet vijuese të emërimit nga PSSP do të jenë deri në pesë vjet’.

Megjithëse ligji nuk specifikon kushtet për nacionalitetin e Auditorit Gjeneral, Auditori Gjeneral i parë dhe i tanishëm i Kosovës është i nacionalitetit Suedez, me 10 vite përvojë si Auditor Gjeneral në Suedi.¹²⁹

Ligji specifikon se Auditori Gjeneral ka imunitet ndaj çdo procesi ligjor sa i përket fjalëve të shqiptuara dhe për të gjitha punët e tjera që i kryen në cilësinë e tij zyrtare. Megjithatë, PSSP-ja ka ‘të drejtë dhe detyrë që ta heqë atë imunitet... [nëse] sipas mendimit të tij imuniteti mund të pengojë rrjedhën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykuar interesin e institucionit të auditorit gjeneral’.¹³⁰

Gjithashtu, PSSP mund ta largoj nga zyra Auditorin Gjeneral, vetëm nëse ai ose ajo: nuk është në gjendje t’i kryej detyrat zyrtare të tij apo të saj për shkak të paaftësi; ka bërë ndonjë sjellje të keqe apo të pahijshme gjatë kryerjes së detyrave zyrtare; është shpallur fajtor me ndonjë aktgjykim përfundimtar për ndonjë vepër penale dhe është dënuar me burg; ka deklaruar falimentimin; cakton pagesat e tij ose të saj në dobi të huadhënësve; ose është temë e votimit nga Kuvendi, me dy të tretat e shumicës së deputetëve të tij, që rekomandojnë largimin e tij ose saj në bazë të kompetencave, integritetit ose sjelljeve gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.¹³¹

Fondet për themelimin e ZAGJ-it u mblodhën nga tri burime: AER-i - për ndihmë teknike, UE-ja - për emërimin e Auditorit Gjeneral dhe zëvendësit të tij/saj, si dhe nga Buxheti i Kosovës - për personelin vendor dhe udhëheqjen e zyrës. Në tri vitet e para, ZAGJ është financuar bashkërisht nga Buxheti i Kosovës dhe AER-i, kurse që atëherë e tutje do të financohet vetëm nga Buxheti i Kosovës dhe të hyrat vetanake të gjeneruara nga pagesat për disa aktivitete të caktuara të auditimit.¹³² Në vitin 2005, ZAGJ ka pasur buxhetin prej gjithësej 1.5 milion euro dhe me një personel të aprovuar prej 87 të punësuarve, prej të cilëve 60 kanë qenë në Departamentin e Auditorit dhe të tjerët në funksione të tjera përkrahëse.¹³³ Në vitin 2004, ZAGJ-i nga AER-i ka pranuar grantin prej 2.2 milionë euro për të financuar ndihmën teknike dhe aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve.¹³⁴

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me 30 qershor të çdo viti, Auditori Gjeneral duhet ‘të përgatis dhe t’i dorëzojë Kuvendit dhe PSSP-së

një raport mbi deklaratat financiare të organizatave buxhetore për vitin e kaluar fiskal', kopjet e të cilave do të vihen në dispozicion të publikut.¹³⁵

Për shkak të transparencës, raportet e ZAGJ-it publikisht janë vënë në dispozicion në web - faqen e tyre. Raportet në vijim janë aktualisht në dispozicion: raportet e auditimit të Buxhetit të Kosovës për vitet 2001-2004; raporti i auditimit për Ministrinë e Komuniteteve dhe të Kthimit për vitin 2005; raporti i auditimit për Zyrën e Kryetarit të Kosovës për vitin 2005, raporti i auditimit për Zyrën e Komuniteteve për vitin 2005, raporti i auditimit për Ministrinë e Bujqësië dhe Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë për vitin 2004; si dhe auditimi i Fondit të Rindërtimit për 2004-2005. Web-faqja po ashtu përmban lidhje me raporte të ndryshme të auditimit për autoritetet komunale për vitet 2001-2002 dhe 2003-2004, të bëra qoftë nga Deloitte Kosova - auditor i pavarur komercial ose nga vet ZAGJ.¹³⁶

Auditimet e llogarive të NPP-ve të ndryshme, të cilat aktualisht janë nën administrimin e AKM-së, deri më tani janë ndërmarrë nga auditorë të ndryshëm komercial dhe mund të merren përmes Web - faqes së AKM-së. Për vitin fiskal 2003 dhe 2004, auditimi i pavarur i Aeroportit të Prishtinës është bërë nga PricewaterhouseCoopers, ai i PTK-së dhe i Hekurudhave të UNMIK-ut është bërë nga Deloitte and Touche, kurse Ernst&Young ka qenë përgjegjës për raportet e auditimit të Termokosit, KEK-ut dhe Ngrohtores Rajonale në Gjakovë.¹³⁷

ZAGJ-i i ka dorëzuar Kuvendit të Kosovës raportin e saj të përgjithshëm të auditimit për Buxhetin e Kosovës të vitit fiskal 2004. Ndonëse raporti shënon se 'është bërë përparim i konsiderueshëm në krijimin e kapaciteteve për auditim të brendshëm brenda sektorit publik të Kosovës', dhe vazhdon të thotë se 'natyra e fragmentuar e sistemeve financiare që mbështjellin...[Buxhetin e Kosovës]... [ku]...sisteme të ndryshme regjistrojnë shuma të ndryshme për të njëjtin artikuj, dhe...këto dallime nuk mund të arsyetohen, duke dëmtuar në masë të madhe kredibilitetin e pasqyrave financiare'. ZAGJ-i konkludon se si rezultat '...ne nuk kemi qenë në gjendje të shprehim mendimin tonë nëse pasqyrat financiare të bashkëngjitura, të marra si tërësi, japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë për [Buxhetin e Kosovës] për vitin aktual'.¹³⁸ Këto të gjetura janë diskutuar nga Komisioni i Kuvendit për Buxhet dhe Financa, i cili vetëm potencoi se 'raporti paraqet një përmbledhje të mirë...[dhe se] mund të vërehen zhvillime inkurajuese sa i përket raportimit financiar'.¹³⁹

Në të vërtetë, problemi kryesor i ZAGJ-it nuk është cilësia e raporteve të saj ose të vet institucionit, por më shumë gatishmëria e organeve të tjera që të reagojnë dhe të çojnë deri në fund rekomandimet e tyre. Një shembull i dukshëm është ai i Komunës së Prishtinës, ku për një vit fiskal ZAGJ-i ka listuar detajisht për 27 parregullësi serioze, që rradhiten prej caktimit të vlerave të pamjaftueshme të tenderimit, pagesave para kohe, mbipagesat, pagesat e shumëfishta, ose pagesat për artikujt që nuk janë specifikuar në kontratë..¹⁴⁰

Megjithatë, Komuna e Prishtinës ka vendosur të mos debatojë në Kuvend për raportin e auditimit, duke e cilësuar atë 'të anshëm, joprofesional dhe të pakompletuar'.¹⁴¹ Duke bërë kështu Komuna ka thyer Rregulloren mbi Pushtetin Lokal, i cili thotë se

‘auditori i dorëzon Kuvendit Komunal raport me shkrim për çdo revizion financiar dhe Kuvendi Komunal merr vendim për veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me secilin rekomandim që përmban raportin. Kuvendi nuk mund ta refuzojë pa arsye bindëse asnjërin prej rekomandimeve dhe arsyet duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes përkatëse’.¹⁴²

Libri i Buxhetit të Kosovës përmban informacione për alokimin e fondeve të Kosovës për të gjitha institucionet publike. Shpenzimet e përgjithshme të planifikuara të ministrive të ndryshme, të komunave ose të agjencive publike janë shënuar në këtë buxhet dhe ato janë të ndara në pesë kategori: paga dhe mëditje, mallëra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, investime kapitale dhe rezerva.¹⁴³ Megjithatë, me qëllim të marrjes së informatave të mëtejshme për shpenzimet e hollësishme aktuale të institucioneve të ndryshme, dikush duhet t’i kërkojë raportet buxhetore individuale të tyre, në të cilat publiku jo gjithmonë ka qasje të lehtë.

6.6. Gjyqësia dhe prokurorët

Strukturat serbe u larguan me përfundimin e luftës në vitin 1999, gjykatat formale nuk ekzistonin në fillim të Misionit të KB-ve në Kosovë. Si rezultat, UNMIK-u dhe OSBE-ja, bashkërisht, morën përsipër të rindërtojnë sistemin gjyqësor dhe të nxisin sundimin e ligjit në Kosovë. UNMIK-u u bë përgjegjës për themelimin e sistemit gjyqësor dhe shpalljen e ligjeve të aplikueshme, kurse OSBE-ja ofroi trajnime për proceset gjyqësore, mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut dhe zhvillimin afatgjatë të institucioneve si Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Shoqata e Avokatëve.

Gjyqësia ka mbetur kompetencë ekskluzive e UNMIK-ut deri tash së voni, kur disa kompetenca u bartën tek Ministria e Drejtësisë, e themeluar në fund të vitit 2005, dhe që ende mbetet çështje e autoritetit të fundit të PSSP-së.¹⁴⁴ Megjithatë, sipas dispozitave kushtetuese për ndarjen e përgjegjësisë, veçmas në mes të ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësisë, Ministria e Drejtësisë nuk është drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e sistemit gjyqësor.¹⁴⁵ Kjo është bërë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), i cili është organ i pavarur profesional, aktualisht i përbërë nga gjykatësit vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe prej disa jo-gjykatësve nga ekzekutivi, legjislativi dhe Akademia. KGJK-ja vepron nën autoritetin e PSSP-së dhe detyra e tij është të zhvillojë politika, të nxjerr rregullore dhe udhëzime dhe të bëjë mbikëqyrjen administrative të gjyqësisë dhe gjykatave.¹⁴⁶ Roli i Ministrisë së Drejtësisë është i kufizuar në zhvillimin e planifikimit të vet strategjik dhe operacional dhe të kapaciteteve buxhetore të ministrisë, miratimin e politikave të tjera brenda fushës së përgjegjësisë të veta, si dhe në ofrimin e trajnimeve dhe provimeve për gjykatës dhe prokurorë.¹⁴⁷

Sistemi gjyqësor sot në Kosovë funksionon përmes gjykatave komunale për kundërvajtje, një Gjykatë të Lartë për Kundërvajtje, gjykatave komunale, gjykatave të qarkut dhe gjykatave supreme të Kosovës. Detyrë e gjykatave komunale është të gjykojnë rastet kriminale që ndëshkohen me jo më shumë se pesë vite heqje lirie. Gjykatat e qarkut ofrojnë rishqyrtimin e rasteve të shkallës së dytë, të inicuar në komunë. Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë e shkallës së fundit, ka juridiksion

mbi tërë territorin e Kosovës dhe, po ashtu, vendos për çështjet që i përkasin Kornizës Kushtetuese.¹⁴⁸

Drejtësia në Kosovë është ofruar përmes përpjekjeve të kombinuara të gjykatësve vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe prokurorëve publikë, duke punuar si pjesë e një sistemi të unifikuar. Duke filluar me vetëm 47 gjykatës dhe prokurorë vendorë në vitin 1999, me afër 10 gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë në vitin 2000, sistemi i drejtësisë është konsoliduar në vitet e fundit. Në vitin 2004 kanë qenë 311 gjykatës vendorë dhe 84 prokurorë vendorë. Në mes të vitit 2004, numri i gjykatësve ndërkombëtarë dhe prokurorëve u ngrit në 24, kurse ngarkesa e tyre totale me lëndë deri atëherë numronte gjithsej 92 raste. Gjyqësia vendore kujdeset për t'i trajtuar të gjitha rastet civile dhe rreth 97 përqind të rasteve kriminale në Kosovë.¹⁴⁹

Buxheti i Kosovës i vitit 2005 kishte paraparë gjithsej 16.77 milionë euro për aktivitetet e Departamentit të Drejtësisë. Prej tyre, rreth 2.3 milionë euro ishin dedikuar për investime kapitale në ndërtesat e gjykatave, kurse pjesa tjetër ishte për t'u shpenzuar për paga administrative dhe profesionale dhe për trajnimin e stafit lokal.¹⁵⁰ Prej gjithsej 56.6 milionë euro, të zotuar për gjyqësinë nga donatorët ndërkombëtarë, në periudhën në mes të viteve 1999-2002, vetëm 31.2 milionë vërtet janë shpenzuar. Donatori më i madh sa i përket fondeve të zotuar ka qenë AER-i (23 milionë euro), por SHBA-ja ka qenë 'top' donatori sa i përket parave që vërtet janë shpenzuar (15.4 milionë euro, krahasuar me shpenzimet e AER-it prej 3.5 milionë euro).¹⁵¹ Një shumë tjetër prej 6.85 milionë euro është shpenzuar nga donatorët në gjyqësinë e Kosovës në vitin 2004.¹⁵²

Kosova ka mungesë të një procedure të pavarur për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve, pasi që vendimi i fundit për këto çështje ende mbetet tek PSSP-ja, kurse KGJK thjesht vetëm propozon gjykatësit për emërim. Për t'u emëruar si gjykatës profesional vendor një kandidat duhet: të jetë banor i përhershëm i Kosovës; të ketë integritet të lartë moral, të jetë i aftë për kryerjen e detyrave dhe punës gjatë gjithë kohës; të ketë diplomë univiersiteti në drejtësi; të ketë kaluar provimin e Jurisprudencës së Kosovës dhe provimin për Sistemin Gjyqësor; të ketë vijuar dhe përfunduar trajnimet e nevojshme të kërkuara me ligj dhe rregulloret tjera; dhe të ketë së paku tri vite përvojë ligjore.¹⁵³

Ekzaminimi i parregullësive të mundshme të gjykatësve dhe prokurorëve është përgjegjësi e Komisionit Disiplinor Gjyqësor (KDGJ) të KGJK. KDGJ-ja mund t'u shqiptojë gjykatësve vërejtje, paralajmërimë ose mund t'i suspendojë ata nga zyra, pa pagesë, për gjashtë muaj. Autoriteti për t'i larguar gjykatësit mbetet tek PSSP-ja, megjithëse KDGJ-ja mund të jap rekomandime për largime. Vendimet e KDGJ mund të dërgohen drejtpërdrejt në KGJK, me përjashtim të zëvendës kryetarit dhe anëtarëve të KGJK-së, të cilët janë pjesë e procesit të parë.¹⁵⁴

Emërimi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë kërkon procedura tjera nga ato që përdoren për të emëruar gjykatësit kosovarë. Ata janë të zgjedhur përmes një procesi rekrutues të UNMIK-ut, ndonjëherë me rekomandime nga Kombet e Bashkuara ose organizatat ndërkombëtare, siç është Këshilli i Evropës. Ata janë të

emëruar nga PSSP-ja me kontratë gjashtë mujore, me mundësi vazhdimi, ‘e cila është kontratë standarde për tërë stafin e misionit në Departamentin e Operaconeve Paqeruajtëse të KB-së.’¹⁵⁵ Rregullorja në fuqi përcakton në hollësi se për praninë në këto pozita, kandidati duhet të ketë: diplomë universiteti në drejtësi, pesë vite përvojë si gjykatës ose prokuror në vendin e tij; integritet të lartë moral; të mos jetë i ndjekur penalisht. Ata mund të largohen nga pozitat e tyre në rast të paaftësisë fizike ose mentale, shkeljeve serioze, ose gabimeve gjatë zbatimit të detyrës.¹⁵⁶

Duke iu dhënë mundësinë për mos vazhdimin e kontratës si një alternativë e largimit, atëherë nuk është befasuese për t’u kuptuar se deri më tani nuk janë bërë shumë largime të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë. Megjithatë, të paktën një gjykatësi nuk i është vazhduar kontrata, ndërsa disa gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë kanë pasur vetëm ripërtirje të kontratave tre mujore. Shumë prej tyre ose e kanë lëshuar me dëshirë Kosovën, ose iu është ripërtirë kontrata me kërkesë të tyre.¹⁵⁷

Sipas disa autorëve, afati shumë i shkurtër i periudhës për të cilën janë emëruar gjykatësit ndërkombëtarë paraqet kërcënim serioz në pavarësinë gjyqësore dhe në kualitetin e administrimit të drejtësisë.¹⁵⁸ Gjithashtu, procedurës së emërimit të gjykatësve ndërkombëtarë i mungon transparenca, si pjesë e kriterëve që gjykatësit duhet t’i përmbushin, nuk ka masa të tjera se si të përzgjidhen ata.¹⁵⁹ Transparenca e këtij sistemi si tërësi më tutje rrezikohet nga fakti se nuk ka ndonjë mekanizëm ligjor për adresimin e ankesave, ku përfshihen gjykatësit ndërkombëtarë. Përqendrimi i skajshëm i kompetencave ‘në duart e një personi, PSSP-së...paraqet kërcënim serioz për pavarësinë e gjyqësorit, duke ngritur dyshime për vlerësimin e njejtë të gjyqësisë, ekzekutivit dhe legjislativit’.¹⁶⁰

Gjithashtu, pozita e gjykatësve dhe prokurorëve vendorë ka qenë gjithmonë me rrezik, sepse në Kosovë, ndryshe nga gjykatat e ndërkombëtarizuara, të cilat i vijuan, gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë ‘kanë pasur juridiksionin më të gjërë ... [ata] mund ta merrnin cilindo rast të çfarëdo krimi, përfshirë rastet e reja dhe rastet që tashmë u ishin caktuar gjykatësve kosovarë, kurse... në vendet tjera [roli i gjykatësve vendorë dhe ndërkombëtarë] zakonisht ishte i limituar me ligj deri në disa kategori – [zakonisht] në krimet e luftës...’¹⁶¹

Korniza Kushtetuese thotë se, pas shterjes së të gjitha mundësive për rishikim administrativ, ‘secili person që ankohet se drejtpërdrejt është dëmtuar me vendimin e Qeverisë ose të ndonjë agjencie ekzekutive nën përgjegjësinë e Qeverisë, duhet të ketë të drejtën për rishikim gjyqësor të ligjshmërisë së atij vendimi...’¹⁶² Veç kësaj, ligji lejon përndjekjen individuale të personave të dyshuar për abuzimin e administratës publike ose funksioneve të shërbimeve publike, me dënime që sillen prej largimit, kufizimit të qasjes në shërbimin civil, si dhe burgimit deri në tetë vite.¹⁶³ Megjithatë – dhe më kryesorja - gjykatat e Kosovës nuk kanë juridiksion mbi veprimet e UNMIK-ut dhe personelit të tij vendor dhe ndërkombëtar.¹⁶⁴

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës ka dispozita për t’u marrë me gjykatësit e korruptuar. Gjykatësi, i cili me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm për vete

ose ndonjë person tjetër, ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet. Nga artikujt e gazetave dhe burimeve të tjera dytësore, është vërejtur se një gjykatës në Gjykatën Komunale të Prishtinës është arrestuar për marrjen e rryshfetit në vlerë prej 1.000 euro dhe është burgosur për tri vite.¹⁶⁵ Në vitin 2006, KGJK ka suspenduar një gjykatëse në Gjykatën Komunale të Gjakovës për abuzim të detyrës zyrtare dhe për marrje të rryshfetit. Hetimi për këtë rast ende po vazhdon.¹⁶⁶

Sa i përket akteve juridike për luftimin e plotë të korrupsionit, në vitin 2005, gjykatat komunale dhe të qarkut janë marrë me gjithsej 25 raste penale për korrupsion. Prej 25 rasteve, 10 janë bartur prej vitit 2004, kurse në vitin 2006 nuk është regjistruar asnjë rast. Prej 25 rasteve të regjistruara, vetëm 9 janë zgjedhur në vitin 2005, kurse 16 kanë mbetur të pazgjidhura. Gjashtë prej rasteve të zgjidhura kanë përfunduar me burgosje, një rast me gjobë dhe tri raste me gjoba të kushtëzuara.¹⁶⁷ Sipas Ombudspersonit:

‘problemi më i madh me të cilin ballafaqohet sistemi gjyqësor në Kosovë vazhdon të jetë pohimi për shtrirjen e gjërë të korrupsionit...[Ombudspersoni] vazhdon të pranojë një numër alarmant të ankesave për korrupsionin e mundshëm të gjykatësve. Mekanizmat ekzistues për parandalimin e korrupsionit duket se nuk kanë përmirëuar besimin e qytetarëve për gjykatat vendore’.¹⁶⁸

6.7. Shërbimi Civil

Sipas Rrregullorës së UNMIK-ut mbi Shërbimin Civil të Kosovës, nëpunës civil është ‘çdo person i punësuar i një organi të punësimit, rroga e të cilit paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës’ dhe i cili do të udhëhiqet nga parimet e: barazisë, neutralitetit politik dhe objektivitetit, ndershmërisë, sinqeritetit dhe përgjegjësisë, transparencës, meritës, jodiskriminimit, përfshirjes’.¹⁶⁹ Kjo përfshinë të punësuarit e ministrive të ndryshme, të pushtetit lokal, të agjencive të tjera qeveritare, punonjësit e shëndetësisë, personelin arsimor etj. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të ndihmojë funksionimin e një Shërbimi Civil efikas dhe të paanshëm në Kosovë.

Shërbimi Civil është nën përgjegjësinë e MSHP-së. Ministria është përgjegjëse për: zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikës së punës për një shërbim civil shumetnik, të paanshëm, profesional dhe të përgjegjshëm; zhvillimin dhe koordinimin e zbatimit të politikës së punës për krijimin dhe aftësimin e kuadrove për Shërbimin Civil; administrimin e sistemit të pagesave dhe listën e pagave të Shërbimit Civil.¹⁷⁰

Me qëllim të arritjes së këtyre synimeve, në vitin 2003, MSHP-ja ka nxjerrë 12 udhëzime administrative, që lidhen me procedurat e: punësimit, kontratave, periudhës provuese, disiplinës, ankesës, përshkrimit të punës, vlerësimit të kryerjes së detyrave, prezencës në punë, procedurat e pushimit, regjistrimit të personelit dhe mundësive të barabarta.¹⁷¹ Në vitin 2005, MSHP-ja mori përsipër përgatitjen e Projektligjit për Kodin e Mirësjelljes së Nëpunësve Civil dhe Projektligjin mbi Shërbimin Civil si dhe administrimin e sistemit të pagesave për të gjithë të punësuarit që paguhet nga Buxheti i Kosovës.

Qëllimi i Projektigjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës është përcaktimi i rregullave të unifikuara për: kushtet dhe procedurat e punësimit të njerëzve në Shërbimin Civil të Kosovës, mënyrën e nisjes dhe përfundimit të mardhënies së punës, zhvillimin e karrieres dhe të drejtat dhe detyrat e nëpunësve civil, kështu që të krijohet një shërbim civil i qëndrueshëm, profesional dhe efikas.¹⁷² Megjithëse mendohet se Rregullorja e UNMIK-ut mbulon shumë nga çështjet e cekura më lart, ligji i ri është shumë më i detajizuar.

Në vitin 2005, numri i llogaritur i nëpunësve civil në Kosovë ka qenë 66.493, ndërsa gjithësej buxheti bruto për pagat e të punësuarve ka qenë 165 milionë euro.¹⁷³ Kjo është gati një e treta e Buxhetit të Kosovës që shkon për pagat e shërbyesve civil. Paga mesatare në Shërbimin Civil të Kosovës ka qenë 181 euro.

Vet MSHP-ja ka pasur 1.019 të punësuar. Buxheti i miratuar për MSHP për vitin 2005 ka qenë 16 milionë dhe 9.5 milionë për vitin 2006.¹⁷⁴ Për Departamentin e Administratës së Shërbimit Civil (DASHC) - departamenti më i rëndësishëm i MSHP-së për zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve mbi shërbimin civil - buxheti për vitin 2006 ka qenë 281.027 euro, më i lartë se buxheti i vitit 2005 me 137.000 euro¹⁷⁵

Institucioni kryesor për trajnime, përgjegjës për aftësimin e përgjithshëm të nëpunësve civil të Kosovës, është Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP), një agjenci ekzekutive në kuadër të MSHP-së, që është themeluar në vitin 2003.¹⁷⁶ Buxheti i IKAP-it sigurohet nga MSHP-ja, ndonëse mund të plotësohet me fonde të tjera të jashtme. Në vitin 2005, buxheti i IKAP-it ka qenë 221.154 euro, e që në vitin 2006 u zvogëluar në 179.954 euro. Në vitin 2006 ka pasur gjithësej 18 të punësuar.¹⁷⁷

Thënë shkurt, detyrat e IKAP-it janë: të këshillojë MSHP-në për strategjinë e aftësimit dhe të jap rekomandime për politikën e aftësimit të nëpunësve civilë të Kosovës; të hartojë programe të përshtatshme për plotësimin e nevojave në pajtim me standardet evropiane dhe të vlerësojë rezultatet e programeve të aftësimit të organizuara për këtë qëllim; të veprojë si institucion kërkimor për zhvillimin e administratës publike në Kosovë; si dhe të koordinojë programet e donatorëve për aftësimin e nëpunësve civil.¹⁷⁸

Sipas ligjit të aplikueshëm, nëpunësit civil në Kosovë 'kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike dhe të organizatave të tjera politike, por duhet të përmbahen nga angazhimi i tyre aktiv në aktivitetet politike'.¹⁷⁹

Kodi i Mirësjelljes për Shërbimin Civil obligon nëpunësit civil të 'kryejnë punët e publikut në mënyrë të shpejtë, me kurtuazi, me mirësjellje, me dashamirësi dhe pa paragjykime apo neglizhencë'. Ata, po ashtu, janë të obliguar të 'mos e keqpërdorin funksionin e tyre zyrtar për përfitime personale apo për përfitime të tjerëve... [dhe të]...i përdorin mjetet publike në mënyrë të ligjshme dhe në mënyrë efektive dhe vetëm sipas autorizimeve të organit të punësimit për të cilin punojnë'. Ata, po ashtu, duhet 'të mos, përveç rasteve kur është e nevojshme për kryerjen e detyrave zyrtare, nëpunësit civilë nuk përdorin dhe nuk japin informata që janë fituar si rezultat i pozitës së tyre zyrtare'. Shërbyesit civil po ashtu kërkohet që të mos 'pranojnë nga asnjë person apo subjekt tjetër të holla, dhurata, mikpritje apo ndihma lidhur me

detyrat e tyre zyrtare ...’¹⁸⁰ Në momentin që bëhet funksional, Agjencia Kundër Korrupsionit do të jetë organ përgjegjës për mbikëqyrjen e kësaj dispozite.

Nëpunësi civil duhet t’i shmangët ‘çfarëdo konflikti të interesave që mund të ndikojë negativisht në kryerjen e detyrave të tij zyrtare’ dhe duhet ta njoftojë ‘organin e punësimit për çfarëdo konflikti ekzistues apo të mundshëm të interesave’. Ligji po ashtu thotë se nëpunësi civil ‘duhet të deklarojë dhe duhet të përjashtohet nga çdo diskutim apo vendim që lidhet me çështjet në të cilat ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes, ka çfarëdo interesash të rëndësishme personale ose financiare’.¹⁸¹

Ligji parasheh se punësimi në Shërbimin Civil bëhet sipas një konkurrence të ndershme e të hapur, në bazë të meritës dhe në pajtim me parimin e përfaqësimit të barabartë të komuniteteve në Kosovë dhe përfaqësimit të barabartë gjinor.

Megjithatë, pavarësisht nga këto rregullore për garantimin e paanshmërisë, meritokracisë dhe sjelljeve të duhura të nëpunësve civil, vlerësimet e shtypit paraqesin një pasqyrë tjetër, në të cilën një kandidat duhet të ketë ‘lidhje të forta’ në mënyrë që të bëhet punëtor i institucioneve publike.

Për shembull, gazeta ditore shqiptare, *Express*, shkruante në qershor të vitit 2005 se Ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, Bujar Dugolli, ka punësuar vjehrrin e tij në ministrinë e tij, me arsyen se ‘ai ka nevojë për njerëz të besueshëm për ta udhëhequr Ministrinë’. Artikulli po ashtu vazhdonte me pohimet se ish Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, Ali Sadria, po ashtu ka punësuar një numër të madh të të afërmeve gjatë mandatit të tij. Gazeta po ashtu ka kritikuar ministrin aktual të MEF-it, Haki Shatri, duke pohuar se ai ‘po ashtu mund të jetë infektuar nga virusi i nepotizmit i lënë prapa nga Ali Sadria’, duke sqaruar se vëllau i Shatrit, Nexhati, është zgjedhur udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Presidencën e Kosovës. Artikulli ka përfunduar me tregimin nga Aeroporti i Prishtinës, NPP, duke pohuar se ‘të punësuarit atje nuk e thërresin njëri tjetrin “kolegë” ose “shef” por “dajë”, “nip” dhe “kushëri”...’ Sipas këtij artikulli, shefi i sigurimit të aeroportit ka pohuar se ka punësuar rreth 17 kushërinj në këtë kompani publike.¹⁸²

Edhe pse ky përshkrim duket i zyrtarë - Shërbimi Civil është parë si një nga institucionet më të korruptuara dhe me shumë pak mekanizma për ta zhdukur këtë perceptcion - janë disa raste të ndëshkimeve që janë zbatuar ndaj nëpunësve civil të zënë duke marrë rryshfet. Rasti i fundit (i raportuar në mediat vendore) ka qenë në mes të gushtit të viti 2006, kur dy mjekë nga spitali kryesor në Prishtinë, kanë rrezikuar jetën e pacientit të tyre 8 vjeçar, kur ata e shtyen operacionin derisa prindërit nuk paguan ca para për këtë.¹⁸³ Ky ka qenë njëri prej pak rasteve të mjekëve nga kjo klinikë, që janë arrestuar nga policia për shkak se kanë marrë rryshfet.

6.8. Policia*

Herët, në vitin 1990, pjesa më e madhe e policëve shqiptarë u shkarkuan nga forcat policore, që do të thotë se pas tërheqjes së trupave serbe në vitin 1999, UNMIK-u është dashur t'i krijojë forcat e brendshme të sigurisë nga zeroja. Përgjegjësia kryesore për ngritjen dhe zhvillimin e strukturës policore në Kosovë i ka takuar Shtyllës I të UNMIK-ut, përkatësisht Policisë dhe Drejtësisë, kurse OSBE-ja ishte përgjegjëse për trajnimin e policëve mbi të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe mbi principet e policisë në bashkësi/komunitet.¹⁸⁴

Sot në Kosovë, policia është një strukturë mjaft e kompletuar, me afër 3.400 policë civil ndërkombëtarë (CIVPOL) dhe mbi 7.000 pjesëtarë vendorë të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK).¹⁸⁵ Për të pasur një pasqyrë të punës së tyre, është me rëndësi të ceket se Policia e UNMIK-ut ka regjistruar 500 vrasje gjatë gjysmës së dytë të vitit 1999, 245 në vitin 2000, 136 në vitin 2001, 68 në vitin 2002 dhe 37 vrasje gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2003. Në vitin 2003, policia e Kosovës është përkrahur me rreth 1.500 punëtorë administrativ vendorë.¹⁸⁶

Buxheti për Shërbimin Policor të Kosovës, është i kombinuar nga fondet e Buxhetit të Kosovës, si dhe nga donacionet financiare dhe teknike të donatorëve ndërkombëtarë. Buxheti i Kosovës në vitin 2003 ndau 39.9 milionë euro për SHPK-në, i cili në vitin 2006 u rrit në 56.85 milionë euro.¹⁸⁷ Këto fonde nuk përfshijnë pagat e policëve ndërkombëtarë të UNMIK-ut.¹⁸⁸ Më vonë, në vitin 2006, një shumë tjetër prej 2.83 milionë euro është ndarë për Shkollën e SHPK-ës, kurse Inspektorati i sapoformuar Policor i Kosovës (IPK) mori 362.000 euro.¹⁸⁹ Më vonë, në periudhën 1999-2004, donatorët zotuan rreth 78.14 milionë euro për përkrahjen dhe zhvillimin e SHPK-së, më pas shpenzuan vetëm 66.11 milionë euro, me kontribuesit më të mëdhenj - SHBA-të dhe Kanadanë.¹⁹⁰

Sa i përket operacioneve ditore, përveç komandës rajonale në qytetin etnikisht të ndarë të Mitrovicës, përgjegjësia operationale në shumë stacione policore dhe komanda rajonale është bartur nga CIVPOL-i tek SHPK-ja.¹⁹¹ Veç kësaj, në fillim të vitit 2006, Shtylla I-rë e UNMIK-ut është reduktuar në një zyrë koordinuese dhe përgjegjësitë administrative, financiare dhe teknike të SHPK-së janë bartur tek Ministria e sapoformuar e Punëve të Brendshme (MPB).¹⁹² Megjithatë, edhe pse Zëvednës Komisioneri (vendor) i SHPK-së punon nën udhëzimet e ministrit, ligjërisht SHPK-ja ende mbetet nën autoritetin e drejtpërdrejtë të PSSP-së dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e një Komisioneri Ndërkombëtar të Policisë së UNMIK-ut.¹⁹³

Komisioneri i Policisë së UNMIK-ut, i cili po ashtu është kryesues i SHPK-së, është emëruar nga PSSP-ja, nga stafi ndërkombëtar. Emërimi i pjesëtarëve të tjerë të lartë të policisë është i rregulluar me Rregulloren 2005/54 të UNMIK-ut *Mbi Kornizën dhe Parimet Drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës*.

* Në Kosovë, prokurorët publik janë të organizuar brenda sistemit të gjyqësisë dhe tani është nën përgjegjësinë e ministrisë së re, Ministrisë së Drejtësisë.

Për të qenë i përshtatshëm për t'u bërë Zëvendës Komisioner i Policisë në SHPK-së ose Ndihmës Zëvendës i Komisionerit të Policisë, personi duhet të ketë: diplomë universitare ose shkallë të barasvlerëshme arsimore profesionale të cilën e ka fituar në ndonjë institucion të pranuar arsimor të policisë në Kosovë apo jashtë Kosovës; përvojë policore, të ketë shërbyer në post dy grada më të ulëta se ai për të cilin është zgjedhur për emërim, qoftë ai post i vërtetë apo si ushtrues detyre në atë post; dhe të mos jetë shpallur fajtor për ndonjë vepër penale apo shkelje të rëndë disiplinore. Emërimet bëhen nga PSSP-ja, bazuar në rekomandimet për së paku tre kandidatë të përshatshëm, të bëra nga Komisioni për Emërimet të Larta dhe për Disiplinë e Çështje Disiplinore në Polici (KELDP).

KELDP-ja është paraparë të jetë e pavarur nga SHPK-ja dhe është formuar nga grupi që përbëhet prej të gjithë sekretarëve permanent të ministrive dhe nga një person i emëruar nga secili kuvend komunal. Në funksionin e vet këshillues, mblihet në një grup që përbëhet prej një kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi, të zgjedhur nga radhët e PSSP-së, si dhe pesë anëtarëve të tjerë, të zgjedhur në bazë të sistemit të rotacionit.

Përveç rekomandimit të kandidatëve për poste të larta, KELDP po ashtu ka një rol këshillues në proceset e rënda disiplinore kundër personelit të SHPK-së. Përveç në rastet e shkarkimeve, kur kërkohet miratimi i posaçëm i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, të gjitha ndëshkimet e tjera për shkeljet e rënda të personelit të SHPK-së nxjerren nga Komisioneri i Policisë së UNMIK-ut, bazuar në rekomandimet e KELDP-së dhe pas konsultimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Megjithatë, PSSP-ja ka të drejtën e rezervuar që të largojë ose kërkojë dorëheqjen e cilitdo polic, përfshirë edhe Zëvendës Komisionerin e SHPK-së, për shkak të gjetjeve të parregullësive personale, ose keqpërdorimit ose moskryerjes së detyrës zyrtare. Përveç vendimeve të ndërmarra nga PSSP-ja, vendimet e tjera, të lëshuara për shkak të masave disiplinore, mund të kundërshtohen në gjykatat kompetente.

Veç kësaj, Rregullorja e SHPK-së parasheh themelimin e IPK-së, si një agjenci ekzekutive në kuadër të MPB, i ngarkuar për mbikëqyrjen e pavarur të Shërbimit Policor të Kosovës. Përgjegjësitë e IPK-së janë të: 'bëjë kontrollime dhe inspektime në Shërbimin Policor të Kosovës dhe të raportojë për përmbushjen dhe efektshmërinë e këtij shërbimi në arritjen e objektivave; dhe (b) hetojë pohimet për kryerjen e shkeljeve të rënda disiplinore nga policët ose personeli civil (SHPK), dhe nëse ka rekomandime për ndonjë ndëshkim, të cilin duhet shqiptuar, ua paraqet ato KELDP-së'. Kur të bëhet funksional, IPK do të përbëhet nga një drejtor ekzekutiv dhe një grup i inspektorëve krejtësisht të pavarur nga SHPK-ja.¹⁹⁴

Sipas zyrtarëve të SHPK-së, brenda Shërbimit Policor ka pasur shumë pak raste të korrupsionit, dhe këto zakonisht kanë qenë të kufizuara në rryshfete të vogla. Sipas një burimi, suspendimi i zyrtarëve të akuzuar për korrupsion është bërë vetëm në rastin e një zyrtari të lartë të komandës në Mitrovicë, një hetuesi policor, si dhe i disa policëve patrollues.¹⁹⁵ Duke i përcjellur artikujt e shtypit ditë mbi SHPK-në, Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) ka gjetur një artikull që raporton se tre zyrtarë policor të Shërbimit Policor të Kosovës, në komunën e Gjilanit, janë arrestuar për

marrje të mitës në vlerë prej 18 eurosh, nga një ngasës i cili është dashur të paguaj 200 euro për kundërvajtje trafiku.¹⁹⁶ Në përgjithësi, SHPK-ja zë relativisht një pozitë të lartë në sytë e opinionit publik, sipas të dhënave të herë pas hershme nga anketat ku SHPK-ja është një prej institucioneve më të respektuara në Kosovën e pas luftës.¹⁹⁷

Që nga përfundimi i luftës, UNMIK-u ka themeluar një numër të njësive të përkohshme të specializuara për hetimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Për shembull, në fillim të vitit 2003, Policia e UNMIK-ut themeloi FIU-në, të përbërë nga dhjetë inspektorë financiarë nga *Guardia di finanza*, përgjegjës për hetimin e korrupsionit të zyrtarëve në organizatat e financuara nga fondet publike.¹⁹⁸ Ata ishin përgjegjës për arrestimin e ish zyrtarit të lartë të Kompanisë së Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK), i cili më vonë u lirua nga gjyqësia e Kosovës. Njësia FIU po ashtu ka udhëhequr një hetim, që më vonë rezultoi me persekutimin e suksesshëm të një ish zyrtari të UNMIK-ut nga Zyra e UE-së Kundër Mashtrimeve (OLAF).

Tani, në kuadër të SHPK-së, janë disa njësi të përhershme, të specializuara për t'u marrë me krimin e organizuar dhe rastet e korrupsionit. Drejtorati për Krime Serioze i SHPK-së, i cili vepron nën autoritetin e Zëvendës Komisionerit Policor vendor, ka dy njësi kryesore në këtë fushë: Njësia Kundër Korrupsionit dhe Njësia për Kundërvajtje Ekonomike. Veç kësaj, në kuadër të SHPK-së poashtu është Drejtorati për Krimin e Organizuar, i cili ende udhëhiqet nga policët ndërkombëtarë dhe është drejtpërdrejt në përgjegjësinë e UNMIK-ut.¹⁹⁹

6.9. Prokurimi publik

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, prokurimi publik fillimisht është rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 2/1999 të UNMIK-ut, dokument i cili bazohej kryesisht në rregulloret e Bankës Botërore.²⁰⁰ Tani është i rregulluar me *Ligjin për Prokurimin Publik*, i cili u aprovua nga Kuvendi i Kosovës dhe u shpall nga PSSP-ja në vitin 2004.²⁰¹ Synimi i Ligjit të ri është që t'i harmonizojë aktivitetet në Kosovë në një vijë me kërkesat e BE-së dhe me praktikatat më të mira të njohura ndërkombëtare.

Qëllimi i këtij ligji është 'të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe të burimeve publike në Kosovë' duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike, që përfshihen ose interesohen në aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me fondet ose burimet e tilla.

Duke u bazuar në institucionet e themeluara më herët me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut, Ligji themeloi 3 organe: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe Komisioni i Rregullave për Prokurim Publik (Komisioni i Rregullave).

Sipas ligjit, KRPP-ja është organ i pavarur që i raporton drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës, që udhëhiqet nga bordi pesë anëtarësh, të cilët janë të propozuar nga

Qeveria dhe të emëruar nga Kuvendi me një mandat prej pesë vitesh. Është përgjegjës për ‘...zhvillimin e përgjithshëm dhe veprimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë... sigurimin që sistemi i tillë të veprojë në mënyrë që të arrijë shfytëzim sa më të lartë, racional, efikas dhe transparent të fondeve dhe burimeve publike dhe të inkurajojë konkurrencën...’

KRPP-ja, po ashtu, ka pushtetin dhe përgjegjësinë për të: (a) vëzhguar dhe kryer revizionet financiare *ad hoc* për një rast të veçantë ose në baza të rregullta gjatë aktiviteteve të prokurimit publik; (b) hetuar, me vetëiniciativë ose me kërkesën e një autoriteti publik, ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit ku dyshohet se janë bërë shkelje të këtij ligji; (c) vëzhguar dhe mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore dhe rregullave të prokurimit publik.

APP-ja është agjenci e re ekzekutive e themeluar brenda Qeverisë, drejtori dhe anëtarët e bordit të së cilës janë të propozuar nga Qeveria dhe të emëruar nga Kuvendi, me mandate prej tri vitesh. Roli i APP-së është të kryej ‘aktivitete të ndërlukuara të prokurimit’ në emër të autoriteteve kontraktuese në rastet kur konstatohet ‘që për arsye të ekspertizës profesionale, ekonomikitetit, efikasitetit ose për ndonjë qëllim tjetër legjitim’, aktiviteti është më së miri të kryhet nga APP-ja. APP-ja, po ashtu, është përgjegjëse për krijimin dhe mirëmbajtjen e një Regjistri të azhurnuar të Prokurimit Publik, si dhe për krijimin dhe mirëmbajtjen e një baze të të dhënave për qasje publike si dhe faqen në internet, që përmban informacionet aktuale mbi të gjitha mundësitë dhe aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë.

Komisioni i Rregullave përbëhet nga tre anëtarë: prej të cilëve njëri është nga KRPP-ja (po ashtu udhëheqës i Komisionit të Rregullave), tjetri nga APP-ja dhe i fundit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Komisioni është përgjegjës për përpilimin e Kodit Etik të prokurimit si dhe të rregullave detaje të prokurimit publik për zbatimin e ligjit: rregullat, udhëzimet, direktivat, dokumentet dhe formularët që autoritetet kontraktuese, zyrtarët e prokurimit, ndërmarrjet dhe personat duhet t’i respektojnë.

Në vitin 2005, Buxheti i Kosovës kishte paraparë 15 të punësuar për APP-në dhe 31 të punësuar për KRPP. Në të njejtin vit, PPA-së i është ndarë buxheti prej 140.000 euro, ndërsa KRPP-ja është dashur të marrë afër 350.000 euro.²⁰² Më vonë, gjatë viteve 2004-2005, AER-i ndau 970.000 euro për të përkrahur përgatitjen e legjislacionit sekondar dhe ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët e prokurimit publik, të cilës shumë iu shtuan 1.5 milion, përkrahje për KRPP-në në vitin 2005-2006.²⁰³ Megjithatë, disa zyrtarë besojnë se, pavarësisht këtyre investimeve, stafi i prokurimit përgjithësisht është i papërgatitur mirë dhe se partitë politike shpesh ndikojnë në proceset e tyre të prokurimit.²⁰⁴

Rregullat e prokurimit publik, siç janë vendosur në Ligjin e Prokurimit, janë në dispozicion për publikun në tërësi, prej Gazetës Zyrtare të Kuvendit të Kosovës, e po ashtu edhe në formë të shkurtuar, në faqen e internetit të PPA-së. Faqja e PPA-së, po ashtu, përmban infomata detaje mbi mundësitë dhe aktivitetet e veçanta të prokurimit në Kosovë.²⁰⁵

Përveç rasteve të kufizuara të specifikuara qartë në ligj, autoriteti kontraktues është i obliguar t'i përdor procedurat e hapura kur kryen aktivitete të prokurimit ... Autoriteti kontraktues mund të vendos kualifikim minimal të caktuar për operatorët ekonomik, nëse mendon se vetëm në atë mënyrë mund të sigurojë një produkt ose shërbim të kualitetit të duhur. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedura të ndryshme të kufizuara, të cekura në ligj, për të udhëhequr një aktivitet të prokurimit, vetëm nëse merr kërkesë me shkrim për autorizim nga APP-ja. Veç kësaj, nëse janë marrë më pak se tre tenderë të përgjegjshëm, autoriteti kontraktues duhet ta anulojë aktivitetin e prokurimit dhe të iniciojë një të ri, përveç nëse kjo mund t'i jap arsye detyruese KRPP-së se një veprim i tillë nuk do të rezultojë në paraqitjen e një numri më të madh të tenderëve të përgjegjshëm.²⁰⁶

Autoriteti kontraktues duhet ta përgatis një njoftim indikativ, duke cekur nevojat e tij të prokurimit, nëse gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore, ka për qëllim dhënien e një kontrate për furnizim ose shërbim, që ka një vlerë të parashikuar minimale prej 750,000 euro, ose të një kontrate të punëve që ka një vlerë të parashikuar minimale prej 1 milion euro. Nëse autoriteti kontraktues ka dhënë një kontratë publike, atëherë, brenda dy ditëve të punës pas dhënies së kontratës, duhet të përgatis njoftimin mbi dhënien e kontratës. Autoriteti kontraktues është i obliguar menjëherë t'i dorëzojë APP-së versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi që është përgatitur, i cili më vonë duhet të përfshihet në Regjistrin e Prokurimit Publik, si dhe t'i publikojë në faqen e vet të internetit - brenda dy ditëve të punës pasi të ketë marrë njoftimin.²⁰⁷

Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, KRPP-ja, në çdo kohë pas dhënies, por para nënshkrimit të kontratës publike, mund të kërkojë që dhënia e kontratës së tillë dhe procedura që shpie drejt dhënies së tillë të shqyrtohen detajisht nga KRPP-ja, ose nga një komision për shqyrtimin e dhënies së kontratës.²⁰⁸

Veç kësaj, nëse një palë e interesuar i përmbush disa kritere bazike të paraqitura në ligj, ai ose ajo mund t'i parashtrorë ankesë KRPP-së 'në çdo fazë të aktiviteteve të prokurimit dhe në lidhje me ndonjë veprim ose lënien jashtë ...që supozohet të jetë në kundërshtim me ..ligjin'.²⁰⁹ Në rastet kur kontrata është dhënë, parashtruesi i ankesës, mund ta dorëzojë ankesën vetëm brenda afatit prej tetë ditëve kalendarike, pas datës së publikimit të njoftimit të kontratës. KRPP-ja është e obliguar të formojë një ose më shumë panele shqyrtuese, të cilat kanë autoritet dhe përgjegjësi për t'i shqyrtuar ankesat e marra nga palët e interesuara dhe të zhvillojnë hetime për faktet që kanë shkakuar ankesat e tilla. Gjithashtu, paneli shqyrtues mund të jap urdhër për pezullimin e dhënies së kontratës publike dhe ta urdhërojë autoritetin kontraktues që ta anulojë vendimin dhe/ose t'ia paguaj kompensimin parashtruesit të ankesës.

Nëse parashtruesi i ankesës mendon se vendimi përfundimtar i një paneli shqyrtues ose KRPP-së është në kundërshtim me faktet ose me këtë ligj, ai ose ajo mund të ankohet kundër një vendimi të tillë para një gjykate kompetente. Nëse gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës në ankesën e mëparëshme, që i është dorëzuar KRPP-së, nuk ka qenë i pavlefshëm, gjykata do të lëshojë një urdhër (i) duke e shfuqizuar ose ndryshuar çfarëdo urdhri ose vendimi të marrë nga KRPP-ja, dhe/ose (ii) kërkojë nga autoriteti kontraktues që t'ia paguaj parashtruesit të ankesës kompensimin adekuat.

Ligji për Prokurimin Publik u ndalon përfaqësuesve të autoriteteve kontraktuese të pranojnë çfarëdo oferte në para ose ofertë pune që do tentonte të ndikonte në vendimet e prokurimit, si dhe veprimet penguese dhe kërcënuese që tentojnë të ndikojnë në rezultatin e aktivitetit të prokurimit. Ndërmarrjet dhe personat që tentojnë të ndikojnë në vendimet e prokurimit në këtë mënyrë, përgjigjen penalisht për veprimet e tyre. Gjithashtu, një nëpunës civil ose zyrtar i autoritetit kontraktues, që vepron në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, do të largohet dhe gjobitet për shpërdorimin e tij ose saj.

Megjithatë, edhe pse Ligji është mjaft voluminoz dhe shumë i detajizuar në dispozitat e tij, praktikat e tanishme të prokurimit publik të Kosovës janë larg nga përmbushja e standardeve ndërkombëtare, siç synon Ligji. Dëshmia më e mirë për këtë mund të haset në raporte të ndryshme të Auditorit Gjeneral, i cili në raportin e adutimit për Ministrinë e Komuniteteve dhe të Kthimit, për shembull, shkruan se ‘është një mos përputhshmëri e madhe mes kërkesave përkatëse ligjore dhe rregullative, veçanërisht të atyre të specifikuara në Ligjin aktual të Prokurimit Publik...[përfshirë]...dështimin për të siguruar numrin e nevojshëm të tenderëve, siç është shpjeguar në rregullore...[dhe]...dhënien e kontratave pa pasur në dispozicion specifikimet teknike ‘.²¹⁰ Komete të ngjashme mund të gjenden edhe në raporte të tjera të Auditorit Gjeneral, dhe ato mund të jenë si: shpërndarja e kontratave në tenderë me më pak se që është shënuar ligjërisht me minimum tre aplikues; furnizimi me mallëra pa themelimin e një regjistri adekuat, pagimi i kontraktorëve para përfundimit të projektit; ndryshueshmëria në mes të datës së hapjes së tenderit dhe datës kur shpallja e tenderit është publikuar në media; shpenzime të pa autorizuar; prokurimi i udhëhequr nga personeli i pacertifikuar, etj.²¹¹

Gjithashtu, disa zyrtarë të prokurimit publik ankohen se ‘vendimet përfundimtare mbi dhënien e kontratave të prokurimit shpesh janë të ndikuara nga zyrtarët e lartë politikë’.²¹² Deklarat që ilustrojnë pohime të tilla, vërtet mund të hasen në shumë media. Për shembull, një artikull në gazetën ditore shqiptare *Express*, në Prill të vitit 2006, citon një nëpunës civil, i cili pohon se Sekretari Permanent në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor ka marrë vendimin përfundimtar për dhënien e tenderit përbrenda ministrisë së tij.²¹³

Autoritetet e prokurimit të insitucioneve vendore nuk kanë qenë të vetmet nën sulmin e mediave – institucionet e UNMIK-ut nuk janë kursyer nga raportet me akuza për parregullësi në proceset e tenderimit. AKM-ja, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të privatizimit në Kosovë, u gjend nën vëmendjen e gjërë të mediave kur miratoi privatizimin e fabrikës më të madhe për përpunimin e metalit, NPSH ‘Ferronikeli’. Dy akuza kryesore ishin hedhur kundër AKM-së nga disa burime: e para, se AKM-ja ka miratuar procesin e tenderit, megjithëse ka dështuar në përmbushjen e kushteve ligjore për t’i pasur së paku tre ofertues; dhe e dyta, sepse ka vendosur t’ia jap kontratën ofertuesit të dytë, me çmim më të lartë, ndërsa ofertuesi i parë u tërhoq nga procesi për shkak se ministri i Tregtisë dhe i Industrisë kinse i ka kërkuar kompensim financiar, si kusht për dhënien e kontratës.²¹⁴

6.10. Ombudspersoni

Institucioni i parë i Ombudspersonit në Kosovë (IOK) është themeluar në vitin 2000, me Rregulloren e UNMIK-ut *mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë*.²¹⁵ Ky institucion momentalisht është në udhëkryq, duke ditur që ligji i ri – Rregullorja e UNMIK-ut *mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë*, ka kaluar në vitin 2006, duke sjellur një varg ndryshimesh, veçanërisht sa i përket udhëheqjes, juridiksionit dhe raportimit të këtij institucioni (IOK).²¹⁶

Sipas Rregullores të vitit 2000, IOK duhej të udhëhiqej nga një person ndërkombëtar, i zgjedhur nga dhe që do t'i raportonte drejtpërdrejtë PSSP-së. Legjislacioni i vitit 2006, ka bërë dy ndryshime të rëndësishme në këtë drejtim. E para, Ombudspersoni i ri duhet të jetë 'banor i përhershëm i Kosovës'. E dyta, ai ose ajo duhet të zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës dhe do t'i përgjigjet këtij.

Po ashtu, është bërë një ndryshim i rëndësishëm sa i përket juridiksionit të këtij institucioni (IOK). Sipas Rregullores së vitit 2000, roli IOK-së ka qenë t'i 'pranojë dhe hetojë ankesat nga çdo individ apo person juridik në Kosovë' sa u përket shkeljeve të të drejtave të njeriut ose keqpërdorimit të autoritetit nga administrata e përkohshme civile apo nga ndonjë institucioni qendror ose lokal në Kosovë'.²¹⁷ Rregullorja e re kufizon rolin e IOK-së vetëm në ankesat që lidhen me keqpërdorimin e autoritetit nga insitucionet e Kosovës. Legjislacioni i vitit 2006, vetëm përcakton se IOK 'mund të lidhë marrëveshje bilaterale me...[PSSP] mbi procedurat për trajtimin e rasteve ku përfshihet UNMIK-u'.²¹⁸

Sa i përket detyrave dhe përgjegjësive të OIK-së, përmbajtja e ligjit nuk ka ndryshuar. Sipas të dy rregulloreve, OIK pranon ankesat nga çdokush që mendon se ai ose ajo ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut ose keqpërdorimit të autoritetit dhe zhvillon hetime në lidhje me këto ankesa. Ombudspersoni, po ashtu, mund të fillojë hetime në mungesë të një ankese individuale (të ashtuquajtura hetime *ex-officio*). Përgjegjësitë e Ombudspersonit, po ashtu, përfshijnë mbikëqyrjen e politikave dhe të ligjeve të miratuara nga autoritetet, për të siguruar se ata i respektojnë standardet e të drejtave të njeriut dhe kërkesat e qeverisjes së mirë. OIK-u kurrë nuk është marrë me konfliktet në mes të individëve privat.

Ligji ka mbetur i pandryshuar në lidhje me premtimin për pavarësinë e IOK-ut, ndërsa është zgjatur koha e emërimit të zyrtarëve kryesor. Sipas rregullores së vitit 2000, Ombudspersoni dhe zëvendësit e tij ose saj kanë pasur mandate dyvjeçare, me mundësi të riemërimit për një mandat tjetër dyvjeçar, ndërsa sipas rregullores së tanishme, mandati i tyre është zgjatur në katër vite, me mundësi riemërimi për një mandat tjetër katërvjeçar.

Rregullorja e vitit 2006 parasheh që Ombudspersoni (dhe zëvendësi i parë i Ombudspersonit) duhet të emërohet nga Kuvendi i Kosovës, me përkrahjen e shumicës, me mundësi të largimit nëse propozimi ka kaluar me mbështetjen e dy të tretave të shumicës dhe një grup i kushteve të cekura është vërtetuar se qëndrojnë. Veç kësaj, ligji i njejtë po ashtu parasheh imunitet ligjor për Ombudspersonin dhe

zëvendësit e tij ose saj 'lidhur me fjalët e thëna apo të shkruara dhe veprat e kryera nga ata në cilësinë e tyre zyrtare'.

Ligji parasheh fshehtësi të plotë të OIK-ut lidhur me të gjitha informatat dhe të dhënat e marra, veçanërisht sa i përket sigurisë së ankuesve dhe dëshmitarëve. Qasja në dokumentet e klasifikuara është e kufizuar vetëm në personelin e lartë dhe hetuesit të cilët direkt janë të caktuar të merren me rastin, ndërsa punëtorët tjerë mund t'i përdorin vetëm nëse autorizohen nga vetë Ombudspersoni.²¹⁹

Megjithatë, Ombudspersoni ka paksa autoritet moral ndaj sjelljeve të institucioneve publike dhe ka fuqinë ligjore për t'i hetuar rastet dhe për të dhënë rekomandime, por ai ose ajo nuk ka fuqi ekzekutive për t'i detyruar partitë që të përgjigjen. Me fjalë tjera, siç thotë vet Ombudspersoni, 'Ombudspersoni është...zëvendësim i gjykatave dhe nuk mundet drejtpërdrejt t'i hetojë krimet, ndryshojë vendimet e gjykatave, ose të lëshojë vendime detyruese'.²²⁰

Që nga zanafilla e institucionit në vitin 2000 e tutje, deri në fund të vitit 2005, Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë është udhëhequr nga një person ndërkombëtar, Marek Antoni Nowicki, shtetas polak, me një histori të gjatë të aktiviteteve për të drejtat e njeriut. Nowicki është ndihmuar gjatë punës së tij nga dy zëvendës vendor, njëri shqiptar dhe tjetri serb. Në vitin 2005, Ombudspersoni ka pasur afër 60 punonjës vendor, prej të cilëve 25 juristë dhe ndihmës ligjor, pjesa tjetër personel administrativ, si dhe katër këshilltarë ndërkombëtarë.²²¹ Aktualisht, institucioni udhëhiqet nga një ushtrues detyre i Ombudspersonit, ish zëvendësi shqiptar i Nowickit, Himi Jashari - në pritje të zgjedhjes së udhëheqësit të ri të përhershëm nga Kuvendi i Kosovës.

Duke ditur se ligji kërkon nga IOK-u t'i kryej shërbimet falas, ky institucion është financuar nga burime të tjera. Deri në fund të vitit 2005, për të financuar shpenzimet ditore të këtij institucioni, fondet janë siguruar nga Buxheti i Kosovës, Këshilli i Përhershëm i OSBE-së, si dhe nga një numër i donatorëve bilateral (e që ka ndryshuar nga viti në vit).²²² Në vitin 2005, për shembull, 420.000 euro janë ndarë për IOK nga Buxheti i Kosovës.²²³ Projekte të veçanta janë financuar nga Këshilli i Evropës, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, UNICEF-i dhe UNIFEM-i. Veç kësaj, disa institucione të tjera të ndryshme kanë ofruar ndihma tjera të herë pas herëshme, veçanërisht në formë të ndihmës teknike dhe në financimin e kurseve për aftësim ose të vizitave studimore.²²⁴

Legjislacioni i vitit 2006 parasheh se duhet të mblidhen fonde të mjaftueshme nga Buxheti i Kosovës, për t'a lejuar IOK-un t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e veta. IOK, po ashtu, duhet të ketë të drejtë të marrë donacione plotësuese nga donatorët ndërkombëtarë, me kusht që kjo nuk do të ndikojë në pavarësinë e tij. Megjithatë, ushtruesi aktual i detyrës së Ombudspersonit ka shprehur shqetësimet se rregullorja e re lë të pazgjidhura shumë pyetje lidhur me mirëqenien financiare të IOK-së.²²⁵

Qasja në IOK ofrohet përmes zyrës kryesore në Prishtinë dhe zyreve rajonale në Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe Gracanicë (enklavë serbe). Zyrat rajonale janë zakonisht të përbëra nga një ose dy juristë dhe një ndihmës gjuhësor/përkthyes.

Përveç pranimit të ankesave në zyrë, juristët rregullisht vizitojnë komunat, enklavat, zonat me kombësi të tjera jo-shqiptare, burgjet dhe qendrat e paraburgimit. Burgjet dhe qendrat e paraburgimit vizitohen çdo dy javë, ndërsa vendet tjera së paku një herë në muaj. Veç kësaj, ekziston po ashtu një 'linjë telefonike' për raste urgjente, në zyrën qendrore të Institucionit të Ombudspersonit.²²⁶

Pas marrjes së ankesës ose nëse bindet se një situatë e kërkuar kërkon veprim të menjëhershëm, Ombudspersoni angazhohet në pajtim me autoritetin publik përkatës. Nëse problemi në fjalë nuk justifikon ndërhyrjen ose nuk mund të zgjidhet miqësisht, Ombudspersoni, bazuar në hetimet e bëra, lëshon një raport, në të cilin ai analizon se a ka pasur apo jo shkelje të të drejtave të personit përkatës'. Në rast se përgjigjja e kësaj pyetjeje është pohuese, raporti po ashtu përmban rekomandimet e Ombudspersonit dhe të PSSP-së ose përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës, se si të sigurohet se ka një pajtim me të drejtat e njeriut në të ardhmen.

Që nga zanafilla e tij, në mes të vitit 2000, e deri në vitin 2005, IOK ka publikuar tre raporte vjetore.²²⁷ Veç përmbajtjes së përshkrimit të rolit, misionit dhe aktiviteteve të IOK, raporti po ashtu ofron një përmbledhje të përgjithshme mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Përveç kësaj, po ashtu ekziston një pasqyrë statistikore për rastet, një pasqyrë e kërkesave për masat e përkohshme dhe kërkesat e tjera për veprime urgjente, përmbledhjet e raporteve dhe të letrave të zgjedhura ndërhyrëse.

Një shembull: gjatë periudhës prej 1 korrikut të vitit 2004 deri me 30 qershor të vitit 2005, përafërsisht 4.000 njerëz, individualisht, kanë kontaktuar Institucionin e Ombudspersonit në Prishtinë dhe zyret në terren, që personalisht t'i paraqesin ankesat ose për të kerkuar këshilla apo ndihmë. Përafërsisht 1.700 njerëz, personalisht, janë takuar me Ombudspersonin ose zëvendësin e tij. Gjatë kësaj periudhe, IOK ka regjistruar përkohsisht 446 raste të aplikimit, prej të cilave 297 kanë qenë të drejtuar për UNMIK-un, 103 për IPVQ-të, 42 për Drejtorinë për Pronë dhe Banim (DPB-së), një për KFOR-in dhe shtatë për institucione të tjera. IOK ka raportuar se jashtë këtyre ankesave:

'136 raste ishin deklaruar si të papranueshme për shkak të mosshfrytëzimit të mjeteve juridike, se kërkesat kishin qenë të pabazuara, apo për shkak të faktit se ato ishin jashtë juridiksionit të Ombudspersonit. Afër 216 raste të tjera ishin hequr nga lista -138 prej tyre ishin zgjedhur pozitivisht dhe 78 ishin mbyllur, ndër të tjera, për shkak të mosinteresimit të kandidatëve në vazhdimin e hetimeve'.²²⁸

Shumica e rasteve të hetuara nga Ombudspersoni janë lidhur me çështjet procedurale, siç është zgjatja e procedurave para gjykatave civile dhe DPB-së, aktet administrative apo lënia pas dore e tyre nga autoritetet publike kompetente, çështjet e pronës, ankesat për keqpërdorim të autoritetit, e drejta në çështjet gjyqësore, ankesat lidhur me punësim, apo çështjet e pandëshkueshmërisë.²²⁹

Pavarësisht nga ky aktivitet mjaft gjithpërfshirës, efikasiteti i IOK-së është penguar nga një problem thelbësor. Kjo do të thotë se ligji nuk i jep atij fuqinë ekzekutive mbi institucionet publike. Si rezultat, Ombudspersoni nuk mund të bëjë më shumë se

dhënia e rekomandimeve, të cilat nuk janë obligative për institucionet. Siç thotë Alice Thomas, këshilltare ligjore ndërkombëtare në Institucionin e Ombudspersonit, ‘baza ligjore nuk na jep neve dhëmbë, kështu që ne varem nga dashamirësia e institucioneve’.²³⁰

‘Dashamirësia e institucioneve’ duket se varet shumë nga individët që janë në shërbim të tyre. Sipas Thomas, ‘marrëdhënia më e afërt në mes të Ombudspersonit dhe UNMIK-ut ishte krijuar gjatë administrimit të PSSP-së të parë, Bernard Kouchner, më shumë për shkak se ky ka qenë një humanist i cili kujdesej për të drejtat e njeriut’. Pasuesi i Kouchner-it, Hans Hakerup, në anën tjetër, ka refuzuar të takojë Nowickin.²³¹

Gjithashtu, ndonëse deri në shkurt të vitit 2006 Ombudspersoni në Kosovë ka pasur autoritetin ligjor mbi UNMIK-un, por asnjëherë mbi KFOR-in, disa të punësuar në IOK, ndjenin se, në realitet, ky i fundit tentonte të jetë shumë më i përgjegjshëm se i pari. Siç thotë Thomas-i:

‘Duket se është bërë një lloj tradite se me çdo ndërrim të udhëheqjes së KFOR-it, që ndodh çdo 3 muaj, personi i kaluar i bart kontaktet tek Mr. Nowicki, duke thënë se “nëse dëshiron ta kesh ndjenjen e vërtetë për gjendjen reale të të drejtave të njeriut në Kosovë, ti duhesh ta takosh atë”. Edhe sikur ne t’u shkruajmë atyre lidhur me rastet e caktuara, ata prap na përgjigjen neve shumë shpjet, megjithëse, sidoqoftë, ne nuk kemi fuqi mbi ta’.

Sipas Thomas-it, ‘UNMIK-u e konsideron Ombudspersonin si një ngarkesë, që ndërhyt në punët e tyre’. Ka paur po ashtu disa raste kur institucionet e Qeverisë së Kosovës kanë shpërfillur IOK-un. Për shembull, kryetari i Komunës së Prishtinës, që kur ka filluar punën në vitin 2002, asnjëherë nuk u është përgjigjur ose kundërpërgjigjur letrave të IOK-ut.²³²

Thomas deklaroi se ‘Grupi i parë punues fillestar, përgjegjës për hartimin e legjislacionit për ‘Kosovarizimin’ e IOK [çfarë më vonë u bë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6] u përpoq t’i përmirësojë këto mangësi vendimtare dhe t’i jap këtij institucioni më shumë ‘dhëmbë’. Megjithatë, sipas Thomas-it, e cila vet ka qenë anëtare e grupit punues, pas disa muajve të punës në projektligj, grupi gradualisht ishte lënë jashtë nga punimet. Projektligji i ri, i përpiluar nga OSBE-ja dhe Zyra Ligjore e UNMIK-ut, ishte miratuar përfundimisht nga Zyra Qendrore e KB në New York, me pak udhëzime nga Grupi Punues.

Kështu, në vend të fuqizimit të institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, rezultati i fundit i ligjit të ri - siç u elaborua tashmë - ishte në të vërtetë një IOK edhe më i dobët, posaçërisht në lidhje me shtrirjen e autoritetit të tij. Dobësia e tij institucionale ka qenë ndoshta e ilustruar më së miri kur UNMIK-u dhe OSBE-ja hudhën poshtë argumentin e Ombudspersonit në largim- Nowickit - që IOK-u të udhëhiqet nga një person ndërkombëtar për aq kohë sa të mbetet një administratë ndërkombëtare në Kosovë.²³³

6.11. Agjencitë vëzhguese

Në vitin 2005, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Zhdukjen e Korrupsionit, i cili parasheh themelimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, që do të udhëhiqet nga një banor i përhershëm i Kosovës. Ligji, po ashtu, parasheh se Këshilli i Agjencisë Kundër Korrupsionit duhet të zgjedhet brenda 60 ditëve pas nxjerrjes së Ligjit.

Megjithatë, për shkak të mospajtimeve politike brenda Kuvendit të Kosovës, u deshën më shumë se gjysmë viti për emërimin e tre anëtarëve të parë në Këshillin e Agjencisë.²³⁴ Sot, pas më shumë se një viti, Agjencia është pjesërisht funksionale dhe punon në një zyrë të vogël brenda objektit të Kuvendit, në pritje për të punësuar staf në vitin 2007.

Ekziston mjaft skepticizëm në lidhje me agjencinë, që buron nga vonesat e përmendura si dhe mardhëniet që ka me Gjyqësinë dhe Policinë - duket se agjencia nuk e ka përkrahjen e tyre të plotë.

(Shiko pjesën 5.1 për më shumë mbi Aktivitetet Kundër Korrupsionit)

6.12. Mediat

Pas abrogimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989, liria e shtypit në gjuhën shqipe ka qenë shumë e kufizuar. Në fillim të vitit 1990, ka qenë vetëm një gazetë ditore në Shqip, *Bujku* (ish Rilindja), politikat editoriale të së cilës janë kontrolluar për së afërmi nga regjimi serb. Në fund të vitit 1990, u themeluan disa gazeta të tjera ditore, si *Koha Ditore* dhe *Zëri*, por ato po ashtu vepruan nën syrin vëzgues të regjimit. Me shumicën e stafit shqiptar, të larguar nga puna në vitin 1990, Radio dhe Televizioni i Prishtinës - në atë kohë i vetmi transmetues publik i vendosur në Kosovë – është injoruar shumë nga popullata shqiptare e Kosovës. Lajmet e transmetuara në gjuhën shqipe janë marrë nga jashtë, nëpërmes programeve të Radio Evropa e Lirë dhe Deutsche Welle, dhe çdo ditë nga dy orë nga transmetimi satelitor i transmetuesit kombëtar publik të Shqipërisë, TVSH.

Nryshe nga kjo, pas përfundimit të luftës më 1999, ka pasur një shtim të të gjitha llojeve të mediave në Kosovë. Aktualisht, në Kosovë janë 22 stacione TV të licencuara - tre prej të cilëve mbulojnë rrjetin e gjërë nacional, si dhe afër 90 radio stacione.²³⁵ Veç kësaj, po ashtu, janë edhe 10 gazeta ditore në gjuhën shqipe, kurse në enkalva serbe mund të gjenden gazeta të cilat sillen nga Serbia.

Me qëllim të sigurimit të 'zhvillimit dhe avansimit të mediave të pavarura profesionale dhe...zbatimin e një sistemi të përkohshëm rregullativ...' UNMIK-u në vitin 2000 themeloi Komisionin e Përkohshëm për Media (KPM).²³⁶ Komisari i përkohshëm për media është emëruar nga PSSP-ja, por me ligj është i obliguar të jetë i pavarur gjatë përmbushjes së përgjegjësive të lartpërmendura.

Duke ditur se KPM-ja gjithmonë ka tentuar të jetë një organ i përkohshëm rregullativ, në vitin 2005, Kuvendi i Kosovës nxori *Ligjin mbi Komisionin e Pavarur për Media*

*dhe Transmetim.*²³⁷ Me formimin e Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media në fund të gushtit të vitit 2006, përgjegjësia për rregullimin e transmetimit të mediave përfundimisht ka kaluar prej Komisionit të Përkohshëm për Media (KPM) te Komisioni i Pavarur për Media (KPM), dhe ai mëparshmi pushoi së ekzistuari.²³⁸ Meqenëse licencat për transmetim, të lëshuara nga KPM (TMC) gjithmonë janë konsideruar të përkohshme, ato nevojitet të ripërtërihen nga KPM (IMC) gjatë muajve të ardhshëm. Mediat e shkruara, në anën tjetër, nuk janë më nën mbikëqyrjen e KPM/KPM (TMC/IMC), që nga themelimit të Këshillit për Mediat e Shkruara në vitin 2005. Këshilli për mediat e shkruara është një OJQ, e themeluar nga përfaqësuesit kryesor të mediave të shtypura, dhe mendohet të shërbejë si një sistem vet-rregullues.²³⁹

Me themelimin e Këshillit të KPM-së (IMC), i gjithë personeli i zyrës së KPM-së (TMC) automatikisht është transferuar në shërbim të organit të ri. Aktualisht, KPM-ja (IMC) punëson 20 njerëz, prej të cilëve njëri është këshilltar ndërkombëtar.²⁴⁰ Deri më tani, personeli kosovar është paguar nga Buxheti i Kosovës, kurse OSBE-ja ka ofruar ndihmë administrative për KPM (TMC).²⁴¹ Në vitin 2003, fondet e Buxhetit të Kosovës për KPM (TMC) kanë qenë 400.000 euro, kurse KPM-së (IMC) në vitin 2006 i janë ndarë 360.000 euro.²⁴²

Gjatë licencimit të mediave elektronike, KPM-ja (IMC) është e obliguar të ‘marrë parasysh interesat publike...[duke inkurajuar] vlerat demokratike, profesionalizëm më të madh, shumëllojshmëri të përmbajtjes së programit dhe qëndrueshmëri financiare të mediave elektronike, për të mbrojtur lirinë e të shprehurit, duke siguruar transparencë të pronësisë së medias, si dhe të stimulojë ekonominë e tregut nëpërmjet reklamave komerciale’²⁴³ Licencimi i nënshtrohet tre llojeve të kushteve: rregullave të përgjithshme të operimit që aplikohen për të gjitha subjektet transmetuese; kushteve teknike të veçanta për secilin subjekt transmetues, siç janë frekuencat për t’u përdorur, niveli i fuqisë dhe lokacioni i transmetuesve; si dhe formati i programit, i veçantë për secilin subjekt transmetues.

Me ligj, KPM është i obliguar që të mos u japë licenca transmetimi: agjencive qeveritare ose ndërmarrjeve apo enteve të tjera në të cilat Qeveria ka ndikim në kontrollin e tyre; individëve të mbajnë një funksion zyrtar në një parti politike; si dhe organizatave dhe kompanive të lidhura me partitë politike.²⁴⁴ Si rezultat i këtyre rregullave, ish pronari i KTV-së, Veton Surroi, pasi u bë udhëheqës i ‘Partisë Reformiste-Ora’, pronësinë e kompanisë së tij mediale i’a barti motrës së tij Flaka Surroit.

Sipas legjislacioni në fuqi, i vetmi transmetues publik i pasluftës në Kosovë, Radio Televizioni i Kosovës (RTK), është ‘institucion publik...i cili ofron shërbim publik në fushën e veprimtarisë së radios dhe televizionit’, RTK-ja është e obliguar me ligj që ‘të informojë me saktësi publikun, të mbështes proceset demokratike, vëzhgimin publik të autoriteteve dhe... të sigurojë një proporcion adekuat të lajmeve të paanshme, programeve kulturore, artistike, sportive, edukative, zbavitëse...’²⁴⁵ Veç kësaj, për përkrahjen e paanshmërisë së RTK-së, Kodi Profesional i Mirësjelljes së këtij institucioni përcakton se botuesit dhe gazetarët duhet ‘të mbjanë distancë

profesionale nga të gjithë mekanizmat e pushtetit, pasi që ato përndryshe mund ta rrezikojnë integritetin e [RTK]'.²⁴⁶

Kuvendi i Kosovës, si themelues i RTK-së, është përgjegjës për të mbrojtur autonominë institucionale dhe pavarësinë editoriale të RTK-së dhe të sigurojë financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-së. Me ligj, burim kryesor i financimit do të jetë parapagimi për transmetuesin publik, megjithëse po ashtu mund të marrë edhe përkrahje financiare nga Buxheti i Kosovës, tërheqja e burimeve tjera financiare, siç është parapagimi për shërbimet transmetuese, mesazhet e paguara dhe shitja e programeve të veta.²⁴⁷ Parapagimi për transmetuesin publik të RTK-së, i cili filloi të mbledhet në vitin 2003, është burimi kryesor i të hyrave, po ashtu edhe në praktikë, duke numëruar gjithësej deri në 4.8 milionë euro në vitin 2004, përkundër të hyrave prej 1.4 milionë euro prej marketingut dhe 1 milion euro prej Buxhetit të Kosovës.²⁴⁸

Megjithatë, pavarësisht nga dispozitat ligjore për të garantuar pavarësinë e transmetuesit publik, Ligji për RTK-në, disa herë është kritikuar nga përfaqësuesit e komunitetit të mediave, e jo më pak edhe nga vet RTK-ja. Në një letër që i është dërguar PSSP-së, RTK-ja shprehet kundër të drejtës së Këshillit të KPM-së, që në fillim të çdo viti të vendos deri në 20 përqind të sasisë së reklamave dhe mesazheve të tjera të paguara në skemën programore të RTK-së.²⁴⁹ RTK-ja ka argumentuar se në shumicën e transmetuesve publik të vendeve evropiane, hapësira për marketing është e rregulluar rreptësisht me ligj dhe nuk është lënë sipas zgjedhjes së autoriteteve rregullative. Arsyeja – RTK-ja vazhdoi - është të shmangen '...mundësitë e sektorit privat për të korruptuar anëtarët e Këshillit të KPM (IMC) dhe t'i ofrojë mundësi transmetuesit publik që të bëjë 'projekte afatgjata buxhetore dhe planifikim të të hyrave'.²⁵⁰

Të tjerët shprehen kundër dispozitës së futur nga UNMIK-u në Ligjin për RTK-në, i cili thotë se 'fondet e RTK-së, përfshirë ato nga parapagimi i transmetuesit publik dhe nga burimet e tjera të financimit... duhet të depozitohen në tërësi si para publike në një xhironlogari të caktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave'.²⁵¹ Berat Buzhala, kryeredaktor në të përditshmen *Express* dhe njëherit anëtar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, ka ndjerë se Ligji 'nxit shkatërrim financiar, që do të thotë shkatërrim profesional...(i) lejon Qeverisë t'i mbaj fondet e RTK-së në xhironlogarinë e vet...dhe t'i bllokojnë ato sa herë që ata dëshirojnë...'.²⁵²

Duke ditur se Ligji i ri për RTK-në ka hyrë në fuqi shumë vonë (prill 2006), ende është e pamundur të vlerësohet objektivisht dhe në mënyrë të pavarur efekti që këto dispozita të paqarta ligjore kanë në paanshmërinë e transmetuesit publik.

Në krahasim me situatën që ka mbizotëruar para vitit 1999, kur të gjitha mediat kanë qenë ose të kontrolluara nga Partia Komuniste, ose nën regjimin e rreptë mbikëqyrës të Miloseviqit, tani është një liri më e madhe e të shprehurit dhe ka më pak censurë arbitrare të mediave.

Shikuar nga këndvështrimi ligjor, Kodi i Sjelljes së Mediave Elektronike në Kosovë thotë se '...secili gëzon të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes...(përfshirë)

lirinë e mendimit pa interferenca dhe lirinë për të kërkuar, për të pranuar dhe për të kumtuar informata dhe ide nëpërmjet të gjitha mediave dhe pa marrë parasysh kufijtë’.²⁵³ Ushtrimi i kësaj lirie u nënshtrohet:

‘...atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve apo ndëshkimeve që janë të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, për interesa të sigurisë kombëtare, të integritetit territorial dhe të sigurisë publike, për parandalimin e trazirave dhe të krimit, për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e prestigjit dhe të drejtave të tjerëve, për parandaimin e zbulimit të informatave të dhëna në besim, ose për ruajtjen e autoritetit dhe të paanësisë së drejtësisë’.²⁵⁴

Megjithatë, në vitet e hershme pas përfundimit të luftës, mediat kanë qenë mjaft shumë të mbikëqyrura nga KPM-ja, për t’u siguruar se ‘pronarët, drejtuesit e ndërmarrjeve dhe botuesit nuk duhet të botojnë detaje personale për asnjë person, duke përfshirë emrin, adresën ose vendin e punës, nëse publikimi i detajeve të tilla mund të paraqesë rrezik serioz për jetën apo sigurinë e cilitdo personi të tillë nga dhuna e personave që e marrin ligjin në duar të veta apo nga dikush tjetër’.²⁵⁵ Ky paragraf e nxiti Haqif Mulliqin, ish kryesuesin e atëhershëm të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), ta kundërshtojë kornizën rregullative të UNMIK-ut si ‘një një akt politik që tenton t’i dëbëjë mediat dhe gazetarët në Kosovë, si dhe të kontrollojë lirinë e mendimit dhe të shprehjes’.²⁵⁶

Ndërkaq, ky kod i përkohshëm i sjelljes për mediat e shkruara - u paraqit nga UNMIK-u në vitin 2000, pas vrasjes së një punëtori serb të KB-së, brenda dy javëve pas shkrimit ditor të një shqiptari në lidhje me pohimet për të kaluarën e tij paramilitare – u suspendua në vitin 2005.²⁵⁷ KPM-ja shprehu besimin se ‘rrethanat e caktuara që motivuan PSSP-në në vitin 2000 ta themelojë sistemin e përkohshëm rregullativ për mediat e shtypura, tani më nuk ekzistojnë dhe është bindur se ‘në pajtim me standardet evropiane, Këshilli për Media është organ i duhur për t’i shqyrtuar ankesat kundër mediave të shtypura’.²⁵⁸

Në përgjithësi, mediat janë relativisht të lira t’i mbulojnë pikëpamjet e kritikëve të Qeverisë. Disa zyrtarë madje besojnë së, në vitin 2005, trajtimi kritik i mediave ka ndihmuar në largimin e ish Kryeministrit të atëhershëm, Bajram Kosumi, pas supozimeve se ai kishte marrë dhuratë në vlerë prej 20.000 euro, që është në kundërshtim me Ligjin Kundër Korrupsionit.²⁵⁹ Tash së voni, mediat janë fokusuar mbi supozimet për keqpërdorimet financiare në zyrën e ish Kryetarit të Kuvendit, Nexhat Daci. Një varg artikujsh u shfaqen pasi që Auditori Gjeneral zbuloi se mbi 230.000 euro janë paguar në fund të vitit 2005 për blerjen e një veture zyrtare, e cila as pas një viti e gjysmë nuk i është sjellur Kuvendit.²⁶⁰

Në fillim të vitit 2006, një mostër rasti për 28 ditë tregoi se shtatë gazeta ditore shqiptare, së bashku, përmbanin mbi 150 artikuj për korrupsionin, do të thotë mesatarisht rreth 5 artikuj në ditë i kushtoheshin korrupsionit. Në këtë drejtim ka prirë

Epoka e Re – e afërt me partinë kryesore në opozitë, PDK-në, me 38 artikuj, e pasuar nga *Koha Ditore* dhe *Express*.²⁶¹

Një reportazh i tillë kritik, është ndihmuar dukshëm nga shtrirja relativisht e gjërë e pronësisë së mediave. Prej tre kanaleve televizive, me shtrirje të gjërë nacionale, RTK-ja është transmetues publik, KTV-ja është pjesë e ‘KOHA Group’ të Surroit, kurse TV21 posedohet nga Afërdita Saraçini-Kelmendi, një gazetare e vjetër. Megjithëse është e vështirë të llogaritet saktësisht, vlerësohet se dhjetë gazetat ditore në Kosovë kanë një qarkullim ditor prej gjithësej 14.000 ekzemplarëve. Gazeta me tirazhin më të madh (6.500), *Koha Ditore*, është pjesë e ‘KOHA Group’ të Surroit. *Zëri*, gazeta e dytë më e madhe, posedohet nga kompania private ‘Zëri’. *Bota Sot*, gazeta e tretë më e madhe, posedohet nga Xhevdet Mazrekaj (Media Print) dhe është e afërt me partinë udhëheqëse në pozitë, LDK-në. *Epoka e Re* posedohet nga Muhamet Mavraj, ish student dhe veprimtar, dhe është e afërt me partinë udhëheqëse në opozitë. *Express* posedohet nga ‘Media Works’, një kompani private, aksioneri më i madh i së cilës është kompania teknologjike vendore, IPKO. *Lajm Ekslusive* posedohet nga ‘ATV-Media’, kompani e vëllaut të Bexhet Pacollit, afaristit të mirënjohur kosovar.

Gazetaria nuk është gjithmonë profesioni më i sigurt në Kosovë: në vitin 2002, OSBE-ja besonte se 29 përqind e gazetarëve në Kosovë kanë qenë të kërcënuar gjatë hulumtimeve të tyre, veçanërisht kur ato kishin të bënin me krimin e organizuar.²⁶² Megjithatë, ndonëse shpesh ka spekulime që lidhin një sulm me tregimin e një gazetari, arsytet e sakta ose motivet që fshihen pas sulmit, shumë rrallë janë zbuluar nga policia dhe rastet e tilla rrallë përfundojnë në gjyq.

Në të shumtën e rasteve të sulmeve mbi gazetarët, spekulimet bazohen në rivalitete dhe dallime ndëretnike ose grupore.²⁶³ Mirëpo, ka pasur po ashtu raste kur sulmet janë bërë pasi që gazetarët kanë punuar në rastet që kanë të bëjnë me institucionet publike. Për shembull, në vitin 2004, Fatmire Tërdevci, një gazetare hulumtuese në gazetën ditore *Koha Ditore*, ishte qëlluar dhe plagosur nga persona të paignifikuar. Autorët nuk janë zënë kurrë dhe arsytet e qarta për sulmin ndaj saj nuk janë zbuluar kurrë. Ndërkaq, bordi editorial i gazetës është shprehur se ata nuk përjashtojnë mundësinë që ajo është bërë cak për shkak të shkrimeve të saj.²⁶⁴ Një rast tjetër, më pak serioz, ka ndodhur në vitin 2005, kur tre persona sulmuan ekipin e KTV-së, që ishte duke punuar një raport mbi korrupsionin në Komunën e Gjilanit.²⁶⁵ Njëri prej sulmuesve dyshohej të ketë qenë punonjës komunal, kurse të tjerët kanë qenë të afërm të kryetarit. KTV-ja e ka paraqitur rastin në Gjykatën Komunale, për pengim gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, sulm dhe dëmtim të pajisjeve.²⁶⁶

6.13. Shoqëria civile

Derisa para luftës Kosova ka pasur shumë pak OJQ, shpesh duke funksionuar në baza vullnetare, viti 1999 dëshmon për rritje të numrit të tyre. Është llogaritur se rreth 2.000 OJQ janë themeluar në tri vitet e para pas konfliktit, që do të thotë përafërsisht një OJQ në çdo njëmijë banorë të Kosovës.²⁶⁷ Sot janë mbi 3.000 OJQ të regjistruara, por është llogaritur se vetëm 150 janë aktive, prej të cilave, disa analistë thonë, ‘vetëm afër 30 prej tyre bëjnë punë të rëndësishme’.²⁶⁸

Baza ligjore për regjistrimin e OJQ-së është Rregullorja e UNMIK-ut mbi *Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare në Kosovë*.²⁶⁹ Ligji përcakton se një OJQ vendore është një ‘asociacion ose fondacion i themeluar në Kosovë për përmbushjen e synimeve ligjore, qoftë për përfitim publik ose interes të përbashkët’, ndërsa një OJQ ndërkombëtare ose e huaj është ‘personi juridik i themeluar jashtë Kosovës’, sipas legjislacionit që i plotëson kërkesat e UNMIK-ut.

Rregullorja i lejon OJQ-të të themelohen për një interes publik (duke i liruar ato kështu nga taksat doganore dhe obligimet e tjera fiskale) ose përfitim të përbashkët, duke mos iu mohuar njerëzve të drejtën për bashkim pa formimin e një organi ligjor. Ajo i lejon OJQ-të të merren me aktivitete ekonomike që përkrahin synimet e organizatave dhe në krijimin e të hyrave, ndonëse ua ndalon atyre të shpërndajnë çfarëdo page neto ose përfitime të tilla për cilindo person. Të gjitha OJQ-të duhet të regjistrohen në Njësinë Ndërlidhëse të UNMIK-ut për OJQ-të, kurse ato që u është dhënë statusi i përfituesit publik - janë të obliguara të përgatisin një raport vjetor që dokumenton programet dhe financat e tyre.²⁷⁰

Edhe pse procesi i regjistrimit të OJQ-së është mjaft i thjeshtë - forma e aplikimit është në tri faqe - Njësia Ndërlidhëse për OJQ-të ka mungesë të mjeteve dhe stafit. Kështu, Zyra ndërlidhëse është e paaftë të mbikëqyrë mijëra OJQ të regjistruara në Kosovë, e cila sipas disa analistëve ka shkaktuar ‘shumë shpërdorime të privilegjeve...dhe ka hapur derën për abuzime’.²⁷¹

Disa analistë kanë thënë se ‘shoqëria civile...në Kosovë duket shumë më e sofistikuar se homologet e saja në shumë vende të tjera të Evropës Lindore dhe në vendet e Azisë Juglindore’.²⁷² Shoqëria civile e Kosovës ende ballafaqohet me disa vështirësi të veçanta. Vështirësia kryesore është forma me dy nivele e qeverisjes, vetëm njëra prej të cilave - IPVQ-ja - është publikisht e përgjegjshme ndaj qytetarëve të Kosovës. Ndonëse OJQ-të mund të ndikojnë tek IPVQ-të sa i përket sektorëve të transferuar (p.sh. arsimit, shëndetësisë, rinia), për shumë çështje të rëndësishme duhet të provojë të ballafaqohet me UNMIK-un. Mirëpo, në disa raste UNMIK-u ka qenë i papërgjegjshëm - nganjëherë shumë hapur – ndaj thirrjeve/lutjeve të grupeve të shoqërisë civile. Për shembull, në vitin 2004, një rrejt i gjërë i OJQ-ve të Kosovës bën fushatë të vrullshme për ndryshimin e sistemit zgjedhor, me qëllim të përmirësimit të përgjegjëshmërisë së zyrtarëve të zgjedhur. Kërkesa nuk është marrë parasysh nga UNMIK-u dhe zgjedhjet pasuese nacionale u zhvilluan me sistemin zgjedhor me lista të mbyllura (preferenca për partinë).

Sa i përket bashkëpunimit të IPVQ-ve me shoqërinë civile, një analist beson se disa OJQ/think tanks ‘...kanë arritur të krijojnë kontakte personale me nivelet më të larta vendim-marrëse brenda IPVQ-ve dhe, në përgjithësi, janë duke u marrë shumë seriozisht’.²⁷³ Megjithatë, shumë aktivistë mendojnë se rrethanat në Kosovën e pasluftës nuk kanë qenë të favorshme për lobim mbi çështjet e shumta sociale dhe politike, sepse fokusi kryesor kanë qenë negociatat për statusin përfundimtar, në shkëmbim/llogari të çështjeve të tjera të rëndësishme, siç është efikasiteti institucional dhe llogaridhënia. Gjithashtu, mjedisi i polarizuar politik e bën të vështirë për OJQ-të të angazhohen në punë të rëndësishme, jo-sektare.²⁷⁴ Kështu, një aktivist i një OJQ-je,

konkludon se ‘momentalisht sektori bën që të mos ketë ndikim mbi procesin politik... dhe është i kufizuar në komuna’.²⁷⁵ Ajo, megjithatë, shpreson se kjo do të përmirësohet në të ardhmen e afërt, pasi tash së voni Zyra e Presidencës dhe Zyra e Kryeministrit kanë krijuar dy pozita për një zyrtar ndërlidhës të OJQ-ve, i cili do të veprojë si ndërmjetësues në mes të OJQ-ve dhe zyreve më të larta politike në Kosovë dhe do të nxis bashkëpunimin në mes tyre.

Ekziston një numër i OJQ-ve, misioni i të cilave veçmas përfshin monitorimin e punës së legjislativit, por që shumë pak janë të angazhuara sa i përket ekzekutivit. Arsyeja, siç shpjegoi njëri nga aktivistët e OJQ-ve, është se:

‘shoqëria civile nuk ka qasje në takimet e ekzekutivit, ku diskutohen politikat dhe merren vendimet, por vetëm mund t’i shikojnë dokumentet e tyre, të cilat në të shumtën e rasteve janë formalisht në rregull. Duke pasur qasje vetëm në një sasi të limituar të informatave dhe duke mos dashur që në mënyrë ta pavlefshme t’i miratojnë politikat e Qeverisë, shumë OJQ i shmangen bërjes së të gjitha analizave të mbyllura dhe sistematike për punën e të mëparshmeve dhe fokusohen më mirë në legjislativ’²⁷⁶

Ky ka qenë problem i OJQ-së ‘Forumi’ në vitin 2003, kur pas disa javëve të monitorimit të Doganave të Kosovës, organizata konkludoi se puna e tyre ka qenë e kënaqshme, për tu befasuar vetëm pak javë më vonë - me arrestimin e një numri të zyrtarëve doganorë.²⁷⁷

Megjithatë, ndonëse nuk ka monitorim sistematik të të gjitha politikave të Qeverisë, një numër i OJQ-ve të veçanta kanë kontrolluar për së afërmi politikat e ndryshme të Qeverisë që janë hartuar mbi baza *ad hoc*, varësisht nga rëndësia e tyre për misionin e një organizate ose intereseve të zonave të tyre zgjedhore. Për shembull, në vitin 2003 dhe 2004, KIPRED-i, një think-tank, ndërmori një varg studimesh mbi punën e qeverisë lokale dhe të administrimit të Kosovës, kurse tani është duke shqyrtuar politikat e Qeverisë për arsimin e lartë.²⁷⁸ Handikosi, një OJQ që promovon të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuara, në mënyrë aktive merret me qeverinë lokale, përmes përfaqësuesve të saj në këshillet e kuvendeve komunale, si dhe duke mbajtur takime për sensibilizimin e opinionit publik për politikat përkatëse të Qeverisë.²⁷⁹

Vitet e fundit, po ashtu, kanë shënuar një ngritje në numrin e OJQ-ve të specializuara sa i përket aktiviteteve kundër korrupsionit. Projekti për Avokim të OJQ-ve në Kosovë (KNAP) ka qenë një prej iniciativave të para në këtë fushë, e cila në vitin 2002 ka zhvilluar programin e granteve kundër korrupsionit për OJQ-të seli në Kosovë, të gatshme për të udhëhequr në parandalimin e korrupsionit. KODI, një think-tank, hartoi agjendën që do të përdorej nga Agjencia Kundër Korrupsionit, e themeluar tash së voni. “ÇOHU”, në anën tjetër, është relativisht një OJQ e re, e themeluar në shtator të vitit 2005, me qëllim që t’i pengojë korrupsionin dhe çështjet e fshehta qeveritare.

Me gjithë faktin që OJQ-të dhe publiku i gjërë mund të marrin pjesë në takimet e Kuvendit të Kosovës, ndikimi i tyre i drejtpërdrejtë në legjisllacion është i kufizuar, për

shkak se ligji nuk i përcakton qartë të drejtat e qytetarëve për të propozuar projektligje. Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës përcakton se ‘projektligji mund të paraqitet për diskutime në Kuvend nga: Qeveria, një komision, një deputet i Kuvendit...[dhe] një grup parlamentar...’²⁸⁰ Si rezultat, shoqëria civile duhet të sigurojë qasje në njërin prej kanaleve të mësipërme me qëllim që të nxis nxjerrjen e ligjeve në Kuvend. Kjo është në kundërshtim me praktikën në vendet e tjera në rajon, siç është Shqipëria, ku qytetarët mund të propozojnë hartimin e ligjeve nëse mbledhin së paku 25.000 nënshkrime në përkrahje të tyre.²⁸¹

Në nivelin lokal, megjithatë, qytetarët kanë të drejtë të bëjnë propozime në kuvendet komunale, dhe OJQ-të shfrytëzojnë përparësitë e kësaj mundësie. Për shembull, një numër i OJQ-ve, shpesh duke vepruar si rrjet, kanë arritur të ndikojnë në rregulloret komunale për një sërë çështjesh të ndryshme, që radhiten prej mbrojtjes së mjedisit deri te orët e punës së bizneseve.²⁸²

Aktivistët e OJQ-ve kanë qenë po ashtu në mesin e mbrojtësve më të zëshëm të *Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare* të Kuvendit të Kosovës. Ligji u siguron qytetarëve të Kosovës qasje në dokumentet e secilit organ ose agjencion të IPVQ-ve, secilës komunë, AKM-së, si dhe secilit prej organeve dhe zyreve të pavarura të përmendura në Kornizën Kushtetuese, siç janë KQZ-ja, ZAGJ, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK), KPM, KGJPK etj.²⁸³ Sipas ligjit, qasja në dokumentet zyrtare mund të refuzohet për arsye të: sigurisë publike, çështjeve ushtarake; marrëdhënieve me jashtë; financiare; politikës financiare ose ekonomike të IPVQ-ve; mbrojtjes së ineresave komerciale të personave juridikë; procedurave gjyqësore dhe këshillimit ligjor; dhe mbrojtjes së hetimeve dhe auditimeve, përveç nëse ‘ka një interes qenësor publik për bërjen publike’. Ligji obligon institucionet t’i shqyrtojnë me përpikshmëri aplikacionet, në afat prej 15 ditësh prej aplikimit e deri te refuzimi ose pranimi i kërkesës për qasje (në dokumente zyrtare). Është me rëndësi të ceket se, megjithatë, dokumentet e UNMIK-ut janë të lira nga ky legjislacion

Mirëpo, krahas kësaj, një numër i aktivistëve të OJQ-ve ankohen se, pavarësisht ligjit, në praktikë nuk ka pasur shpjegime të mjaftueshme për publikun që të kuptojnë se cilat dokumente janë të hapura për publikun dhe cilat janë të ndjeshme. Këto lista, megjithatë, duket se nuk janë bërë dhe ky fakt shpesh është përdorur nga insitucionet si arsyetim për të mos i dhënë ato. Një numër i udhëheqësve të OJQ-ve kanë konfirmuar se qasja në dokumentet zyrtare, në të vërtetë, ende varet nga kontaktet personale brenda institucioneve.²⁸⁴ Gjithashtu, kritikët argumentojnë se situata madje u keqësua në vitin 2006, pasi që Ministrja e Shërbimeve Publike nxori një udhëzim administrativ që u lejon zyrtarëve të kenë edhe më shumë liri veprimi në vlerësimin e kërkesave për qasje në dokumentet zyrtare. Në të vërtetë, një aktivist i shoqërisë civile ka raportuar se pas nxjerrjes së këtij udhëzimi, ai nuk ka mundur të ketë qasje zyrtare në procesverbalet e takimeve të Kuvendit të Kosovës, ndonëse këto janë të hapura për publik dhe të transmetuara nga transmetuesi nacional publik.²⁸⁵

6.14. Qeverisja lokale dhe rajonale

Në Kosovë janë dy nivele të qeverisjes, pushteti qendror dhe pushteti lokal ose komunal. Pushteti lokal në Kosovë aktualisht është i rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut *Mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë*, e cila specifikon se ‘njësia themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna’.²⁸⁶ Momentalisht në Kosovë janë 30 komuna, megjithëse reformat e pushtetit lokal mund të krijojnë një numër të komunave të tjera në mes të vitit 2007.²⁸⁷ Veç kësaj, UNMIK-u zyrtarisht e ka ndarë Kosovën në pesë rajone. Megjithatë, këto nuk janë rajone politike, meqenëse nuk janë mbajtur zgjedhje në këtë nivel dhe ato nuk kanë një administrim të ngjashëm kosovar.

Zyret rajonale të UNMIK-ut kanë administratorë ndërkombëtarë, të cilët së bashku me administratorët e UNMIK-ut në nivelin komunal kanë pasur rolin kryesor në Kosovën e pasluftës, kur ka ekzistuar një mungesë e institucioneve të tjera lokale.²⁸⁸ Në periudhën në mes të vitit 1999 dhe vitit 2001, administratorët rajonalë dhe komunalë të UNMIK-ut kanë pasur kompetenca të padiskutueshme mbi pushtetet lokale komunale, përfshirë autoritetin për të ‘kontrolluar, zbatuar apo mbikëqyrur funksionet që u janë besuar shërbimeve publike si dhe organeve të qeverisjes lokale [të rajoneve/komunave përkatëse] dhe [mund] të kërkojnë që këto shërbime dhe organe të kërkojnë miratimin paraprak të tij/saj për vendime apo iniciativa të veçanta’.²⁸⁹ Veç kësaj, ata kanë pasur rolin kyç në koordinimin e ndihmave në nivelin lokal. Të administruar drjetpërdrejt nga PSSP-ja, këta administratorë ndërkombëtarë u kanë raportuar vetëm autoritetve të UNMIK-ut.

Sot, administratorët ndërkombëtarë kanë më pak kompetenca, dhe ato janë të kufizuara në çështjet që kanë të bëjnë me pronat komunale dhe çështjet e komuniteteve (minoriteteve). Pjesa dërmuese e përgjegjësive të qeverisjes lokale tani mbetet te pushtetet komunale të zgjedhura, të cilat sipas Rregullores mbi Pushtetin Lokal është menduar të ofrojnë: kushtet elementare lokale për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik; planifikimin urban dhe të fshatit dhe shfrytëzimin e tokës; lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillime të tjera; mbrojtjen lokale të ambientit; ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës; shërbimet publike; udhëheqjen e pronës së komunës; shkollimin parashkollor, fillor dhe të mesëm; kujdesin primar shëndetësor; shërbimet sociale dhe strehimin; mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik; lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje; të panairëve dhe tregjeve; emërimin dhe riemërimin e rrugëve; veprime që kanë të bëjnë me turizmin; aktivitete kulturore dhe të rinisë, sporte dhe aktivitete të lira; avancim të vlerave ekonomike dhe qytetare.²⁹⁰

Megjithatë, mundësia e tanishme e komunave për të ofruar shërbimet e mësipërme, për shumë arsye, është tejet e kufizuar. Në njëërën anë, legjisllacioni i miratuar pas Rregullores mbi Pushtetin Lokal, gradualisht i tërhoqi disa nga përgjegjësitë e komunave, duke i bartuar ato tek institucionet ose agjencitë e tjera. Për shembull, me transferimin e menaxhimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe pasurive të tyre te AKM-ja, në vitin 2002, UNMIK-u i privoi komunat nga të hyrat që fitohen nga toka, burimet

natyrore ose llojet e tjera të pronave që në sistemin socialist kanë qenë nën mbikëqyrjen komunale.²⁹¹

Në anën tjetër, mundësitë e kufizuara financiare, profesionale dhe menaxheriale të vetë komunave i kanë penguar aftësitë e tyre për t'i përmbushur disa nga përgjegjësitë kryesore. Për shembull, sipas ligjit, secila komunë deri më tani duhet të ketë të hartuar planin zhvillimor komunal për tërë territorin e vet.²⁹² Megjithatë, deri më sot, vetëm një komunë, ajo e Shtërpces, ka kompletuar të tri këto elemente-studimet ekonomike, sociale dhe hapësinore-të planit.

Ndonëse mund të ketë mungesë të stafit me kualitet të lartë në administratat komunale, numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë është relativisht i lartë.²⁹³ Buxheti i Kosovës i vitit 2006 ka paraparë që gjithsej 5.691 persona duhet të punësohen për administrimin e 30 komunave të Kosovës, që mesatarisht i bie një i punësuar për 334 banorë.²⁹⁴ Megjithatë, ka ndryshime në mes të komunave, madje edhe në rastet kur numri i personelit të punësuar nga komuna kalon numrin e paraparë në buxhtin zyrtar. Për shembull, komuna e Prishtinës, me një popullsi që vlerësohet të jetë nën 300.000 banorë, ka një listë të planifikuar të stafit prej 600 njerëzve, edhe pse aktualisht punëson më shumë se 800 njerëz.

Ndryshe nga deputetët e kuvendeve komunale (përfshirë kryetarët e tyre përkatës), i gjithë stafi tjetër punues në nivelin e pushtetit lokal - përfshirë edhe kryeshefin ekzekutiv dhe Bordin e Drejtorëve - kanë statusin e nëpunësve civilë të Kosovës. Si rezultat i kësaj, ata janë po ashtu të kufizuar nga normat dhe rregulloret e njejta si nëpunës civilë në nivelin qendror, përfshirë ato që kanë të bëjnë me nepotizmin, konfliktin e interesave, dhuratat dhe mirëpritjen, siç është specifikuar në Ligjin Kundër Korrupsionit ose në Rregulloren e UNMIK-ut për Shërbimin Civil.

Veç kësaj, Rregullorja e Pushteti Lokal ka dispozita të veçanta që merren me konfliktet e interesave të deputetëve të kuvendeve komunale. Sipas kësaj rregulloreje, secili deputet i kuvendit komunal duhet të përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjeje për të cilën ai/ajo ose ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo të saj ka ndonjë interes personal apo material. Gjithashtu, secili deputet kërkohet t'i paraqes të gjitha konfliktet e interesave, posa të paraqiten ato, dhe secili deputet mund të ofrojë informacionin për interesin e ndonjë anëtari tjetër.²⁹⁵

Gjithashtu, para takimit të tyre të parë, këshilltarët e kuvendit komunal janë të obliguar t'i regjistrojnë interesat e tyre financiare në regjistrin publik i cili mbahet nga kryeshefi ekzekutiv dhe t'i shënojnë ndryshimet posa të paraqiten ato. Përveç këtyre obligimeve, kryetari i kuvendit komunal dhe nënkryetarët e tij/saj duhet që 'pas zgjedhjes së tyre duhet të përfundojnë sa më shpejt që të jetë e mundur çdo kontratë ose lidhje tjetër për të mos u vënë në dyshim mundësia e kryerjes së obligimeve të tyre në formë të drejtë dhe të paanshme'. Kufizime të ngjashme u detyrohen edhe kryeshefit ekzekutiv dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Përfundimisht, 'të gjithë nëpunësit civilë komunalë kërkohet t'i paraqesin me shkrim, në një regjistër, të gjitha konfliktet e interesave të cilat i ruan kryeshefi ekzekutiv (KE)'.

Megjithatë, zbatimi aktual i dispozitave të ndryshme kundër nepotizmit ose konfliktit të interesit shpesh është i diskutueshëm. Për shembull, në vitin 2004 shtypi shkruante se një numër i zyrtarëve të lartë në Komunën e Prishtinës kanë punësuar kushërinjtë ose familjarët e tyre të ngushtë në administratën komunale. Kryeshefi ekzekutiv i atëhershëm, Sami Hamiti, është dalluar për akuzat se ka më së shumti familjarë që punojnë në administratë përkrah tij, përfshirë edhe kushëririn e parë, dajën, kunatën dhe nipin.²⁹⁶ Një shembull tjetër që është ngritur kohëve të fundit kur pronari i një restorani ka pohuar se, prej vitit 2002 deri në vitin 2006, komuna e Gjakovës ka grumbulluar borxhin në vlerë mbi 18.000 euro si rezultat i faturave nga darkat e zyrtarëve të lartë'. Veç kësaj, ai po ashtu ka pohuar se vet kryetari i Komunës, restorantit i ka pasur borxh 4.000 euro, për huazimin e sallës për martesën e djalit të tij, që është bërë para dy viteve. Komuna nga ana e saj i ka refuzuar këto deklaratat, duke thënë se asnjëra prej faturave të tyre nuk dokumentojnë borxhin ndaj restorantit.²⁹⁷

Pushteti lokal në Kosovë është i zgjedhur dhe jo i emëruar nga pushteti qendror. Megjithatë, autoritetet qendrore në shumë mënyra mund të ushtrojnë një masë të konsiderueshme kontrolli mbi komunat. Së pari, komunat janë financiarisht të varura nga pushteti qendror deri në një masë të madhe, pasi që deri në 80 përqind e buxhetit komunal vjen nga niveli qendror. Në vitin 2006, për shembull, buxheti total i komunave të Kosovës ka qenë rreth 166.5 milionë euro, prej të ciave 132.5 milionë euro duhej të vinin nga grantet e transferuara nga pushteti qendror, kurse 34 milionë euro do të grumbulloheshin vet nga komunat nëpërmes taksave, pagesave dhe gjobave.²⁹⁸

Së dyti, puna e qeverive dhe administratave komunale është majft e ndikuar nga politikat lokale të partive, e të cilat janë të ndikuara nga strukturat qendrore të partive. Ligji Zgjedhor në Kosovë, sipas të cilit qytetarët votojnë për listën e partive dhe jo për kandidatët individual, lejon kontroll të konsiderueshëm mbi përbërjen përfundimtare të kuvendeve komunale, jo vetëm në degë por gjithashtu edhe në zyrat qendrore të partive politike.²⁹⁹

Përfundimisht, vet legjislacioni përcakton një numër të kushteve sipas të cilave pushteti qendror mund të ushtrojë mbikëqyrjen mbi komunat. Rregullorja e Pushteti Lokal i jep autoriteteve qendrore të drejtën gjithpërfshirëse të '...ushtrojnë mbikëqyrjen administrative mbi komunat, pët të siguruar përputhshmërinë me ligjin dhe korinzën rregullative si dhe mirëmbajtjen e standardeve të pranuar'.³⁰⁰ Një udhëzim administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) përcakton se mbikëqyrja e pushtetit qendror mbi komunat kur 'performimi i kompetencave të veta [komunave] duhet të kufizohet në mbikëqyrjen e ligjesisë së veprimeve' kurse në rastin e '... kompetencave të deleguara [ai] duhet të përfshijë mbikëqyrjen e ligjshëmrisë së veprimeve dhe mbikëqyrjen e përshtatshmërisë së veprimit'.³⁰¹ Komunat janë të obliguara që 'çdo tre muaj t'i paraqesin MLGA-së një raport të plotë të aktiviteteve të tyre'.

Rregullorja për Pushtetin Lokal përcakton se 'Autoriteti Qendror do ta emërojë një revizor të pavarur për kontrollimin e deklaratave financiare të çdo komune', i cili do të 'ketë qasje në të gjitha deklaratat financiare, libra, shkresa dhe dokumente të tjera...

të cilat atij apo asaj i duhen për kryerjen e kontrollit³⁰² Për vitin fiskal 2001-2004, të gjitha komunat në Kosovë i kanë pasur llogaritë e tyre të kontrolluara ose nga revizorët e pavarur komercial, ose nga Zyra e Auditorit Gjeneral të Kosovës.³⁰³ Parregullësi me shkallë të ndryshme të seriozitetit janë gjetur në të gjitha komunat. Në disa raste, siç është në Fushë Kosovë, afër 40 përqind e mostrave të pagesave të kontrolluara nga ZAGJ mendohet se janë bërë me thyerje serioze të ligjit, ndërsa Komuna e Prishtinës është identifikuar për keqpërdorimin e më shumë se 300.000 euro.³⁰⁴ Herë pas here, revizorët janë ballafaquar me sjellje jo kooperuese dhe penguese nga një pjesë e zyrtarëve komunalë dhe si rezultat, bie fjala, ZAGJ ka vendosur të paraqesë akuzën kundër një zyrtari në komunën e Suharekës.³⁰⁵

Mirëpo, problemi kryesor mbetet tek zbatimi deri në fund i rekomandimeve të revizorëve ose të institucioneve të tjera përkatëse. Për shembull, të gjeturat e ZAGJ-it për keqpërdorime financiare në Komunën e Ferizajt, nxitën Kuvendin Komunal në largimin e kryeshefit ekzekutiv, të përfshirë në rast. Megjithatë, nga prokurori publik nuk është inicuar asnjë procedurë penale, edhe pse kryetari i Komunës publikisht kishte deklaruar se keqpërdorimet kapin shumën prej 700.000 euro.³⁰⁶

Përveç raporteve të revizorëve të pavarur, ligji poashtu obligon MEF-in të 'bëjë revizion të rregullt financiar të llogarive financiare të komunave...' ndërsa kryetari i komunës ka për obligim t'i 'paraqes MEF-it dhe MAPL-së raportet financiare dhe llogaritë financiare, jo më vonë se 30 ditë pas miratimit të tyre'.³⁰⁷ Por, siç ka raportuar ZAGJ në 2006, një numër i komunave, siç është Kaçaniku, Suhareka ose Fushë Kosova, nuk kanë bërë asnjë revizion të brendshëm për fondet e shpenzuara gjatë viti 2004.³⁰⁸

Përmbushja e detyrave të komunave në fushën e të drejtave të njeriut është e mbikëqyrur për së afërmi nga Insitucioni i Ombudspersonit. Përveç zyrës drejtuese në Prishtinë, IOK ka pesë zyra në terreni, me personel prej një ose dy juristëve dhe një ndihmësi gjuhësor/përkthyesi. Përpos pranimin të rregullt të kërkesave në zyrë, juristët poashtu rregullisht i vizitojnë komunat e tjera, së paku një herë në çdo muaj.³⁰⁹ Megjithatë, si në rastin e institucioneve të pushteti qendror, ndikimi i Ombudspersonit mbi autoritetet komunale është i kufizuar në dhënien e rekomandimeve dhe jo në imponimin e vendimeve. Vet IOK, në të vërtetë, njofton se 'autoritetet komunale të Kosovës kanë qenë akoma më pak të përgjegjshme se sa individët nën juridiksionin e tyre, ndaj përpjekjeve të institucioneve për të përkrahur ose ndërmjetësuar në zgjidhjen e pakënaqësive të ndryshme'. Shembulli më i jashtëzakonshëm ndaj kësaj rregulloreje është Komuna e Fushë Kosovës 'e cila gjithmonë i është përgjigjur me përpikshmëri kërkesave dhe rekomandimeve të IOK-ut', ndërsa Komuna e Prishtinës është shikuar si rast negativ, që ka 'dështuar të përgjigjet së paku në një letër që e ka marrë ...nga marsi i vitit 2004 deri në qershor 2006'.³¹⁰

Rregullorja për Pushtetin Lokal cakton një numër masash për të ndihmuar qasjen e publikut dhe të shtypit në takimet e pushtetit lokal. Sipas kësaj rregulloreje, 'Përfaqesit nga publiku, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e shtypit, do të lejohen në të gjitha takimet e Kuvendit Komunal si dhe të komiteteve të tyre', përveç nëse zbatimi i kësaj të drejteje 'mund të shkaktojë çrregullim publik apo dhunë dhe nëse

zbatimi i tyre do të rezultojë në zbulimin: e informatave të ofruara nga Pushteti Qendror për ndonjë çështje të natyrës konfidenciale; e informatave të ndjeshme personale ose komerciale; ose informatava që kanë të bëjnë me proceset aktuale apo të mundshme gjyqësore'. Gjithashtu, Rregullorja specifikon se 'Kuvendi Komunal dhe komitetet e tij vendosin për përjashtimin e publikut dhe përfaqësuesit e mediave nga tërë mbledhja ose një pjesë e mbledhjes, çdoherë kur natyra e çështjes që diskutohet mund të marrë përmasa të cilat mund të jenë të dëmshme për interesin e përgjithshëm publik'.³¹¹ Këto parime janë ripohuar edhe në udhëzimin administrativ, të lëshuar në vitin 2006, i cili vazhdoi të sqarojë edhe më hollësisht se buxhetet dhe planet komunale janë dokumente publike për të cilat komuna duhet të marrë përsipër që shtypit dhe publikut t'u mundësojë qasje.³¹²

Aktivistë të shoqërisë civile,, të angazhuar në mbikëqyrjen e punës së institucioneve qeveritare, ankohen se qasja publike në takimet dhe dokumentet e institucioneve lokale është përgjithësisht më e lehtë se e atyre në nivelin qendror. Që nga viti 2003, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), një organizatë jo-profitabile, me seli në SHBA, ka trajnuar afër 70 OJQ për mbikëqyrjen e punës së kuvendeve komunale. Që nga viti 2006, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), organizatë simotër e NDI-së, në mënyrë sistematike ka mbikëqyrë punën e organeve komunale në nëntë komuna. Për më tepër, që nga viti 2004, Handikosi, një OJQ kosovare për të drejtat e personave me afësi të kufizuara, ka pasur përfaqësuesit e vet të pranuar në tri komitete të kuvendeve komunale, si anëtarë të barabartë, me të gjitha të drejtat për votim.³¹³

7. Diskutimi i çështjeve kryesore

7.1 NIS: Institucionet e integritetit

Në vlerësimin e suksesit përkatës të shtyllave të NIS-it, dy kriteret në vazhdim janë përdorur si parime të përgjithshme udhëzuese. E para, është ndjerë se shkalla deri tek e cila një institucion ka qenë i aftë ta përmbush misionin e tij kryesor, ka pasur ndikim të madh në vet kontributin e tij në NIS. Për shembull, siç do të shtjellohet më poshtë, organi ligjvënës, i cili nuk është në gjendje të ushtrojë madje kontroll minimal mbi ekzekutivin, është një shtyllë e dobët në NIS, pavarësisht asaj se sa ligje kundër korrupsionit mund të miratohen. Kriteri i dytë, i marrë parasysh për vlerësimin e efikasitetit të një shtylle të NIS-it, është se sa një institucion ka qenë drejtpërdrejt i kyçur dhe sa ka kontribuar në luftimin e korrupsionit.

Me këto dy kriteret në mendje, si përfundim del se shtylla më e fortë në NIS-in e Kosovës janë mediat. Mediat e shkruara, në veçanti, kanë qenë një trup mjaft aktiv, i zëshëm dhe dinamik, duke paraqitur këndvështrime të ndryshme dhe duke mbajtur pozicione të ndryshme ndaj spektrit politik të Kosovës. Disa prje gazetave, *Express*-i për shembull, ka qenë veçanërisht i pandalshëm në fushatën e tij kundër korrupsionit, me artikuj që radhiten prej publikimit të raporteve të Auditorit Gjeneral deri te protestimi kundër mosndëshkimit të zyrtarëve të lartë dhe anëtarëve të ngushtë të familjeve të tyre kur e thyejnë ligjin. Kjo, natyrisht, nuk është për t'i mbuluar disa mungesa serioze të mediave kosovare, veçmas animet e dukshme politike në politikën editoriale të disa gazetave dhe të raportimit jokritik të gazetarëve.³¹⁴ Megjithatë, mediat në Kosovë meritojnë mirënjohjen më të madhe për forcimin përkatës të NIS-it, sepse, së paku disa prej anëtarëve kryesor të tyre, janë zotuar në sigurimin e një raportimi vërtet të pavarur, që nuk ka frikë të kritikojë edhe Qeverinë, edhe UNMIK-un.

Të kuptuarit më gjithpërfshirës të suksesit të medias, megjithatë, kërkon një analizë më të thellë të kontekstit institucional të pasluftës, që ndihmoi në shfaqjen e një shtypi (media) të fortë dhe të pavarur. Në njërin anë, shtylla e medias është përkrahur nga donatorët të cilët ishin të domosdoshëm për themelimin e tre stacioneve nacionale TV, si edhe në sigurimin e programeve për aftësimin e gazetarëve dhe për përkrahjen fillestare të disa gazetave të reja, si *Koha Ditore*. Në anën tjetër, institucionet siç janë OSBE-ja dhe KPM-ja, të krijuara dhe udhëhequra nga komuniteti ndërkombëtar, kanë qenë qenësore në forcimin e integritetit të përgjithshëm të shtyllës së medias. Gazetarët vendorë kanë qenë shumë herë të irituar me disa prej restriksioneve të imponuara mbi ta me rregulloren e UNMIK-ut dhe KPM-së. Megjithatë, është e vështirë të mohohet ajo, pavarësisht të metave të tyre, këto mjete dhe institucione i kanë mbrojtur mediat nga ndërhyrja arbitrare dhe kritika e Qeverisë, në një nivel që nuk është parë më herët në Kosovë.

Përkrahja e vazhdueshme e donatorëve dhe involimi i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm i komunitetit ndërkombëtar në funksionimin e Komisionit Zgjedhor, Zyrës së Auditorit Gjeneral, Insitucionit të Ombudspersonit dhe Policisë, janë po

ashtu arsyet kryesore pas suksesit përkatës të këtyre shtyllave të NIS-it. Për më shumë, sukcesi i tri insitucioneve të para është ndihmuar nga të qenurit institucione relativisht të vogla dhe vet-funksionuese, me mision të kufizuar dhe të definuar në mënyrë shumë të qartë.

Natyrisht, kontributi i tyre pozitiv në NIS duhet po ashtu të vlerësohet. Studimi sugjeron se jashtë listës së mësipërme, institucioni më i suksesshëm është Komisioni Zgjedhor, i cili ka qenë përgjegjës për sjelljen deri te realizimi i katër palë zgjedhjeve të lira dhe të ndershme nacionale. Megjithatë, OSBE-ja - si organizatë ombrellë dhe përgjegjëse për zgjedhjet, i dha NIS-it një goditje serioze kur e kundërshtoi iniciativën e shoqërisë civile për të ndryshuar ligjin zgjedhor. Në këmbënguljen për mbajtjen e listave të mbyllura zgjedhore (e bazuar në parti - jo në kandidatë), OSBE-ja dhe UNMIK-u ua mohuan kosovarëve mundësinë për t'Çi mbajtur të përgjegjshëm individualisht si parlamentarët, ashtu dhe zyrtarët e tjerë të zgjedhur.

Auditori Gjeneral dhe Institucioni i Ombudspersonit janë të ngarkuar me një problem të përbashkët: domethënë, ndonëse ata në nivel të kënaqshëm i përmbushin rolet e tyre, ashtu siç janë të definuara në ligj, efikasiteti i tyre në praktikë është i kufizuar dhe i varur nga insitucionet e tjera, veçmas nga sistemi gjyqësor. Ndonëse ZAGJ ka të drejtën për t'iu qasur llogarive të secilit institucion publik në vend, pas publikimit të raporteve të veta, fuqitë e tij ligjore janë në thelb të dobësuara. Nëse ka dëshmi të keqpërdorimit të fondeve publike, përgjegjësia për të inicuar një hetim dhe ndjekje eventuale, i mbetet Zyrës së Prokurorisë Publike.

Pozita ligjore e IOK është edhe më e dobët, megjithëse mund t'i shfaq publikisht pikëpamjet për të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut, prap nuk ka asnjë fuqi ekzekutive për t'i zbatuar ato. Pa bashkëpunimin e gjykatave, IOK-u vërtet është 'institucion pa dhëmbë'. Megjithatë, ZAGJ dhe IOK, që të dyja kanë ndikim pozitiv mbi NIS-in për shkak të rolit të tyre edukativ dhe informativ. Ato janë shtylla të rëndësishme në procesin e ndërtimit institucional të Kosovës, sepse kontribuojnë për një publik më të informuar dhe më kritik, i cili është parakusht për përgjegjësi në sektorin publik.

Me disa hapa të rëndësishëm, SHPK-ja po ashtu mund të konsiderohet si shtyllë e suksesshme në NIS. Merita kryesore e SHPK-së qëndron në pozitën e tyre të mirë në opinionin publik. Gjithashtu, mbetja nën menaxhimin e UNMIK-ut nënkupton se SHPK-ja u zhvillua në një shërbim policor civil, kryesisht të pavarur nga ndikimet politike dhe krejtësisht i ndryshëm nga shërbimi policor, shpesh represiv dhe i kontrolluar nga regjimi i ish - Jugosllavisë. Megjithatë, raportet e SHPK-së dhe CIVPOL-it në luftimin e korrupsionit janë shumë më pak mbresëlënëse: pavarësisht themelimit të shumë njësive speciale për luftimin e krimeve serioze dhe korrupsionit, Policia e UNMIK-ut bëri shumë pak arrestime të suksesshme në këto fusha.

Megjithatë, efikasiteti i policisë në luftimin e drejtpërdrejtë të korrupsionit është shumë i ndërlidhur me sistemin gjyqësor - sistemi më i dobët në NIS-in e Kosovës. Studimi do të argumentojë se gjyqësia për dy arsye është shtylla e fundit e suksesit në NIS. E para, kjo shtyllë nuk është vet transparente dhe është e pllakosur me deklarata

për korrupsion mjaft shumë të përhapur - problem i cili nuk është adresuar në mënyrë sistematike deri më sot. E dyta, dhe ndoshta edhe më e rëndësishmja, ka të bëjë me dështimin e gjysësisë për t'i çuar deri në fund deklaratat dhe dëshmitë për korrupsionin dhe parregullësitë në institucionet publike, që e pengojnë efikasitetin dhe integritetin e shtyllave të tjera të NIS-it. Në rastin më të mirë, sistemi gjyqësor jofunksional e bën të kotë punën e institucioneve të tjera, siç është rasti me ZAGJ-in në Kosovë. Në rastin më të keq, e ndihmon shfaqjen e korrupsionit, duke mos i mbajtur nën kontrollë institucionet e tjera të rëndësishme, siç është ekzekutivi.

Mirëpo, gjyqësori nuk është i vetmi bllok kryesor i ndërtimit të sistemit shtetëror që ka dështuar në përkrahjen e integritetit institucional në Kosovë. Legjislativi dhe ekzekutivi janë shumë afër, sa i përket dështimit në kundërshtimin e korrupsionit brenda vetes së tyre dhe ndërmarrjes vetëm të disa përpjekjeve gjysëm entuziaste në luftimin e tërsishëm të korrupsionit.

Plejada e forcave politike në Kuvendin e Kosovës do të thotë se legjislativi ushtron kontroll të parëndësishëm mbi ekzekutivin. Epërsia e koalicionit qeverisës në Kuvendin e Kosovës - dhe veçanërisht e partisë më të madhe në pozitë - LDK, tregon se thirrjet e opozitës në mënyrë sistematike mund të injorohen. Për shembull, Kuvendi ende nuk ka qenë në gjendje që zyrtarisht të intervistojë cilindo ministër, ministria e të cilit është gjetur se ka mangësi në fushën e menaxhimit financiar nga ZAGJ. Gjithashtu, për veturën në vlerë mbi 200.000 euro, të paguar por ende të padorëzuar, Kryesia e Kuvendit vetë ka qenë temë e deklaratave për parregullësi financiare.

Ekzekutivi, për arsye të ngjashme, ka qenë mjaft shtyllë e dobët në NIS-in e Kosovës. Në njërin anë, disa ministri, siç është ajo e Ekonomisë dhe Financave, apo e Tregtisë dhe Industrisë, janë bërë sinonim me deklaratat për nepotizëm dhe klanizëm, kurse të tjerat, siç është ajo e Komuniteteve dhe Kthimit, vazhdimisht kanë qenë në titujt kryesor me dyshime për keqpërdorime financiare. Në anën tjetër, aktivitetet e Qeverisë në zhvillimin e një agjencie efektive kundër korrupsionit, kanë qenë vërtet të pakta. Janë dashur 2 vite pas miratimit të Ligjit Kundër Korrupsionit, për t'u themelur Agjencia Kundër Korrupsionit, dhe edhe tani agjencia ka staf dhe pajisje të pamjaftueshme. Në të vërtetë, madje edhe vet anëtarët e Këshillit kundër korrupsionit besojnë se ky trup ka vetëm kompetenca formale dhe nuk do të bëjë asgjë të dukshme në praktikë.

Ndikimi i shërbimit civil dhe qeverisë vendore në NIS-in e Kosovës gjithashtu nuk është për t'u lavdëruar, ndonëse ndikimi i tyre negativ është më shumë i kufizuar për shkak të fuqisë së tyre thelbësisht të dobët institucionale. Siç u përmend tashmë, këto shtylla janë më së shpeshti të kritikuar për të qenurit qendra të korrupsionit të vogël, shërbimeve joprofesionale dhe nepotizmit. Por, akuzat serioze të lidhura me keqpërdorime financiare të mijëra eurove, po ashtu janë nivelizuar, veçanërisht ato të lidhura me aktivitetet e prokurimit në disa komuna të mëdha. Kritikrat e tilla po ashtu theksojnë dobësitë e shtyllës së prokurimit publik në Kosovë. Ndonëse ekziston ligji gjithëpërfshirës për prokurimin publik, tri insitucionet qendrore përgjegjëse për zbatimin e tij dhe njësitë e brendshme të prokurimit publik, pothuajse në secilin organ të financuar nga Buxheti i Kosovës, raportet e ZAGJ-it janë të pamjaftueshëm për të

ilustruar dështimet spektakulare të kësaj shtylle. Pjesa më e madhe e raporteve të ZAGJ-it paraqesin thyerjen e rregullave të prokurimit, si forma më të shpeshta të keqmenaxhimit financiar në insitucionet publike të Kosovës.

Përfundimisht, ndonëse Zyra për Regjistrimin e Partive Politike (ZRPP) dhe shoqëria civile nuk e kanë nxitur korrupsionin drejtpërsëdrejti në Kosovë, kontributi i tyre në forcimin e NIS-it ka qenë shumë i vogël. ZRPP-ja në të vërtetë ka bërë publike raportet mbi të hyrat dhe shpenzimet e partive politike, saktësisht siç kërkohet me ligj. Megjithatë, ndikimi i saj ka qenë i parëndësishëm për dy arsye. E para, edhe pse ZRPP-ja ka të drejtën të udhëheqë hetime të pavarura, raportet e saj zakonisht kanë qenë të bazuara në deklarata të bëra nga vet partitë, e që në këtë mënyrë nuk kanë ofruar vlerësim të besueshëm dhe të pavarur për llogaritë e partive politike. E dyta, edhe pse ZRPP-ja raporton se shumë parti nganjëherë kanë shkelur ligjin mbi donacionet dhe pagesat, personeli atje pranon se ata asnjëherë nuk kanë shqiptuar gjopa më të mëdha se 200 euro, edhe atëherë kryesisht për arsye të paraqitjes me vonesë të llogarive të partive.

Shoqëria civile, po ashtu, nuk ka qenë shtyllë shumë e suksesshme e NIS-it, për shkak të ndikimit të saj afatgjatë të kufizuar në transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike. Derisa shoqëria civile në të vërtetë ka organizuar një numër të fushatave të vetëdijësimit kundër korrupsionit, efikasiteti i tyre në luftimin e tanishëm të korrupsionit është dyshues. Në anën tjetër, fushatat e gjëra sociale dhe politike që do të mund të ndihmonin në përmirësimin e qeverisjes në Kosovë, siç ishte ajo për ndryshimin e Ligjit Zgjedhor në vitin 2004, janë ndërprerë nga bashkëpunorët e tjerë, duke minimizuar kështu edhe efikasitetin e OJQ-ve.

Shkurt, NIS-i i Kosovës është i mangët për dy arsye. E para, derisa është shënuar një progres i dukshëm në zhvillimin e kornizës legjislative moderne kundër korrupsionit, zbatimi i ligjit në praktikë shpesh ka munguar. Kjo më së miri ilustron faktin se janë dashur më shumë se një vit pas miratimit të Ligjit Kundër Korrupsionit për të zgjedhur drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe zyra e tij ende nuk është funksionale dhe e kompletuar me personel. Një paraqitje e tillë instiucionale qëndron në kundërshtim të dukshëm me qëndrimin zyrtar të politikanëve të Kosovës, siç është Kryeministri i tanishëm, Agim Çeku, i cili deklaroi se ‘... parandalimi dhe luftimi i korrupsionit është i domosdoshëm, sepse jep rezultate të drejtpërdejtja në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve dhe në ngritjen e besimit të tyre në institucionet publike’.³¹⁵

E dyta, NIS-i i Kosovës është i mangët po ashtu për shkak të mosfunksionimit të disa shtyllave kryesore, që vazhdimisht e zvogëlojnë efikasitetin e shtyllave të tjera të suksesshme. Dështimet e gjyqësisë duhet të potencohen këtu për shkak të ndikimit goditës që ka në institucionet e tjera. Për shembull, Zyra e Auditorit Gjeneral e përmbush rolin e vet ashtu siç e kërkohet me ligj, auditimin e llogarive të institucioneve publike dhe publikimin e tyre. Ngjajhëm, mediat janë të mbuluara me artikuj që paraqesin dëshmi të shkeljeve dhe keqmenaxhimit në institucionet publike. Megjithatë, mbetet përgjegjësi e Zyrës së Prokurorisë Publike që të ec përpara mbi këto dëshmi dhe të ngris padi penale kur është e nevojshme. Kur kjo nuk bëhet, jo

vetëm integriteti profesional, por edhe vlerat e ZAGJ-it dhe të mediave vihen në pikëpyetje – pasi që ato konsiderohen se janë thjesht ‘institucione që flasin’ – por respekti i publikut për tërë NIS-in është zvogëluar.

Si përfundim, zhvillimi i institucioneve siç është Ombudspersoni, Auditori Gjeneral, ose SHPK-ja kanë përkrahur integritetin e procesit të rindërtimit në Kosovë përmes vendosjes së disa ndalesave, vlerësimeve dhe kontrolleve. Do të thotë, dështimet e institucioneve të tjera kryesore, posaçërisht gjyqësia, legjislativi dhe ekzekutivi, kanë penguar zhvillimin e një NIS-i të fortë që do të mund të vazhdonte të ndikojë dhe udhëheq më mirë procesin e rindërtimit.

7.2 Ecuria e reformave në rindërtim

Shikuar nga perspektiva e të gjitha përpjekjeve të bëra nga donatorët në procesin e rindërtimit në Kosovë, përkrahja për ‘aktivitetet kundër korrupsionit’ si e tillë hyri relativisht vonë në agjendë. Siç u elaborua edhe më lart, donatorët fillimisht u përqendruan në aktivitete të rindërtimit fizik dhe ndërtimit të përgjithshëm institucional, ashtu që përkrahja kundër korrupsionit ka qenë e natyrës *ad hoc*. Ideja e ‘zhdukjes sistematike të korrupsionit’ hyri në diskursin publik vetëm në vitin 2003, me miratimin e “Standardeve për Kosovën” të UNMIK-ut, dokument që sqaronte një grup të kushteve që Kosova duhet t’i plotësojë para se të fillonin negociatat për statusin e saj të ardhshëm. Ndër të tjera, Standardi 2, ‘Sundimi i Ligjit’, kërkoi ‘që ligjet kundër korrupsionit të zbatohen dhe të dy palët, ata që kërkojnë rryshfet si dhe ata që ofrojnë të dënohen’.³¹⁶

Roli i Qeverisë së Kosovës në vendosjen e agjendës kundër korrupsionit përgjithësisht ka qenë vërtet i kufizuar, ka vepruar thjesht si pranues i fondeve dhe zbatues i programeve të donatorëve mbi integritetin institucional. Prapëseprapë, duke marrë parasysh rëndësinë e ‘Standardeve për Kosovën’ në negociatat për statusin final, qëndrimi zyrtar i Qeverisë për debatin e ri kundër korrupsionit që nga fillimi ka qenë i mirëpritur. Duke folur për nxjerrjen e Strategjisë Anti-Korrupsion të Qeverisë së Kosovës në vitin 2004, kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Bajram Rexhepi, deklaroi se ‘Qeveria e Kosovës është zotuar për gjetjen e një zgjidhjeje më të mirë në luftimin e korrupsionit’.³¹⁷

Mirëpo, zbatimi i kësaj retorike në praktikë doli të jetë shumë më i vështirë dhe vetëm disa vërtet iu përgjigjën detyrës. Në të vërtetë, kur në fillim të vitit 2006, Agim Çeku, u emërua kryeministër i Kosovës u betua se ai do ta rishikojë punën e ministrave në 100 ditët e para dhe do ta shkarkojë cilindo prej tyre që është i implikuar në skandale financiare. Ndërkaq, konsideratat politike u treguan më të fuqishme se zotimet ose dëshira e Çekut: kur ditët e caktuara kaluan, askush nga kabineti nuk u shkarkua, megjithëse deklarata për keqpërdorime financiare të një numri të ministrave ishin përhapur përmes gazetave ditore.³¹⁸

Përpjekjet e donatorëve për të luftuar korrupsionin është kanalizuar në dy drejtime kryesore: drejtpërdrejt përmes institucioneve vendore ose përmes ndërmjetësuesve, siç është shoqëria civile ose UNMIK-u. Në njërin anë, shumë fonde të dedikuara veçmas

për 'aktivitete kundër korrupsionit' kanë qenë të përqendruara në shoqërinë civile, përmes programeve siç janë KNAP i USAID-it ose OJQ-të si 'Çohu'. Ende, ashtu siç u argumentua tashmë, pavarësisht publicitetit që në atë kohë mund të nxitnin OJQ-të, ato rrallë qenë të afta të sjellin ndryshime efektive dhe të përhershme në sjelljet dhe praktikatat e institucioneve publike. Për më shumë, fondet që shkuan tek institucionet e specializuara të UNMIK-ut kundër korrupsionit, si UE-ja që financoi FIU-në, nuk qenë efektive për një periudhë afatgjate, sepse ata dështuan që t'i shfytëzojnë në mënyrë të duhur institucionet vendore, siç është SHPK-ja.

Në anën tjetër, pas miratimit të dokumentit 'Standardet për Kosovën', donatorët po ashtu intensifikuan përkrahjen e tyre të drejtpërdrejtë për institucionet e Kosovës, me synim forcimin e integritetit të tyre në një kuptim më të gjërë, përmes projekteve për ngritjen e kapaciteteve. Kështu, për shembull, financimi është siguruar për KIPA-në, Institut i Kosovës për Trajnimin e Shërbyesve Civil, dhe njësitë e tjera kundër korrupsionit, të formuara brenda policisë së UNMIK-ut. Megjithatë, siç u elaborua në pjesët e veçanta, donatorët i kanë përzier rezultatet në këto përpjekje: vërtet kanë qenë disa tregime të suksesshme, siç është themelimi dhe 'kosovarizimi' i Komisionit Qendror Zgjedhor, por ata janë ndeshur me disa dështime të mëdha, veçanërisht me gjyqësinë e dobët.

Me një fjalë, janë dy mungesa kryesore të qasjes kundër korrupsionit, të miratuara nga donatorët në Kosovë. E para, si edhe në tërë procesin e rindërtimit, donatorët rrallë janë koordinuar me njëri tjetrin, kështu që është krijuar pak sinergji efektive. E dyta, gjyqësia është menaxhuar mjaft keq, shumë pak e financuar dhe e papërkrahur. Siç u argumentua deri më tani, kjo e ka penguar përkrahjen dhe punën e bërë në shtyllat e tjera, funksionimi efikas i të cilave varet qenësisht nga një gjyqësi e fortë, e paanshme dhe e respektuar.

7.3 Efikasiteti i reformave në rindërtim

Përpjekjet e donatorëve për të luftuar korrupsionin kanë qenë të pakta që nga fillimi dhe, deri më sot, të gjitha kanë dështuar. Duke filluar me Ligjin për Zhdukjen e Korrupsionit, që ka pasur një të metë kryesore, që nuk e përfshin korrupsionin e mundshëm të institucioneve ndërkombëtare dhe burokratëve të tyre, të cilët patën kompetenca të papara në cilëndo demokraci tjetër perendimore.³¹⁹ E dyta, madje edhe autoritetet vendore që është dashur të veprojnë sipas ligjit, kryesisht e injoruan atë që nga momenti i hyrjes në fuqi. Shumë muaj kaluan para se të themelohej Këshilli i Agjencisë Kundër Korrupsionit, kurse emërimi i Drejtorit të Agjencisë zgjati edhe më shumë. Akoma, më shumë se një vit pas nxjerrjes së Ligjit Kundër Korrupsionit, Agjencia nuk ka nisur as edhe një hetim të vetmëm ose të jetë marrë me çfarëdo ankese - mos kompletimi me staf të duhur mbase mund ta shpjegojë këtë deri në njëfarë mase.

Rezultati i donatorëve në këtë fushë ka qenë vetëm pak më i mirë. Përpjekjet për ta vënë në shënjestër korrupsionin përmes shoqërisë civile ka qenë të gabuara në

kocept, për shkak të dobësive përkatëse të kësaj shtylle që të ndikojë drejpërdrejt në sjelljet e zyrtarëve vendorë. Përpjekjet për t'u ballafaquar me korrupsionin përmes formimit të njësive të specializuara hetimore dështuan në zbatim: numri i përndjekjeve të suksesshme që ka rezultuar nga puna e njësive të tilla, siç është FIU dhe ITF, ose Zyra e Kosovës për Krimin e Organizuar (KOCB), është thuaja se i pa qenë.. Veç kësaj, shumë pak është bërë në koordinimin e njësive të tilla të ndryshme, siç është *Guardia di Finanza* Italiane, që duhej të vepronte vetëm përkohësisht në Kosovë, me qëllim të aftësimit për punë të zyrtarëve policorë në SHPK dhe disa zyrtarë vendorë ankoheshin se policia ndërkombëtare e UNMIK-ut, prokurorët dhe gjykatësit, janë marrë me rastet e tyre në një mënyrë jo transparente dhe jo-gjithpërfshirëse.³²⁰ Në tërësi, prandaj, përpjekjet e donatorëve për të përkrahur integritetin e institucioneve vendore kanë qenë më të suksesshme se 'aktivitetet e tyre kundër korrupsionit', por edhe kjo ka ndryshuar prej rasti në rast.

8. Prioritetet dhe rekomandimet

Ecuria e procesit të rindërtimit në Kosovë ka qenë e përcaktuar shumë nga përfitimet politike si dhe nga pasiguria në vend. Rindërtimi fizik kryesoi agjendën në vitet e para të pas luftës, sepse ishte prioritet real kur merret parasysh shkatërrimi i shtëpive private dhe i infrastrukturës publike. Po ashtu, prania e UNMIK-ut nënkuptonte se ndërtimi institucional fillimisht mund të lihej pak anash, duke lejuar kështu që fondet të përqendrohen në rindërtimin fizik.

Hapi i ardhshëm i natyrshëm pas fazës emergjente - ishte në të vërtetë ndërtimi i institucioneve vendore. Sfida ishte e dyanshme: bashkësia ndërkombëtare ishte e ngarkuar me 'ndërtimin e shtetit' në një vend me pasojat e fundit të komunizmit, aparteidit dhe luftës. Me fjalë të tjera, çdo insitucion duhej të krijohej prej fillimit dhe të rregullohej sipas modelit të ri, perendimor, institucional. Të ballafaquar me sfida të tilla të jashtëzakonshme në rindërtim dhe në ndërtimin bazik institucional, krijimi i një shoqërie të liruar nga korrupsioni, fillimisht nuk ka qenë në krye të agjendës së UNMIK-ut. Kjo, mbase, shpjegon karakterin e pakoordinuar dhe kryesisht *ad hoc* të shumë përpjekjeve kundërr korrupsionit, veçmas para periudhës – 'Standardet për Kosovën'.

Sidoqoftë, pasojë e kësaj pjese të reformave ka qenë se disa institucione kyçe të integritetit kanë mbetur të pazhvilluara. Siç u cek tashmë, dështimi për të krijuar një gjyqësi të fortë dhe të besueshme ka qenë arsyeja kryesore që e ka zvogluar efektivitetin, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e shumë shtyllave të tjera. Ndonëse janë bërë përpjkeje të shumta për modernizimin e sistemit ligjor, përmes adoptimit të shumë ligjeve të UE-së, NIS-i i Kosovës sot mbetet i dobët pikërisht sepse gjyqësia është e paaftë për të imponuar sundimin e ligjit.

Kështu, çdo përpjekje e ardhshme në rindërtim, që përfshin një sërë aktivitetesh në ndërtimin institucional, duhet të përqendrohet në zhvillimin e një gjyqësori të fortë, të lidhur ngusht me një shërbim policor efikas dhe organe efektive hetimore. Studimi tregon se është kjo një detyrë e vështirë, posaçërisht në vendet që kanë kaluar nëpër konflikt etnik ose sektarian dhe që ende janë shumë të ndarë sipas këtyre vijave. Por,

derisa të mos ndalohet menjëherë kjo, me miliona euro nga fondet e donatorëve mund të humbasin në aftësimin e shërbyesve civil ose në ndërtimin e institucioneve, siç është Ombudspersoni, pa ndikuar shumë në përfitimin afatgjatë. Njësoj sikurse edhe më lart, ky studim rekomandon që të ndërmerren studime kërkimore krahasuese, për të kuptuar më mirë sfidat gjatë vendosjes së rendit dhe sundimit të ligjit në vendet e pas luftës, si dhe mundësitë e zhvillimit të një gjyqësori të fortë në rrethana të tilla.

9. Fusnotat

- ¹ MEF, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2003, fq.2.
- ² Për më shumë të dhëna referohu në: <http://Kosovo.starttips.com>.
- ³ Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG), ‘Collapse in Kosovo’, Prishtina/Belgrade/Brussels, 22 prill 2004.
- ⁴ MEF, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2006, fq.7.
- ⁵ IMF (Rakia Moalla-Fetini, Heikki Hatanapaa, Shehadah Hussein and Natalia Koliadina), ‘Kosovo – Gearing Policies Toward Growth and Development’, 18 nëntor 2004, fq. 20.
- ⁶ Teksti i Marrëveshjes mund të gjendet në ueb-faqen e NATO-s, <http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>, shikuar më 15 shtator 2006.
- ⁷ Të dhënat e publikuara nga KMLDNJ-ja janë të bazuara në deklaratimet e njerëzve.
- ⁸ MMPH (Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit, Sektori i Rindërtimit), ‘Banimi dhe Procesi i Rindërtimit në Kosovë 1999-2002’, Prishtinë, 2003.
- ⁹ ESK, www.ks-gov.net/esk/pdf/economic/Housing_in_Kosovo.pdf, shikuar më 1 dhjetor 2005.
- ¹⁰ USAID, ‘Kosovo – Regional Overview’, FRY Overview, www.usaid.gov, shikuar më 14 mars 2006.
- ¹¹ EAR, ‘Kosovo 1999 Action Programme’, www.ear.eu, shikuar më 14 mars 2006.
- ¹² Department for International Economic Cooperation (Donor Cooperation Division), ‘Annual Report on Donor Activities in Kosovo Janar 2004 – Dhjetor 2004’, shtator 2005, fq. 7-8.
- ¹³ MEF, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2003, fq.2.
- ¹⁴ *Op. cit.*, Department for International Economic Cooperation, ‘Annual Report 2004’, fq.6 dhe fq. 9.
- ¹⁵ Intervistë me personin anonim, ish-zyrtar, Njësia për Koordinimin e Donatorëve, Departamenti i Rindërtimit (DiR), UNMIK, 16 mars 2006.
- ¹⁶ Për më shumë informata shiko: IKS, ‘Rindëtimi i pas-luftës-Përshkrimi i vendit : Kosovë’, prill 2006, Kap. 3.
- ¹⁷ Intervistë me Verena Knaus- Analiste seniore, ESI, shkurt 2006.
- ¹⁸ *Op. cit.*, Anonymous, Anonim, DiR, UNMIK, 16 mars 2006.
- ¹⁹ Intervistë me Rexhep Vasolli, Ushtryes detyre-drejtor, Sektori për Koordinimin e Donatorëve, MEF, shtator 2005.
- ²⁰ *Op. cit.*, Department for International Economic Cooperation, ‘Annual Report 2002’ and ‘Annual Report 2004’.

- ²¹ Roy Dickinson, Co-head of the Department of Reconstruction, duke prezantuar ne Mbledhjet e Donatorëve për Kosovën, mbajtur në Prishtinë, në shkurt të vitit 2001. I gjithë teksti i deklaratës së mund të lexohet në: www.seerecon.org/calendar/2001/events/kdcm/statements/dickinson.htm, shikuar më 30 nëntor 2005.
- ²² *Op. cit.*, Department for International Economic Cooperation, 'Annual Report 2002', and 'Annual Report 2004'.
- ²³ *Op. cit.*, Verena Knaus, ESI.
- ²⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/1, *Mbi Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative të Kosovës*, Gazeta zyrtare e UNMIK-ut , www.unmikonline.org.
- ²⁵ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, *Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë*, Gazeta zyrtare e UNMIK-ut , www.unmikonline.org.
- ²⁶ Departamenti i Rindërtimit, 'Partneriteti në Kosovë: Rindërtimi 1999-2000', Prishtinë, shkurt 2001, fq.11
- ²⁷ *Op. cit.*, Rexhep Vasolli, MEF.
- ²⁸ Intervistë me Kriton Begolli, Programming and Quality Assurance, AER, 7 tetor 2005.
- ²⁹ Intervistë me David Leong, zëvendës drejtor i misionit, USAID, 25 Tetor 2005.
- ³⁰ MEF, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2005, fq.35.
- ³¹ RIINVEST, 'Analizë e opinioneve të publikut mbi korrupsionin në Kosovë', Prishtine, 2006. Ju Item shikoni publikimin me listën e anketave të analizuara.
- ³² 'Përkufizimi i përdorur i korrupsionit është: abuzimi i fuqisë së besuar për qëllime personale. Përkufizimi i përdorur i integritetit është: mbështjetja në standarde të larta profesionale dhe principe morale'. Shiko: Tiri, 'Integrity in Reconstruction: Corruption, Effectiveness and Sustainability in post-war countries – Terms of Reference for Country Partners', korrik 2005, fq. 4.
- ³³ *Op. cit.*, RIINVEST, 'Analizë e opinioneve të publikut mbi korrupsionin në Kosovë', fq. 5-7.
- ³⁴ *Ibid.*
- ³⁵ Intervistë me Safete Hadërgjonaj, deputete e Parlamentit të Kosovës dhe anëtare e Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, PDK, gusht 2006.
- ³⁶ *Op. cit.*, RIINVEST, 'Analizë e opinioneve të publikut mbi korrupsionin në Kosovë', fq. 5-7.
- ³⁷ *Ibid.*
- ³⁸ Qeveria e Kosovës, 'Strategjia Anit-Korrupsion, Prishtinë, 17 mars 2004, fq.13.
- ³⁹ Ligji i Kuvendit të Kosovës 2004/34, *Mbi Zhdukjen e Korrupsionit*, shpallur nga Rregullorja e UNMIK-ut 2005/26, *Mbi shpalljen e Ligjit për Zhdukjen e Korrupsionit, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës* , Gazeta zyrtare e UNMIK-ut , www.unmikonline.org.
- ⁴⁰ Bisedë telefonikeme Habit Hajredini, udhëheqës i Zyres për Qeversije të Mirë, 2 dhjetor 2005.

- ⁴¹ Intervistë me Gani Koci, anëtar, Këshilli i Agjencisë Anti-Korrupsion, 1 shtator 2006. Shiko, gjithashtu, Artan Behrami, 'Inspektor Preteni', *Express*, 13 shtator 2006, fq. 10-11.
- ⁴² *Op. cit.*, Gani Koci, Këshilli i Agjencisë Anti-Korrupsion
- ⁴³ EAR, 'Annual Action Programme for 2005 for Community Assistance to Kosovo, Justice and Home Affairs', p. 3, <http://www.ear.europa.eu/kosovo/main/documents/2005Justice.pdf>, shikuar më 29 maj 2006.
- ⁴⁴ UNDP, PISG (OGG), 'Combating corruption in Kosovo: A citizen's perception survey in support of the Kosovo Anti-Corruption Strategy', fq. 4.
- ⁴⁵ Fatmire Tërdevci, 'Impunity for Graft', Transition Online (TOL), 20 tetor 2005, <http://www.nobribes.org/en/news/print.asp?ed=21>, shikuar më 18 shtator 2006.
- ⁴⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19, *Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë*, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.
- ⁴⁷ Faik Hoti, *Koha Ditore*, 3 gusht 2006, p.2.
- ⁴⁸ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.
- ⁴⁹ *Ibid.*
- ⁵⁰ *Ibid.*
- ⁵¹ Ministrinë e tanishme janë: (i) Komunitete dhe Kthim; (ii) Administrimi i Pushtetit Lokal; (iii) Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural; (iv) Edukim, Shkenë dhe Teknologji; (v) Transport dhe Post-Telekomunikacion; (vi) Shërbime Publike; (vii) Shëndetësi; (viii) Energji dhe Miniera; (ix) Ekonomi dhe Financa; (x) Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Jorezidente; (xi) Punës dhe Mirëqenies Sociale; (xii) Tregti dhe Industri; (xiii) Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; (xiv) Drejtësi; and (xv) Punë të Brendëshme. Ueb-faqje e Qeverisë së Kosovës: www.ks-gov.net, shikuar më 18 maj 2006.
- ⁵² *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9.
- ⁵³ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9.
- ⁵⁴ SIGMA, 'Assessment Report: Serbia and Montenegro – Kosovo, Governance and Public Administration 2004', p. 7, www.oecd.org, shikuar më 18 gusht 2006.
- ⁵⁵ *Op. cit.*, MEF Buxheti i Kosovës 2005, fq. 218.
- ⁵⁶ *Op. cit.*, Buxheti i Kosovës 2006, fq. 63.
- ⁵⁷ Intervistë me person anonim, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, mars 2006 dhe 4 shtator 2006.
- ⁵⁸ 'zyrtar senior' ka kuptimin për: Presidentin e Kosovës, Kryeministrin, Anëtarët e zgjedhur të Kuvendit, ministrat, sekretarët e Qeverisë, sekretarët permanentë, drejtorët e zyrave brenda ministrive, gjyqtarët dhe prokurorët si dhe zyrtarët seniorë ndërkombëtarë sipas Ligjit për Zhdukjen e Korrupsionit, *op. cit.*, Neni 2.

⁵⁹ Neni 33.3 specifikon se ‘Dhurata të rastit në vlerë të vogël konsiderohen dhuratat e sjella në raste të ndryshme të jubileve të punës dhe personale, raste festash dhe raste të ngjashme dhe nuk e kalojnë vlerën 50 €ose vlera totale e tyre nuk kalon 100 €në një vit, nëse ato sillen nga i njëjti person.

⁶⁰ *Op. cit.*, Fatmire Tërdevci, ‘Impunity for Graft’, TOL.

⁶¹ Chicago Kent College of Law, ‘Kosovo History’, <http://operationkosovo.kentlaw.edu>, shikuar më 10 maj 2006.

⁶² *Op. cit.*, MEF, Buxheti i Kosovës 2003, fq. 62.

⁶³ *Op. cit.*, MEF, Buxheti i Kosovës 2005, fq. 39.

⁶⁴ AER, Programi i Asistencës së KE-së 2003, <http://www.ear.eu.int>, shikuar më 15 maj 2006.

⁶⁵ UNDP, Përkrahje për arkivat parlamentare të Parlamentit në Kosovë, <http://www.ks.undp.org>, shikuar më 12 maj 2006.

⁶⁶ OSBE Misioni në Kosovë, <http://www.osce.org>, shikuar më 15 maj 2006.

⁶⁷ *Op. cit.*, MEF, Buxheti i Kosovës 2005, fq. 40.

⁶⁸ *Op. cit.*, Safete Hadërgjonaj, PDK.

⁶⁹ MEF, Buxheti i Kosovës 2006, p.60.

⁷⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/17, Për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë., Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut , www.unmikonline.org.

⁷¹ *Op. cit.*, Safete Hadërgjonaj, PDK.

⁷² *Op. cit.*, UNMIK Regulation 2003/17.

⁷³ *Op. cit.*, Safete Hadërgjonaj, PDK.

⁷⁴ Kuvendi i Kosovës , General Principles of the Rules of Procedure of the Assembly of Kosovo, <http://www.assembly-Kosovo.org>.

⁷⁵ *Ibid.*

⁷⁶ *Op. cit.*, Safete Hadërgjonaj, PDK.

⁷⁷ ‘Rreth 5000 euro për veshmbathje, 800 euro për dreka, mijëra euro rroga për Brezovicë’, *Koha Ditore*, 20 prill 2006.

⁷⁸ ‘Auditori Deloitte &Touche bën auditimin e Kuvendit të Kosovës’, *Zëri*, 31 mars 2006..

⁷⁹ Shiko p.sh, KIPRED, ‘Reformimi i Sistemit Zgjedhor në Kosovë, Punim diskutimi, Botimi i dytë, Prishtinë, 2005, fq. 12, www.kipred.net.

- ⁸⁰ International Relations and Security Network (ISN), 'Decision 305 of the Permanent Council of the OSCE establishing the OSBE Misioni në Kosovë', Permanent Council, 1 Korrik 1999, www.isn.ethz.ch/osce, shikuar më 15 mars 2006.
- ⁸¹ OSBE Misioni në Kosovë, Departamenti i Zgjedhjeve, 'Zgjedhjet', www.osce.org/kosovo, shikuar më 16 janar 2006.
- ⁸² Vullnetarët e UN-it në Kosovë, www.unmikonline.org, shikuar më 28 mars 2006
- ⁸³ *Op. cit.*, ISN, 'OSBE Misioni në Kosovë'.
- ⁸⁴ Intervistë me person anonim, OSBE Departamenti i Zgjedhjeve, 12 prill 2006.
- ⁸⁵ Rregullorja e UNMIK-ut 2004/9, *Mbi Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve*, ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/45, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.
- ⁸⁶ OSBE, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, www.osce.org/kosovo, shikuar më 13 janar 2006.
- ⁸⁷ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/9.
- ⁸⁸ Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2003/28, që implementon Rregulloren e UNMIK –ut 2000/21, mbi Thmelimin e KQZ-së, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.
- ⁸⁹ *Op. cit.*, Intervistë me Sabri Halili, udhëheqës, Departamenti i Zgjedhjeve në Sekretariatit e KQZ-së, 12 janar 2006
- ⁹⁰ *Ibid.*
- ⁹¹ *Op. cit.*, Buxheti i Kosovës 2005, fq.91.
- ⁹² *Op. cit.*, Sabri Halili, SKQZ.
- ⁹³ KQZ, Rregullat e Zgjedhjeve, <http://internet.cec-ko.org/en/electoral.html>, shikuar më 14 gusht 2006.
- ⁹⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2004/12, *Mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës*, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.
- ⁹⁵ ECAC -gjithsej gjobat e papaguara deri me 1qershor 2005, www.kosovoelections.org, shikuar më 31 mars 2006.
- ⁹⁶ Cituar në Gary Dempsey, 'Kosovo's Contradictory Elections', Cato Institute: <http://www.cato.org/dailys/12-07-01.html>, shikuar më 23 mars 2006.
- ⁹⁷ Voice of America, Politics, Prof. Julie Mertus, 'Elections in Kosovo', www.albanian.com, shikuar më 13 janar 2006. See also: BBC Albanian, 'NATO vlerëson zgjedhjet në Kosovë', 25 tetor 2004, www.bbc.co.uk/albanian/news, shikuar më 23 mars 2006); BBC Albanian, 'Reagim i Këshillit të Evropës', <http://www.bbc.co.uk/albanian/news>, shikuar më 23 mars 2006.
- ⁹⁸ ESK, <http://www.sok-kosovo.org/statistics/elections.htm>, shikuar më 5 prill 2006.
- ⁹⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2004/11, *Mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë*, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org. *Op. cit.*, person anonim, OSBE Departamenti i Zgjedhjeve.

¹⁰⁰ OSBE Misioni në Kosovë, 'Zgjedhjet', <http://www.osce.org/kosovo/13208.html>, shikuar më 1 shtator 2006; OSBE Misioni në Kosovë, Zgjedhjet në Kosovë, Regjistrimi i Partive Politike, 'Zyra për regjistrimin e Partive Politike', <http://kosovoelections.org/eng/pfd/index.htm>, shikuar më 1 shtator 2006.

¹⁰¹ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/11, and *op. cit.*, person anonim, OSBE Departamenti i Zgjedhjeve.

¹⁰² *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/12, *Mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës*; ZRPP, <http://kosovoelections.org/eng/pfd/partydisclosure.htm>, shikuar më 7 prill 2006.

¹⁰³ *Op. cit.*, Person anonim, OSBE Departamenti i Zgjedhjeve.

¹⁰⁴ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/11.

¹⁰⁵ *Op. cit.*, Person anonim, OSBE Departamenti i Zgjedhjeve.

¹⁰⁶ *Ibid.*

¹⁰⁷ *Ibid.*

¹⁰⁸ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/11.

¹⁰⁹ *Op. cit.*, person anonim, OSBE Departamenti i Zgjedhjeve.; *Op. cit.*, Rreg. e UNMIK 2004/11

¹¹⁰ *Ibid.*

¹¹¹ Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2, *Mbi Pengimin e Larjes së Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale* (nryshyar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2005/42), Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.

¹¹² *Ibid.*

¹¹³ Urdhëresa Administrative 2004/1, *që implementon Rregullorën e UNMIK-ut 2000/16, të ndryshuar në Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike*, Gazeta zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.

¹¹⁴ OSBE Misioni në Kosovë, Zgjedhjet në Kosovë, Regjistrimi i Partive Politike, 'Political Party Financial Reports', <http://kosovoelections.org/eng/pfd/financialreports.aspx?pcodeë146>, shikuar më 1 shtator 2006; OSBE Misioni në Kosovë, PPRO, 'Report on Political Entity Campaign Financial Disclosures for 2004 Assembly Elections', <http://kosovoelections.org/eng/pfd/pdf/Final%20Campaign%20Financial%20Disclosure%20Report%20to%20CEC%202005-03-23%20ENG.pdf>, shikuar më 1 shtator 2006.

¹¹⁵ Vedat Memedaliu, 'OSBE-ja i bën publike pasuritë e politikanëve kosovarë', <http://www.agimi.com/modules.php?name=News&file=article&sid=3>, shikuar më 5 prill 2006..

¹¹⁶ UNMIK monitorimi i mediave, *Koha Ditore*, 'The wealth of the top people – to laugh and to cry', <http://www.unmikonline.org/press/2004/mon/sep/lmm150904.pdf>, shikuar më 7 prill 2006.

¹¹⁷ *Op. cit.*, OSBE Misioni në Kosovë, PPRO, 'Report on Political Entity Campaign Financial Disclosures for 2004 Assembly Elections', fq. 6.

- ¹¹⁸ Limiti legal i lejuar për shpenzime ditore është vendosur të jetë 5.000 euro për shpenzime ditore, *op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2; See also: *Op. cit.*, OSBE Misioni në Kosovë, PPRO, 'Report on Political Entity Campaign Financial Disclosures for 2004 Assembly Elections', fq. 8.
- ¹¹⁹ *Ibid.*, fq. 7.
- ¹²⁰ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/11.
- ¹²¹ Intervistë telefonike me person anonim, OSBE Departamenti i Zgjedhjeve, 1 shtator 2006..
- ¹²² Rregullorja e UNMIK-ut 1999/16, *Për Themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal të Kosovës dhe çështje të lidhur me të*, Gazeta zyrtare e UNMIK-ut , www.unmikonline.org; MEF, Departamenti për Revizion të Brendshëm, Prapavia , <http://www.mfe-ks.org/English/mefwww/departamentet/rmbrendshem/historiku.html>, shikuar në maj 2006.
- ¹²³ Netherlands Court of Audit (NCA), Buxheti i Kosovës, <http://www.rekenkamer.nl/cgi-bin/as.cgi/0282000/c/start/file=/9282400/modulesf/gxeny7cd>, shikuar në maj 2006.
- ¹²⁴ NCA, Audit Report 1999/2000, Conclusions, <http://www.rekenkamer.nl/9282400/v/>, and NCA, Audit Report 2001, Conclusions, <http://www.rekenkamer.nl/cgi-bin/as.cgi/0282000/c/start/file=/9282400/modulesf/gxeny7cd>, shikuar më maj 2006.
- ¹²⁵ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9; Rregullorja e UNMIK-ut 2002/18, *On the Establishment of the Office of the Auditor-General of Kosovo and the Audit Office of Kosovo* (later amended by Rregullorja e UNMIK-ut 2005/33), Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut , www.unmikonline.org.
- ¹²⁶ Office of the Auditor General (OAG), News Archive 2003, 'Membership to EUROSAI, Fifth Congress Meeting in Barcelona', 19 tetor 2003, http://www.oag-ks.org/news_archive.htm, shikuar më 24 gusht 2006.
- ¹²⁷ ZAGJ, Mandati, <http://www.oag-ks.org/home.htm>, shikuar në maj 2006.
- ¹²⁸ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, dhe *op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/18.
- ¹²⁹ ZAGJ Arkivi i lajmeve 2003, 'Emërimi i auditorit të parë në Kosovë, 1 dhjetor 2003, http://www.oag-ks.org/news_archive.htm, shikuar më 24 gusht 2006.
- ¹³⁰ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/18.
- ¹³¹ *Ibid.*
- ¹³² *Op. cit.*, MEF, Buxheti i Kosovës 2003, fq. 131-132.
- ¹³³ *Op. cit.*, MEF, Buxheti i Kosovës 2005, fq. 92.
- ¹³⁴ ZAGJ Arkivi i lajmeve 2004, 'Prezantimi i mediave në Kosovë', http://www.oag-ks.org/news_archive.htm, shikuar më 15 gusht 2006
- ¹³⁵ Ligji i Kuvendit të Kosovës 2003/2, *Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë* , <http://www.assembly-Kosovo.org>.
- ¹³⁶ ZAGJ, Historia e auditorit, <http://www.oag-ks.org/reports.htm>, shikuar më 24 gusht 2006.

- ¹³⁷ Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, Divizioni i NP-ve, <http://kta-kosovo.org/html/index.php?module=htmlpages&func=display&pid=37>, shikuar më 24 gusht 2006.
- ¹³⁸ ZAGJ, ‘Raporti i auditimit për Buxhetin e Kosovës 2004’, fq. 5, http://www.oag-ks.org/Reports_ENG/KCB%20Audit%20Report%202004.PDF, shikuar më 25 gusht 2006.
- ¹³⁹ Kuvendi i Kosovës, ‘Lajmet: Mbledhja e Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa’, 2 mars 2006, <http://www.assembly-Kosovo.org/?krye=news&newsid=710&lang=al>, shikuar më 24 gusht 2006.
- ¹⁴⁰ OAG, ‘Audit Report of Procurement Processes and Managements of Assets in the Municipality of Prishtina for the year 2004’, janar 2006, fq 11-26, http://www.oag-ks.org/Reports_ENG/AR2004EngPRISHTINA%20P-AM.PDF, shikuar më 24 gusht 2006
- ¹⁴¹ Intervistë me Kushtrim Kaloshi, drejtor, Instituti Demokratik Kosovar, 24 gusht 2006.
- ¹⁴² Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45, *Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës*, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.
- ¹⁴³ Shiko për shembull, *op. cit.*, MEF, Buxheti i Kosovës 2005.
- ¹⁴⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2005/53, *që ndryshon rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë*; Rregullorja e UNMIK-ut 2006/26, *që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 2001/ Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë*, Gazeta zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.
- ¹⁴⁵ Kujtim Kërveshi, ‘Drejtësia Kosovare në rrugë drejt arritjes së standardeve ndërkombëtare’, *KOHA për Integritet Evropian*, 5 shtator 2006, fq. 2-3.
- ¹⁴⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2005/52, *PërThemelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës*, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.
- ¹⁴⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2006/25, *Mbi Kornizën Rregullative për Sistemin e Drejtësisë në Kosovë*, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.
- ¹⁴⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26, *Mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës*, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, www.unmikonline.org.
- ¹⁴⁹ UNMIK, ‘Pillar I: Police and Justice Presentation Paper’, qershor 2004, fq. 15 http://www.unmikonline.org/justice/documents/PillarI_Report_Qershor04.pdf, shikuar më 3 shtator 2006.
- ¹⁵⁰ *Op. cit.*, MEF, Buxheti i Kosovës 2005, fq. 105.
- ¹⁵¹ MEF, Departamenti për bashkëpunim ekonomik ndërkombëtar, sektori për Koordinimin me Donatorë, ‘Donor Profiles,’ Prishtina, janar 2004, fq. 9.
- ¹⁵² *Op. cit.*, MEF, Buxheti i Kosovës 2005, Donor Contribution for Kosovo during 2004 and projections for 2005, fq. 134.
- ¹⁵³ *Op. cit.*, Rregullorja e UNMIK-ut 2005/52.

¹⁵⁴ *Ibid.*

